

# HADITHI I NDER SHËM

PËRKTHEU DHE PËRSHTATI:  
MR. IBRAHIM SHERIFI



THIRRJA 

# **Hadithi i ndershëm**

Dr. Mustafa Elbega Muhjedin Mustu Vehbi Sulejman Gavoci

**Përktheu dhe përshtati:**

**Mr. Ibrahim sherifi**

**Titulli në origjinal:** الحديث الشريف

**Titulli në shqip:** Hadithi i ndershëm

**Autor:** Dr. Mustafa Elbega, Muhjedin Mustu, Vehbi Sulejman  
Gavoci

**Përktheu dhe përshtati:** Mr. Ibrahim Sherifi

**Redaktor gjuhësor:** Grup lektorësh

**Realizimi kompjuterik:** Fatmir Idrizi

## Parathënie

---

Falënderimi i takon All-llahut. Atë e falënderojmë dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga All-llahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon All-llahu s'ka kush e lajthit dhe kë e largon nga rruga e vërtetë, s'ka kush e udhëzon. Dëshmoj se s'ka hyjni tjetër përveç All-llahut, i Cili është Një dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij. Paqja dhe meshira e Allahut qofshin për mbi Muhamedin alejhi selam, mbi familjen e tij, mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që e ndjekin rrugën e tij deri ditën e gjykimit.

Në hadithet profetike ka shumë dobi të panumërta, për atë që i lexon, janë të lehta për kuptim dhe veprim, zënë vend në zemrën e cdo besimtari, janë bindëse në cdo çështje, spjegues të ajeteve Kur'anore dhe orientues për njerëzit nëse atyre ju ngatërohet dicka.

Ky libër që është para jush është libër shkollor për shkallën e dytë të mësimin në disa shkolla në shtetin e Sirisë. Mësohet nga nxënësit që janë fillestarë në lëmin e Hadithit.

Në këtë libër janë spjeguar 50 hadithe që janë të nxjerrura nga libri Sahih Buhari, dhe të gjithë janë hadithe të vërteta nga i Dërguari alejhi selam.

Ky libër përmban në vete shumë dobi, shtjellon shumë tema të ndryshme që i nevojiten një muslimani në jetën e tij, i cek dobitë e cdo hadithi, tregon rregulla fetare, dispozita, etikë, moral etj.

Titulli i tij në origjinal është: الحديث الشريف.

Shkrimtar të këtij libri janë tre autore: Dr. Mustafa Elbega, Muhjedin Mustu, Vehbi Sulejman Gavoci.

Idenë për përkthimin e librit fillimisht e mora nga hoxha Dhulkarnejn Ramadani.

Dhe pastaj e kam përkthyer temë për teme dhe është publikuar në web faqen: thirrjaislame.com, në formë temash javore, dhe më në fund kur është përkthyer i tëri e kam përmbledhur në një libër.

Redaktor gjuhësor të këtij libri janë një grup lektorësh që në emrin tim personal i falënderoj për mundin që e kanë dhënë.

Libri është 114 të formatit b5 , është i vogël në madhësi mirëpo i madh në kuptim.

Ua preferoj për lexim të gjithë njerëzve, e sidomos nxënësve të diturisë.

Disa çështje që janë cekur në këtë libër, nuk d.m.th. që unë pajtohem me autorin, dhe ndonjëherë nuk e ndaj të njejtin mendim me të, mirepo e kam përkthyer ashtu sic ka qendruar në tekst.

E lus All-llahun e Lartësuar që ta bënë këtë libër të dobishëm dhe të ketë prani tek njerëzit.

Ibrahim Sherifi

Shtator, 2018

Shkup

## Hadithi nr. 1: Etika e lutjes

---

*Etika e lutjes.* All-llahu i madhërishëm thotë në Kur'anin fisnik:

**{Kur ai iu lut Zotit të vet me një zë të ulët..} kaptina Merjem 3.**

**{Lutnie Zotin tuaj të përulur e në heshtje, pse Ai nuk e do ata që e teprojnë} kaptina El-A'Rafë 55.**

Nga Aisheja [Allahu qoftë i kënaqur me të] ka thënë: “ i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] pëlqente lutjet përmbledhëse.

Transmeton Xhabiri [Allahu qoftë i kënaqur me të] se i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] ka thënë: “Mos mallkoni veten, mos i mallkoni fëmijët tuaj, mos mallkoni pasurinë tuaj. Mos ia qëlloni çastit në të cilin Allahu lutësit ia plotëson çdo gjë të kërkuar, që edhe mallkimit tuaj t'i përgjigjet pozitivisht” (Transmeton Muslimi).

Transmeton Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të] se i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] ka thënë: “Kur dikush nga ju i lutet Allahut mos të thotë: O Zot më fal nëse don Ti, më furnizo nëse don Ti, le të kërkon çështjen i vendosur dhe i bindur në përgjigje ngase Allahu bën ç'farë të dëshiron nuk ka dikush që e detyron”. (Mutefekun Alejhi).

Shpjegimi:

Lutja është ibadet madhështor, me të cilën lutësi afrohet te Allahu dhe e bënë që të meriton më tepër pranimin e lutjes. Prandaj lutësi duhet të kujdeset ndaj atyre rregullave.

Prej rregullave është: ulja e zërit, zgjedhja e lutjeve përmbledhëse, e që janë lutjet me fjalë të shkurtëra dhe përmbajnë mirësi të mëdha.

Gjithashtu muslimani nuk duhet të mallkojë veten, fëmijët e tij, pasurin e tij, sepse mundet të ndodhë në çastet kur pranohet lutja dhe t'i përgjigjet All-llahu i lartësuar lutjes së tij. Poashtu nga çështjet që duhet largohet besimtari gjatë lutjes është edhe lidhja e lutjes me dëshirë e që jep të kuptohet se lutësi sikur nuk është i nevojshëm.

**Dobitë e hadithit:**

- Pëlqimi i uljes së zërit gjatë lutjes sepse përmban hushu'(koncentrim) dhe nënshtrim ndaj Allahut.
- Është e pëlqyer që lutja të bëhet me fjali përmbledhëse.
- Kujdesi që njeriu mos të mallkojë veten, pasurinë dhe fëminë e tij.
- Obligimi i vendosshmërisë gjatë lutjes duke mos e kushtëzuarë me dëshirë, sepse jep të ndiejmë sikur nuk është me rëndësi ajo që e kërkon dhe nuk tregon varfëri të plotë te Allahut te lartësuar.

## Hadithi nr.2: Morali në rrugë

---

Rrugët janë prej shërbimeve të përgjithshme prej të cilave përfitojnë të gjithë njerëzit, kështuqë nuk i lejohet askujt që ta zë rrugën ose të sillt në atë mënyrë që ta pamundëson që të tjerët të përfitojnë nga lëvizja e lirë. Në hadithin në vijim Pejgamberi s.a.w.s. na mëson moralin e rrugës, moral i cili e largon njeriun nga rënia në vepra të papëlqyera ose në të ndaluara dhe e largon atë nga dëmi ndaj njerëzve.

Transmetohet nga Ebi Seid el Hudriu [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: Ka thënë Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem]: “Keni kujdes dhe mos u ulni në rrugë.” Thanë: “O i Dërguari i All-llahut e kemi patjetër të ulemi në rrugë për të biseduar.” Tha: “Nëse e keni patjetër që të uleni në rrugë atëherë jepjani rruges hakun e vet.” Thanë: “E cili është haku i rrugës o i Dërguari i All-llahut?” Tha: “Ulja e shiqimit, mos shqetësimi i tjerëve, kthimi i përshëndetjes, urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja”.

### **Dobitë e hadithit:**

- Ua tërhoqi vërejtjen Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] shokëve të vet nga ulja në qoshe të rrugës, sepse ajo është shkak që mund njeriu të bjerë në mëkat. Kur ia treguan arsyen Pejgamberit [salallahu alejhi ve selem] për qëndrimin e tyre në rrugë ua lejoi me kushte dhe i cekti disa prej tyre dhe iu tha që të kenë sjellje islame:
  - a) Ulja e shiqimit: d.m.th. nga gjërat e ndaluara si p.sh.: shiqimi në gratë e huaja.
  - b) Mos shqetësimi: që mos e shqetësojnë në rrugë askënd, as mos t’ua zënë rrugën atyre që kalojnë, as mos të tallen me ata, as mos të ju thonë grave fjalë shqetësuese, ose të tallen me to, ose t’i hedhë mbeturinat në rrugë, etj.
  - c) Kthimin e përshëndetjes: kthimi i përshëndetjes është obligim (vaxhib) dhe e ka përmendë Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] në veçanti në këtë hadith që mos ta nënvlersojë ai që rri në rrugë kthimin e përshëndetjes përshkak të përshëndetjeve të shumta.
  - d) Urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja: kjo bëhet duke i udhëzuar kah e mira ose përkujtimi i tyre me dispozita sheriatike ose këshillimi i tyre, ndërsa ndalimi nga e keqja bëhet kur sheh



kundërshtimin e ligjeve të All-llahut ose shkelje të normave të fesë.

- Rruga ka gjithashtu të drejta tjera në Islam që janë përmendur në hadithe tjera: të folurit mirë, ndihmimi i të tjerëve nëse kanë nevojë për të bartur diçka, ndihmimi i atij që i bëhet padrejtësi, udhëzimi i atyre që nuk e dinë rrugën.
- Gjithashtu aludon hadithi se rrugët janë shërbime të të gjithëve dhe nuk lejohet që dikush ta përvetësojë atë.
- Muslimani duhet që çdoherë të veprojë për përhapjen e mirësisë.
- Nuk lejohet ngushtimi i rrugës për kaluesit.

## Hadithi nr.3: Dispozita e xhenazes

---

Sheriati islam i ka dhënë rëndësi dispozitave të xhenazes si dhe na nxit për përcjelljen e saj, dhe e ka ngulitur në jetën shoqërore të muslimanëve derisa është bërë pjesë përbërëse e jetës së përditshme të tyre. Këtë e vërejmë në dispozitën e nderimit të të vdekurve prej të gjallëve dhe marrja mësim nga ky udhëtim i domosdoshëm për çdo të gjallë. Në këtë temë bëhet fjalë rreth vlerës së përcjelljes së xhenazes dhe namazit të saj si dhe qëndrimi me të derisa të kryhet varrosja.

Transmeton Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të] se Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] ka thënë: "Kush e përcjell kufomën e besimtarit me besim dhe duke pritë shperblim,dhe qëndron derisa të i falet namazi i xhenazes dhe të kryhet varrimi ai kthehet me dy kirat ...çdonjëra nga ato sikur kodra e Uhudit, e kush ia falë namazin e xhenazes pastaj kthehet para se të varroset, ai kthehet me një kirat ...".

### Dobitë e hadithit:

- Përcjellja e kufomës: hadithi flet për përcjelljen e kufomës,nuk është problem nëse hecin njerëzit para kufomës apo pas saj, djathtas apo majtas,sepse kështu më shpejt përcjelljet xhenazja edhe arrihet praktikimi i sunnetit në përshpejtimin e xhenazes. Nuk përcjelljet xhenazja me zëra të lart(këtu hyn edhe muzika) apo zjarr,mirëpo duhet përcjellur me qetësi,duke marrë mësim nga vdekja edhe duke u lutur për të vdekurin.
- Namazi ndaj kufomës: është obligim kolektiv(farz kifaje). Për kryerjen e këtij namazi kemi disa obligime ndaj të vdekurit si: pastërtimi ,mbulimi i pjesëve të turpshme,kthimi kah kibla etj.Të njëjtën kohë është nderim për të vdekurin të lutesh për të,dhe falet pasiqë të pastrohet kufoma dhe të qefinoset. Është e pëlqyer që në namazin e kufomës të prezentojnë sa më shumë njerëz,dhe të rënditen në sa më shumë rreshta.Më së paku duhet të ketë njerëz deri në 40 persona ose më së paku të bëhen tre rreshta.
- Çka është kirat? Ka thënë ibn Ethiri: "kirat është një pjesë e dinarit, është gjysa e një të dhjetës në shumicën e vendeve". Ndërsa banorët e shamit e llogarisin pjesë e një të njëzet e katërtës. Ne nuk e dim se si do të jetë shpërblimi në botën tjetër dhe këtë e din vetëm All-llahu xh.sh. dhe ne nuk mund të dijmë vetëmse nëpërmjet

përngjasimit të tij me diçka nga ajo që e njohim, për këtë arsye e ka përshkruar me pjesë të dinarit. Kirati e ka vlerën e vogël mirëpo në hadith e shohim se vlera e tij është sa kodra e Uhudit që është në afërsi të Medines.

- Hadithi na udhëzon që të prezentojmë në varrime dhe në faljen e namazit të xhenazes.
- Ka argument se All-llahu I lartëmadhëruar e ka nderuar kufomën e besimtarit dhe e ka bërë që të shpërblehet shumë ai i cili përkujdeset për vorrimin e tij.

## Hadithi nr.4: Kerkimi i natës së Kadrit

---

Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] e ka njohur mirë jetën e popujve të mëhershëm, por edhe jetën e umetit të tij. Ai e ka ditur se populli i tij nuk mund të arrij që t'i kryej të gjitha punët dhe obligimet gjatë kësaj jete të shkurtër, andaj All-llahu i madhëruar ia ka dhuruar atij natën e kadrit, kjo natë e cila është më e mirë se sa një mijë muaj. Në hadithin që e transmeton Ubade ibn Samit [Allahu qoftë i kënaqur me të] Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] ka nxitë në kërkimin e natës së kadrit, pasi që nuk dihet saktësisht se kur është ajo, ku thuhet: Një natë pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] ka dal që t'u tregojë njerëzve se kur është nata e kadrit, megjithatë kur i pa dy myslimanë duke u grindur, ai tha: *“Unë dola që t’ju tregoj për natën e kadrit, por i pashë se si grindeshin dy myslimanë, dhe ajo u ngrit. Ndoshta kjo është mirësi për ju, andaj kërkoheni atë në të shtatat, të nëntat ose në të pestat.”*

### Dobitë e hadithit:

- **Vlera e natës së kadrit**

Nata e kadrit në përgjithësi është nata më e mirë. Lidhur me këtë Allahu thotë në Kuranin Fisnik:

**“ Ne e zbritëm atë (Kur’anin) në natën e Kadrit.**

**E ç’të bëri ty të dish se ç’është nata e Kadrit?**

**Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj!**

**Me lejen e Zotit të tyre në (atë natë) të zbresin engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) për secilën çështje.**

**Ajo (që përcakton Zoti) është paqe deri në agim të mëngjesit.”(Kadër, 1-5)**

Pra, Allahu ka zbritur kaptinë të posaçshme për të treguar vlerën e kësaj nate, edhe atë duke përmendur se:

a) ajo është më e rëndësishme se një mijë muaj, pra, namazi, përmendja e Allahut dhe agjërimi në këtë natë kanë më shumë vlerë se sa t'i kryesh ato një mijë netë;

b) engjëjt zbresin në këtë natë;

c) ajo është paqe deri në mëngjes;

- **Caktimi i saj**

Dijetarët kanë mendime të ndryshme për caktimin e natës së kadrut, e mendimi më i vërtetë është se ajo gjendet në njërin prej dhjetë netëve të fundit të muajit të ramazanit. Ndërkaq, urtësia e mosdijes saktësisht të kësaj nate është se, njerëzit në këtë mënyrë japin më shumë përpjekje për ta gjetur atë, e që në të kundërt njerëzit do të jepnin përpjekje vetëm në një natë të caktuar;

- **Namazi dhe lutja në këtë natë**

Nga Ebu Hurejre [Allahu qoftë i kënaqur me të] transmetohet se Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] ka thënë: *“Kush e ngjall natën e kadrut me besim në Allahun dhe duke e pritur vetëm nga ai shpërblimin, atij i falen mëkatet e kaluara ”*. Dhe ngjallja e natës së kadrut është falja e namazit gjatë tërë natës. Poashtu, transmetohet nga Aishja r.a. se e ka pyetur pejgamberin a.s.: *“Nëse e arrij natën e kadrut, çka të them?”*, ai tha: *“Thuaj: ‘O Zot, ti je falës, e do faljen, më fal mua.’”*;

- **Urrejta e grindjes dhe mosmarrëveshjes**, ngase grindja e disave është dënim për të gjithë;
- **nxitja e kërkimit të natës së kadrut.**

## Hadithi nr.5: Këshilla për çdo musliman nga Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem]

---

Pejgamberi alejhi selam ka qenë ai që ua ka marrë besën shokëve të vetë për çështje të ndryshme, e sidomos atyre në të cilët ka parë fuqi në pasimin e të vërtetës dhe ndihmë ndaj saj; dhe këtë e ka bërë për ta ripërtërirë besën e fesë apo për të vërtetuar ndonjë çështje. Kjo është një prej mënyrave të edukimit të Pejgamberit [salallahu alejhi ve selem] në pastrimin e qenies dhe nënshtrimin e saj ndaj udhëzimit.

Në vazhdim do të shohim besën e dhënë nga një shok i ndershëm i Pejgamberit [salallahu alejhi ve selem]. Transmetohet nga Xhabir ibn Abdullah el Bexhelij [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: Ia kam dhënë besën të Dërguarit [salallahu alejhi ve selem] për faljen e namazit, dhënien e zekatit dhe për këshillë ndaj muslimanit.

### **Dobitë e hadithit:**

- **Kufizimi i namazit dhe zekatit.**

Hadithi është kufizuar në namaz dhe zekat për shkak të rëndësisë së tyre në Islam. Namazi është shtylla e fesë dhe është adhurim trupor, ndërsa zekati është adhurim me dhënie të pasurisë.

Ky hadith është transmetuar me fjalë të ndryshme siç është transmetimi i Buhariut dhe Muslimit: Ia kam dhënë besën Pejgamberit [salallahu alejhi ve selem] për ndëgjim dhe respektim, dhe ai më tha: *“Në atë që ke mundësi dhe këshillimi për çdo musliman.”* Në librin e Buhariut qëndron: Erdha te Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] dhe i thash: *“ta jap besën për Islam”*, dhe ai më kushtëzoi edhe këshillimin për çdo musliman.

- **Këshillimi për çdo musliman**

Shumica e transmetimeve bëjnë me dije se Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] është ai i cili ia ka kushtëzuar edhe këshillën për çdo musliman, pasi që Xheriri [Allahu qoftë i kënaqur me të] e ka dhënë besën për Islam dhe për shtyllat e fesë. Nga kjo e kuptojmë rëndësinë e këshillës për çdo

musliman. Dhe po ashtu, Imam Buhariu e ka përfunduar librin e tij me kapitullin e këshillës, sepse me të është plotësimi i imanit.

Është transmetuar nga Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem].: ” *Feja është këshillë për Allahun, për librin e Tij, për Pejgamberin e tij, për prijësit e besimtarëve dhe për muslimanët në përgjithsi*”.

Këshilla është fjalë gjithpërfshirëse që ka kuptim dëshirimin e të mirës ndaj atij që këshillohet. Hadithi në fjalë “feja është këshillë” është prej haditheve që është thënë për të se është çereku i fesë.

a) Këshilla për Allahun: Përshkrimi i cilësive të Tij si i takon madhërisë së Tij, nënshtrimi ndaj Tij me gjymtyrët e brendshme dhe të jashtme, dashuria ndaj Tij dhe veprimi i urdhrave të Tij, largimi nga ndalesat e Tij, lufta për kthimin e gjunahqarëve tek Ai.

Transmetohet nga Isa alejhi selam se ka thënë: “Këshilluesi për Allah është ai i cili i jep përparsi hakut të Allahut para hakut të njerëzve.”

b) Këshilla për librin e Allahut është: Mësimi i tij për vete dhe të tjerëve. Leximi dhe shkrimi i tij mirë, kuptimi i fjalëve të tij, nënshtrimi ndaj regullave të tij, veprimi me atë çka është në të dhe largimin e keqinterpretuesve të tij.

c) Këshilla për Pejgamberin e Tij: Ngritja e tij dhe ndihma ndaj tij i gjall dhe i vdekur, ngjallja e sunetit të tij me mësimin e tij dhe mësimin e të tjerëve, marrja e tij në fjalë dhe vepra, dashuria ndaj tij dhe ndaj pasuesve të tij.

d) Këshilla prijësve të besimtarëve: Ndhma ndaj tyre në bartjen e përgjegjësisë, vërejtja ndaj anashkalimeve, bashkimi me ta, dhe largimi i tyre nga padrejtësia me të mirë. Prej prijësve të besimtarëve janë edhe dijetarët e tyre, dhe këshillimi i tyre bëhet duke e shpërndarë diturinë e tyre dhe të mirat e tyre dhe mendimi i mirë për to.

e) Këshilla për muslimanin e rëndomtë: Mirësia ndaj tyre, ndihma ndaj tyre, mësimi i tyre çka u bën dobi, largimin e të këqijave nga ata, të duash për të atë që e do për vete, dhe të urresh për të atë që e urren për vete.

- Veçimi i këshillës për muslimanin është për ne përgjegjësi. Ndërsa këshilla për pabesimtarin mundet të zbatohet duke e thirrë atë në Islam dhe duke e drejtuar kah e mira, nëse kërkon drejtim.
- Përkushtimi i Xheririt r.a. ndaj besës së dhënë: Ky sahabi i ndershëm ka vazhduar, i përkushtuar ndaj besës së dhënë edhe në shitje dhe blerje.

Transmetohet se kur ka shitur diçka u ka thënë njerëzve me të vërtetë këtë që po ta shes e dua më shumë se sa atë që po ma jep, prandaj zgjidh. Gjithashtu është transmetuar se një rob i tij e ka blerë një ditë një kalë për treqind dirhem, kur e ka parë mire kalin, e ka marrë atë dhe ka shkuar te pronari i tij dhe i ka thënë: Kali yt meriton më shumë se treqind dirhem, derisa në fund ia ka dhënë tetëqind dirhem.

Gjithashtu transmetohet se Xheriri [Allahu qoftë i kënaqur me të] një ditë ka hypur në hutbe dhe ka thënë: Unë kam shkuar te Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] dhe i kam thënë: Ta jap besën për Islam, e ai më kushtëzoi edhe këshillën ndaj çdo muslimani dhe u besatova për këtë, pasha Zotin e kësaj xhamie unë po ju këshilloj juve...

- **Këshillimi i të gjithë njerëzve.**
- Fjala “Din” d.t.th. vepër. Argument për këtë është fjala e pejgamberit: *“feja është këshillë”*.
- **Morali Islam është humanizëm.**

**Përfillja e shokëve të Pejgamberit [salallahu alejhi ve selem] ndaj besës së dhënë.**



## Hadithi nr.6: Xhelozia pozitive e lavderuar

---

Xhelozia në esencë është dëshira e largimit të mirësive nga dikush. Dhe me këtë kuptim është nga sjelljet e këqija të nënçmuara, dhe tregon për mosnjohjen e mirësive të Allahut dhe rebelimi ndaj gjykimit të Tij, dhe shfaqet te njerëzit në cilësinë e urrejtjes dhe zilisë. Për këtë arsye e ka ndaluar këtë Islami dhe e ka nënvlersuar shumë, dhe ka bërë për të shërim që e rrënjosë këtë cilësi nga njerëzit, dhe ky shërim është në përforsimin e besimit në Allahun edhe në lejimin e xhelozisë pozitive. Në hadithin në vijim na zgjedh Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] nga xhelozia pozitive dy çështje të rëndësishme për shpëtimin e njerëzve dhe forcimin e shoqërisë. Transmetohet nga Abdullah ibn Mesudi [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: Ka thënë Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem]: "Nuk ka xhelozia përveçse në dy gjëra: një njeri që i ka dhënë Allahu pasuri dhe ai atë e shpërndan ditën dhe natën, dhe një njeri që i ka dhënë Allahu urtësi dhe ai me të gjykon dhe ua mëson të tjerëve".

### Dobitë e hadithit:

- Xhelozia dhe shërimi i tij: xhelozia e nënvlersuar është prej sëmundjeve shoqërore që e dobëson atë dhe i prish zemrat dhe e largon qetësimin nga njeriu. Ka thënë Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem]: "ju ka kapluar juve sëmundja e popujve para jush urrejtja dhe xhelozia dhe ajo është që të rrunë, rrunë fenë e jo flokët. Ka thënë i Lartesuari: **thuj kërkuj mbrojtje prej Zotit të agimit...nga dëmi i ziliqarit kur të xhelozon**". Urrëjtja rrënjën e ka te xhelozia, çdo e keqe ia fillon prej te xhelozia, ai që xhelozon e korigjon gjykimin e Allahut dhe nuk e pranon gjykimin e tij në atë që ka thënë. Zilia është mëkati i parë që i është bërë Allahut Zotit të botrave, kur nuk i bëri sexhde iblisi Adem-it alejhi selam. Gjithashtu ka qenë shkak për mëkatin e parë ndërmjet njerëzve kur Kabili e vrau vëllaun e tij Habilin. Për këtë xhelozia është cilësi e keqe dhe e nënvlersuar dhe e fshinëfenë dhe besimin. Islami ka bërë shërim për xhelozinë, dhe ilaçi përbëhet nga dy çështje:

a) përforsimi i besimit në Allahun dhe forcimi i lidhjes me Atë, kënaqësia me caktimin e tij.

b) garimi i lavdëruar: garimi në të mirë, synimi i njeriut që të ketë edhe ai sikur të tjerët pasuri, dituri apo popullaritet, këtë e ka lejuar Islami. Ka thënë i lartësuar: ” **në këtë le të bëjnë gara garusit**”. Ka thënë Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem]: ”besimtari ka garim a munafiku zili”.

- Shpenzimi i pasurisë në bamirësi: pasuria është dhuratë prej Allahut dhe emanet dhe trashëgimi, ka thënë Allahu: ” **shpenzoni nga ajo që Allahu ju ka bërë trashëgues**”, Allahu e ka bërë pasurinë nga shkaqet e rehatisë dhe gjithashtu është shkak për të vepruar vepra të mira dhe nuk është qëllim në vete as epsh, ka thënë Allahu :” **kërko me atë që të ka dhuru Allahu, botën e ardhshme**”. Kështu që pasuria është për të cilën xhelozohet pozitivisht njeriu, dhe besimtari e kërkonë atë nga mënyrat e lejuara pastaj e shpenzon atë në mirësi dhe arrin me të pozitive të lartë te Allahu xh.sh. dhe te njerëzit. Ka thënë Ibn Sirini: i pasuri është më i dashur tek unë se i varfëri sepse i pasuri me pasuri i mban lidhjet farefisnore, e kryen haxhin, liron rob, dhe jep lëmoshë.
- Gjykimi ndërmjet njerëzve me urtësi dhe mësimi i saj njerëzve: nga mirësitë e Allahut ndaj robit të Tij është që ti jep sukses që t’a vendos çdo send në vendin e tij dhe që të flet vetëm se me hak dhe kjo është nga urtësia, ka thënë Allahu :” **kujt i është dhënë urtësia i është dhënë një mirësi e madhe**”. Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] në hadith e ka pasur për qëllim diturinë në ligjet e Allahut dhe diturinë në sunnetin e Pejgamberit [salallahu alejhi ve selem]. Sikur që e ka komentuar imam Shafiu fjalën e Allahut: ”edhe ua mëson librin (kuranin) dhe urtësinë (sunetin)”. E meriton dijetari i rregullave të fesë që të xhelozohet për mirë nga njerëzit për këtë dhunti që e ka, ka thënë i derguari [salallahu alejhi ve selem]: ” me të vërtetë Allahu dhe engjujt e Tij edhe banorët e qiejve dhe tokës derisa edhe bubrecci në follenë e tij, derisa edhe peshqit bëjnë dua për atë që ua mëson njerëzve mirësinë”.
- Tregon hadithi se xhelozia e nënvlersuar është sëmundje shoqërore e rrezikshme.
- Xhelozia për të mirë është e lavdëruar nëse është për mbledhjen e pasurisë dhe shpenzimin e saj në mirësi apo nëse është për ta mësuar urtësinë për të gjykuar ndërmjet të armiqësuarve ose ta mundë paditurinë.
- Vlera e të pasurit i cili nuk kursen nga ajo që ia ka dhënë Allahu i Lartëmadhëruar.

- Vlera e diturisë mbi rregullat e fësë dhe mësimi i tij njerëzve.

## Hadithi nr.7: Furnizimi është prej All-llahut të lartësuar

---

Allahu i lartësuar është furnizuesi, dhe Ai është i cili ju jep robërve të Tij nga magazinat e pashtershme të Tij. Këtë furnizim ngandonjëher e bën nëpërmjet dikujt prej njerëzve. Nëse i jepet dikujt ndonjë pasuri pa e kërkuar dhe pa nënçmim të vetes le ta merr atë sepse është furnizim që ia ka dhënë Allahu dhe le të mos kërkon më shumë dhe mos të ia kthen atij që jep me arsyen se pak ose shumë,sepse furnizuesi i vërtetë është Allahu i lartësuar dhe ai njeriu që e jep atë me të vërtetë është ndërmjetsues dhe mjet dhe ndarës ose shpërndarës e jo furnizues apo ndalues.

Transmetohet nga Muaviu [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: e kam ndëgjuar Pejgamberin [salallahu alejhi ve selem] duke thënë: ” kujt ia don All-llahu të mirën e bën të ditur në fe, me të vërtetë unë jam shpërndarës dhe All-llahu është furnizues, dhe do të vazhdon ky ummet i ngritur në çështjen e All-llahut nuk i dëmton ato kush i kundërshton derisa të vijë urdhëri i All-llahut xh.sh.”.

### **Dobitë e hadithit:**

- Në këtë hadith flitet për vlerën e diturisë dhe nxitjen drejt saj,sepse e udhëzon besimtarin drejt devotshmërisë.
- Gjithashtu flitet për vlerën e diturisë në fe mbi dituritë tjera,dhe vlerën e dijetarëve fetarë mbi njerëzit tjerë.
- Pejgamberi alejhi selam është përcjellës nga All-llahu dhe sqarues i ligjeve te Tij, dhe ndihmues i sheriatit të Tij.
- Furnizimi i vërtetë është nga ana e All-llahut të lartësuar, njerezit janë mjet, besimtari kërkon prej All-llahut e jo prej njerëzve.
- Të kërkosh pa nevoj është nënçmim dhe poshtërim dhe e ndaluar në Islam ndërsa të kërkosh me nevoj nuk prish gjë me kushtë duke mos e nënçmuar veten dhe mos ta tepron në kërkim dhe mos t'i shqetëson njerezit.
- Pasuria është e All-llahut të lartësuar dhe kush jep diqka nuk bën të lavdërohet ose të poshtëron dikë dhe kujt i jepet diqka nga pasuria pa e kërkuar atë ,le ta mer atë dhe nuk ka faj në të dhe nuk ia ulë vlerën sepse ai është rob prej robërve të Allahut e merr nje pasuri e cila është e Allahut.
- Kujt i jep furnizim All-llahu ai duhet të jetë i kenaqur me atë dhe mos të lakmon në atë që ua ka dhënë All-llahu të tjerëve prej furnizimit dhe të mirave të Tij.
- Allahu e mbronë këtë fe nga keqpërdorimi ,ndryshimi apo nga shtrembërimi apo nga humbja e tij.

- Eshtë obligim qe ummeti të ketë në të një grup që mësojnë fenë,dhe i mësojnë rregullat e tij,dhe ua mësojne njerëzve.Kjo është obligim kolektiv(farz kifaje)nëse e bëjnë disa njerëz bie obligimi nga të tjerët,e nëse nuk e bën askush të gjithë kanë mëkat.
- Ummeti duhet që të urdhëron në të mirë dhe të ndalon nga e keqja dhe ta mbronë fenë Islame dhe ta lufton të keqen dhe degjenerimin,dhe çdo send që e prishë besimin dhe moralin e ummetit.

## Hadithi nr.8: Ngritja e diturisë

---

Transmeton Imam Ahmedi dhe Taberaniu në shkakun e zbritjes së hadithit “ngritja e diturisë” se ebu Umame [Allahu qoftë i kënaqur me të] ka qenë në haxhin e lamtumirës dhe ka thënë Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem]: ”merrni dituri para se të ngritet” tha një beduin si ngritet? Tha: ”ngritja e diturisë është me shkuarjen e bartësve të saj “ tri herë.

Në një transmetim tjetër të Ebu Umames [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ai(beduini) ka thënë: o i derguari i Allahut si do të ngritet dituria nga ne a në mesin tonë ka mus’hafa (Kur’ana) dhe e kena mësu çka ka në to dhe ua kemi mësuar fëmijëve tanë, grave tona dhe shërbetorëve tanë. E ngriti kokën kah ai duke qenë i nervozuar dhe tha: ”jehudet dhe të krishterët i kanë në mesin e tyre librat e tyre mirëpo nuk kanë mësuar nga to ajo që u ka ardhë pejgamberëve të tyre”.

Transmetohet nga Abdullah ibn Amr ibn Asi [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: ka thënë i Dërguari i All-llahut [salallahu alejhi ve selem]: ”me të vërtetë Allahu nuk e merr diturinë duke ua marrë njerëzve prej gjoksave mirëpo e merr diturinë me marrjen e dijetarëve,derisa nuk ngel asnjë dijetar,pastaj njerëzit i bëjnë prijsa injorantët dhe ata pyeten dhe japin përgjigje pa dituri dhe devijojnë veten dhe të tjerët”.

### **Dobitë e hadithit:**

- Ngritja e diturisë: shpërndarja e injorancës është nga shenjat e kiametit që aludon në mbarimin e jetës në këtë botë.I ka lajmëruar Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem]. Shokët e tij në haxhin e lamtumirës dhe janë habitur si mundet të ngritet dituria kur ata e lexojnë kuranin,dhe ua qartësoj Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] se diturinë Allahu nuk ua fshinë njerëzve prej gjoksave,mirëpo pakësohet dituria dhe shpërndahet injoranca me vdekjen e dijetarëve.Transmeton Tirmidhiu nga Ebu Derda [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë :kemi qenë me Pejgamberin [salallahu alejhi ve selem] dhe e ka ngritë shiqimin e tij drejt qiellit dhe ka thënë: vjen koha kur do të ngritet dituria nga njerëzit derisa nuk do të dijnë asgjë”,dhe tha Zijad ibn Lebid el Ensariu [Allahu qoftë i kënaqur me të] :si do të ngritet dituria nga ne kur ne e lexojmë

kuranin dhe pasha Allahun do ta lexojmë atë dhe do ua lexojmë femijëve tanë dhe grave tona, dhe i tha i derguari:” të humb ty nana o Zijad a unë të kam llogaritur prej dijetarëve të Medines, ky është tevrati dhe inxhili te jehudet dhe te krishterët qka ju bjen dobi atyre?...etj.

E ka thënë të vërtetën i derguari i Allahut [salallahu alejhi ve selem] se cka bëjnë dobi librat nëse mbeten vetëm shkronja të shkruara dhe vija të rënditura, nëse njerëzit nuk i mësojnë rregullat e saj as nuk veprojnë me të.

- Omer ibn AbdulAzizi [Allahu qoftë i kënaqur me të] duke e ditur këtë hadith është frikuar mos po humbet hadithi i Pejgamberit [Allahu qoftë i kënaqur me të] dhe i shkruan mëkëmbësit të tij për në Medine Ebu Bekër ibn Hazmit: merri dhe shkruaj të gjitha hadithet e Pejgamberit [salallahu alejhi ve selem] se unë frikohem nga humbja e diturisë, dhe shkuarjes së dijetarëve, dhe nuk pranohet vetëm se hadithi i pejgamberit [salallahu alejhi ve selem] dhe le ta shpërndajnë diturinë dhe le të mësojnë derisa të dinë ata që nuk dinë, dhe se nuk shkatërohet dituria derisa të mbahet fshehurazi”.
- Kujdesi nga dhënia e fetfave (përgjigje) në çështjet fetare pa dituri, pa u vërtetuar nga mendimi më i vërtetë. Ka thënë Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem]:” më i guximshmi për fetfa është më i guximshmi për në Zjarr”
- Muslimanët duhet që t’i pyesin për rregullat e fesë dijetarët që veprojnë me të, dhe të cilët janë të njohur me diturinë dhe më devotshmerinë e tyre.
- Nxitja në kërkimin e diturisë dhe kujdesi që të veprojmë me të dhe mbrojtja e diturisë nga humbja.
- Rëndësia e diturisë islame në rregullimin e jetës së muslimanit, dhe ruajtjes së lumturisë së tyre.
- Dituria kur të përmendet në fjalët e të Dërguarit [salallahu alejhi ve selem] fillimisht është për qëllim dituria islame e cila ua sqaron muslimanëve rregullat e fesë së tyre me të cilën ata shpëtojnë në këtë botë dhe në botën tjetër.

## Hadithi nr.9: Mësimi i grave

---

Dituria e vërtetë është mjeti parësor i përmirësimit të shoqërisë. Ajo duhet t'i përfshijë që të dy gjinitë: burrat dhe gratë, dhe njëherit ato të plotësojnë njëra-tjetrën. Lidhur me këtë, urdhërat e fesë islame kanë ardhur njësoj, si për burrat, ashtu edhe për gratë.

Transmetohet nga Ebu Seid el Hudriu [salallahu alejhi ve selem] se ka thënë: I kanë thënë gratë Pejgamberit [salallahu alejhi ve selem]: *“Burrat na e kanë kaluar në dituri, andaj ndaj një ditë për të na mësuar edhe neve”*. I dërguari i Allahut [salallahu alejhi ve selem] u premtoi dhe një ditë u takua me to, dhe në mes të tjerash u tha: *“Nuk ka ndonjë grua të cilës i kanë vdekur tre fëmijë, e ato të mos jenë mburojë prej zjarrit për të”*. Një grua prej tyre tha: *“edhe dy?”*. I dërguari i Allahut ia ktheu: *“edhe dy”*.

### Dobitë e hadithit:

- **Guximi i moralshëm i muslimanëve në kërkimin e të drejtave për mësimin e fesë dhe marrjen e diturisë.**

Gratë edhe pse kanë prezentuar në ligjëratat e të Dërguarit [salallahu alejhi ve selem], përsëri kanë pasur turp që ta pyesin Pejgamberin [salallahu alejhi ve selem] për gjërat që u kanë interesuar. Andaj, lidhur me këtë Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] ka caktuar një vendtakim të veçantë për t'u konsultuar, këshilluar dhe për t'i rregulluar çështjet familjare, gjë që është zgjidhja më e mirë për përmirësimin e gruas dhe mbrojtjen e nderit të saj;

- **Mësimi i gruas**

Feja islame i ka dhënë rëndësi të veçantë edukimit dhe arsimimit të gruas, nënës edukatore, e cila ndihmon në përmirësimin e familjes dhe shoqërisë. Islami e nxit gruan për pjesëmarrje në jetën shoqërore, edhe atë duke ia lejuar prezencën në xhami, në vende të diturisë, e të ngjashme.

S'ka dyshim se arsimimi i gruas ka rëndësi të madhe në formimin e shoqërisë së mirëfilltë islame, sepse arsimimi dhe vetëdijësimi i saj ndikon fuqishëm në formimin e një gjenerate të përgjegjshme e të ndërgjegjshme. Kështu, gruaja me ndjenjat e saja të sinqerta e të buta hyn në jetën e fëmijëve dhe i trajton problemet e tyre, gjë që e zgjon pëlqimin dhe



dashurinë e tyre ndaj nënës, dhe kësisoj fëmijët e pasojnë nënë me gjithë sjelljet dhe veprimet e saj. E gjithë kjo tregon se arsimimi i gruas luan rol të posaçëm në përmirësimin e familjes;

- **Këshilla e veçantë për gratë e mërzitura dhe të goditura me sprovën e vdekjes së ndonjë prej fëmijëve të tyre dhe shpërblimi i madh si rezultat i kësaj sprove;**
- **Edukata e guximit që duhet të posedojë çdo musliman;**
- **Vlera që ia ka dhënë Islami gruas, jo vetëm si grua dhe nënë, por edhe si pjesë përbërëse e shoqërisë së dobishme;**
- **Të lejuarit e njeriut të ditur në edukimin dhe arsimimin e grave, me kusht që mos të ketë veçime të ndaluara dhe fitne;**
- **Urtësia e Pejgamberit [salallahu alejhi ve selem] në përshtatjen e temës konform bashkëbiseduesve.**

## Hadithi nr.10: Përparësia e të djathtës ndaj të majtës

---

Muslimani dallohet nga të tjerët me sjelljet e tij: veshmbathja, të ushqyerit, pastërtia, etj, ndër të cilat vend të posaçëm zë edhe shembulli i Pejgamberit [salallahu alejhi ve selem] në dhënien përparsi të së djathtës ndaj të majtës.

Përkitazi me këtë transmetohet nga Aishja [salallahu alejhi ve selem] se ka thënë: *“Pejgamberi alejhi selam e ka pëlqyer që të fillojë me të djathtën në mbathjen e nallaneve, krehjen e flokëve, pastrimin e tij dhe në të gjitha çështjet e tij.”*

### Dobitë e hadithit:

- **Të filluarit e Pejgamberit [salallahu alejhi ve selem] me anën e djathtë në mbathjen e nallaneve dhe pastrimin e tij.**

Në disa versione është transmetuar se Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] ka shtuar duke thënë: *“sa të ketë mundësi”*, për të vërejtur që të kihet kujdes si në rastin e hyrjes në banjo, ku përjashtohet ky rregull dhe i ipet përparsi të së majtës. Ndërsa fjala e Aishes “në të gjitha çështjet” jep të kuptojmë se i dërguari i Allahut [salallahu alejhi ve selem] nuk e ka braktisur këtë praktikë as në shtëpi e udhëtim dhe as kur ka qenë i lirë ose i angazhuar.

- **Rregulli: pëlqyeshmëria e fillimit me të djathtë apo me të majtë**

Imam Neveviu r.a. ka thënë se është e pëlqyer fillimi me anën e djathtë në çdo gjë që është e bukur dhe e ndershme, ndërkaq në gjithçka të kundërt është e pëlqyer të fillohet me anën e majtë. Dhe poashtu imami ka theksuar se ekziston konsensus i dijetarëve të ehlu sunetit se fillimi me anën e djathtë gjatë abdesit është sunet dhe se kush e braktisë këtë, ka humbur një vlerë, mirëpo ka abdes;

- **Shembuj të përdorimit të këtij rregulli**

Është mirë që të fillohet me anën e djathtë në veshjen e rrobave, këpucëve; gjatë hyrjes në xhami, gjatë përdorimit të misvakut, prerjes së thonjëve, krehjes së flokëve, rruajtjes së nënsqetullave, rruajtjes së flokëve; dhënia selam në namaz, larja e pjesëve të trupit gjatë pastrimit, ngrënia dhe pirja, përshëndetja, etj.

Ndërsa është mirë të fillohet me anën e majtë gjatë hyrjes në banjo, daljes nga xhamia, gjatë pastrimit të hundëve, zhveshjes së rrobave, këpucëve, e të ngjashme.

Prej pjesëve të trupit që nuk është e pëlqyer fillimi me anën e djathtë gjatë marrjes së abdesit, imam Neveviu i ka përmendur duart, fytyrën dhe veshët, për arsye se këto pastrohen me një herë (me një të larë);

- **nderimi i flokëve gjatë krehjes;**
- **vlera e të djathtës.**

## Hadithi nr.11: Larja e të Dërguarit [salallahu alejhi ve selem]

---

Larja paraqet të pastruarit e trupit me ujë të pastër. Ajo njëherit konsiderohet edhe një prej obligimeve për pastrimin dhe mbrojtjen e trupit nga sëmundjet dhe papastërtitë e ndryshme, gjë që ia kthen shëndetin dhe aktivitetin trupit.

Në lidhje me formën e të pastruarit, Aishja [Allahu qoftë i kënaqur me të] transmeton se *Pejgamberi* [salallahu alejhi ve selem] *kur është pastruar nga papastërtia (xhunubllëku) ka filluar me larjen e duarve, pastaj ka marrë abdes sikurse për namaz, me dorë të lagur i ka larë mirë rrënjët e flokëve, pas së cilës e ka shpërlarë kokën tri herë dhe në fund i ka hedhur ujë tërë trupit.*

### Dobitë e hadithit:

- **Obligueshmëria e të pastruarit nga papastërtia (xhunubllëku)**

Allahu i madhëruar në Kuran ka thënë: “**nëse jeni të papastër (xhunub), lahuni**” (Maide, 6).

Papastërtia ndodhë me dy gjëra:

1. me ejakulimin e spermës nga burri ose gruaja, duke shiquar dic, menduar apo ejakulim gjatë ëndërrimit, dhe
2. me marrëdhëniet intime, edhe nëse nuk bëhet ejakulim.

- **Larja e duarve**

Larja e duarve tri herë është sunet. Kjo, për higjienë më të madhe. Gjithashtu, transmetohet nga Buhariu se sunet është edhe larja e organit gjenital, e kjo mjafton të lahet një herë.

- **Abdesi para larjes**

Poashtu, nga tradita profetike është që para larjes të mirret abdes sikurse për namaz.

- **Fërkimi i flokëve**

Dobia e fërkimit të flokëve qëndron në atë se në këtë mënyrë uji arrinë në çdo pjesë të trupit. Kjo është obligim me pajtimin e të gjithë dijetarëve.

- **Shpërlarja e kokës tri herë**

Larja e gjymtyrëve nga tri herë është e preferuar. Ndërkaq, imam Neveviu ka thënë se nuk ekziston kundërshtim ndërmjet dijetarëve në këtë çështje, pos Maverdiut, i cili ka thënë se nuk është e preferuar përsëritja e larjes së gjymtyrëve.

- **Shpërlarja e tërë trupit**

Shpërlarja e tërë trupit është vërtetim se uji duhet ta kaplojë tërë trupin dhe njëherit argument se nuk është obligim fërkimi i tij.

- **Preferimi i plotësisimit të abdesit para larjes dhe mosvonimi i larjes së këmbëve deri në fund të larjes**

Thuhet se nëna e besimtarëve, Mejmune r.a. gjatë larjes ka marrë abdes sikur për namaz, përveç këmbëve. Andaj edhe shumica e dijetarëve preferojnë që të vonohet larja e këmbëve, ndërsa imam Maliku thotë: “nëse është vendi i larjes i papastër, preferohet vonimi i larjes së këmbëve, në të kundërt jo”.

Në medhhebin shafi ka dy mendime, ndërsa imam Neveviu ka thënë se më i sakti është se duhet plotësuar abdesi që në fillim të larjes, për arsye se shumica e argumenteve nga Aishja r.a. dhe Mejmune r.a. flasin kështu.

- **Larja, njëherit paraqet edhe adhurim, pasiqë i përgjigjet urdhrit të Allahut të madhëruar: “nëse jeni të papastër (xhunub), lahani!”.**
- **Islami është feja e pastërtisë**

## Hadithi nr.12: Besimtari nuk bëhet i papastër

---

Njeriu, edhe nëse është besimtar apo jobesimtar djersa e tij, jargët e tij, lotët e tij, janë të pastra edhe nëse e ka kry nevojën apo është bërë xhunub (papastër) ose nëse gruaja është në mensturacione ose në lehoni. Kjo është prej nderimit të njeriut që ia ka bërë All-llahu i Latmadhëruar ku thotë: **”Ne i kemi nderuar bijte e Ademit”**. Ne hadithin në vijim e verteton Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] se besimtari është i pastër edhe nuk bëhet i papastër.

Transmeton Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të] se Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] e ka takuar atë në një rrugë të Medines kur ai ka qenë i papastër(xhunub) dhe tha: u fsheha prej tij dhe shkova u pastrova pastaj erdha dhe me tha: ku shkove o Eba Hurejra? Tha: isha i papastër dhe nuk desha të rrij ulet me ty dhe une duke qene i papaster. tha: ”i lartësuar është All-llahu me vertete besimtari nuk bëhet i papastër”.

### Dobitë e hadithit:

- Besimtari është i pastër: ka qenë prej traditës së Pejgamberit [salallahu alejhi ve selem] që kur e ka taku ndonjërin prej shokëve të tij e ka përshëndetë për dore dhe ka bërë lutje për të. Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të] është frikuar të përshendet dorën e ndershme të Pejgamberit [salallahu alejhi ve selem] duke qenë xhunub(i papaster) dhe ka shpejtuar për tu pastruar, për këtë arsye Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] ia mohoi Ebu Hurejres këtë bindje se është i papaster nëse është xhunub e jo fjalën e tij, nuk desha me u ul pa u pastru, sepse me ndejt me dikënd duke qenë i pastër është e preferuar.

Kuptimi se besimtari nuk është i papastër është se ai është i paster në trupin e tij, jargët e tij, djersa e tij, uji çka ngel(pasi te pin prej gotes), lotët e tij, edhe jobesimtari e ka dispozitën e njejtë sikur besimtari.

E sa i përket fjalës së All-llahut të Lartësuar: **”Me të vërtet mushrikat(jobesimtare)t janë të papaster”**, shumica e dijetarëve thone: nuk është për qëllim papastërtia e trupave të tyre mirëpo është për qëllim papastërtia e besimit, për këtë arsye e ka lidhur Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] një rrob jobesimtar në

xhami,dhe e ka lejuar All-llahu ushqimin e pasuesve të librit.  
Shumica e dijetareve kanë thënë :është përmendur veçant besimtari sepse ai është që çdoher largohet nga papastërtia,ndersa jobesimtari nuk rruhet nga papastërtia.

- Preferohet respektimi i njerëzve me vlerë,dhe nderimi i tyre. Kanë preferuar dijetarët që nxënësi i diturisë të jetë në formë më të mirë kur e kërkon diturinë, i paster, i regulluar, thonjtë e prerë, erë të këndshme qe mos të i pengon mësuesit të vetë dhe shokëve të tij.
- Lejohet që të vonohet pastrimi prej kohës së parë të obligueshmëris.
- Lejohet që xhunubi(i papasteri)të i kryen disa nga nevojat e tij para se të pastrohet.
- Afrimi i zemrave të besimtarëve dhe modestia për hir të All-llahut.

## Hadithi nr.13: Këshillimi i të Dërguarit [salallahu alejhi ve selem] ndaj grave

---

Prej kujdesit të Islamit është edhe mësimi i gruas dhe dhënia e të drejtave të saj.

Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] i këshillonte gratë me fjalë të përshtatshme. Një herë ua patë caktuar një mbledhje të veçantë atyre, pasi që ato e kërkuan një gjë të tillë dhe i mësonte ato nga ajo që e kishte mësuar Allahu. Nga mënyra e urtë e tij e të mësuarit ka qenë se ai i ka këshilluar në mënyrë të rreptë, gjithmonë këshillat e tij janë dedikuar në shumës që më lehtë t'i pranojnë dhe të nënshtrohen. Në vijim do të japim një nga këshillat e tij:

Transmetohet nga Ebu Seid el Hudriu [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: Doli Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] në festën e Kurban Bajramit apo të Fitër Bajramit dhe kaloi nga gratë të cilëve u tha: *“O ju gra, jepni lëmoshë se unë e kam parë që shumica e banorëve të zjarrit janë prej jush (grave).”* Ato thanë: *“Përse, o i dërguari i Allahut?”* Tha: *“Mallkoni shumë, e mohoni afërsinë, nuk kam parë më të mangëta në fe dhe në mendje, dhe më së shumti që ia merr mendjen njeriut jeni ju.”* Ata thane: *“E çfarë është mangësia e mendjes dhe fesë tonë?”* Tha: *“A nuk është se dëshmia e gruas është sa gjysma e dëshmisë së burrit?”* Ato thane: *“Gjithësesi.”* Ai tha: *“Kjo është nga mangësia e saj. E kur të jetë në menstruacione ndonjëra nuk falet apo nuk agjëron?”* Thanë: *“Gjithësesi.”* Tha: *“Kjo është mangësia e fesë së saj.”*

### Dobitë e hadithit:

- Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] i ka nxitur gratë që të japin lëmoshë, sepse ajo i shlyen shumë mëkate. Lidhur me këtë ka transmetohet në librin Sahih të Tirmidhiut se Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] ka thënë: *“Lëmosha e shlyen gabimin sikur që uji e fikë zjarrin.”*

Shkaqet përse gratë janë banorë të zjarrit:

1. Mallkimi i tepërt, gjë që është largim dhe dëbim nga mëshira e Allahut të lartësuar dhe, njëherit, është edhe nga mangësitë e këqija të gjuhës, qoftë ndaj kafshëve apo njerëzve. Ka thënë pejgamberi [salallahu alejhi ve



selem]: *“Besimtari nuk është mallkues.”* Nga kjo kuptojmë se mallkimi është i ndaluar fetarisht përveç kush bën vepra që e largojnë nga Allahu, sikurse mohimi (kufri), padrejtësia. Në këtë rast është kusht të mos përvetësohet, por të thuhet: *“Mallkimi I Allahut qoftë mbi mohuesin ose mbi të padrejtin.”* Ndërkaq, në sahihun e Muslimit transmetohet se pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] ka thënë: *“Mallkuesit nuk bëhen as ndërmjetësues, as shehidë në Ditën e Kijametit.”*

2. Mohimi i afërsisë, gjë që, poashtu është zakon te gratë. Ato i mbulojnë të mirat e burrit dhe e mohojnë afërsinë. Ndërsa në hadith qëndron kështu: *“Nëse i bën mirë ndonjëres tërë kohën dhe sheh diçka prej teje, thotë se nuk ka parë prej teje mirësi asnjëherë.”* Prej bazave të Isamit është se mohimi i mirësive është e ndaluar, sepse është mohim i dhuruesit (Allahut) dhe mbulim i dhuntisë. Thotë Allahu i lartësuar: ***“Nëse falënderoni, ua shtoj, ndërsa nëse mohoni, dënimi im është i dhembshëm.”***

3. Humbja e mendjes së burrit. Gruaja ka ndikim te burri, deri në atë nivel sa që burri i bëhet rob asaj me vepër ose fjalë, gjë që nuk lejohet sipas fesë. Ky ndikim shtohet kur burri është i nënshtruar ndaj epsheve, gjë që e shohim në kohën tonë ku gruaja është drejtuese e çështjeve të burrave në mënyrë të paparë. Të vërtetën e ka thënë i dërguari i Allahut: *“Pas vdekjes time nuk kam lënë ndonjë provë më të madhe për burrat se sa sprova e gruas.”* Gruaja e cila është shkak që burri i saj të bie në gabime, mëkate dhe t’ia humbë atij mendjen, padyshim se edhe ajo ka një pjesë të mëkatit . Nëse burri i vendosur, ndonjëherë, u nënshtrohet grave, atëherë ai që është i pavendosur iu nënshtrohet krejtësisht dhe qorrazi.

- Mendja e mangët e grave. Në këtë çështje Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem]u ka përgjigjur në proporcion me atë që shkruan në librin e Allahut, ku flitet se dëshmia e dy grave është sa dëshmia e një burri, kur bëhet fjalë për borxh. Kjo ndodhë për shkak të largimit të saj nga këto kontrata ndërmjet njerëzve, sepse ajo është e angazhuar me diçka tjetër dhe se ajo ndikohet shumë nga ndjenjat, ndërsa dëshmia duhet të jetë e dhënë nga mendja e pavarur nga ndjenjat. Ne mund të themi se gruaja është qenie njerëzore sikurse burri. Në këtë aspekt gratë shpeshherë ua tejkalojnë burrave. Por mangësia në mendje që e ka cekur pejgamberi s.a.u.s. është në mendjen e përfutur ose është e angazhuar me çështjet e jetës së saj .
- Mangësia e fesë së saj, ka thënë i dërguari i Allahut, qëndron në atë se kur është në menstruacione nuk falet dhe nuk agjëron. Është e

ditur se ajo e kompenzon agjërimin, mirëpo jo edhe namazin, dhe pa dyshim se lënia e namazit ia pakëson shpërblimin asaj. Imam Neveviu ka thënë: “Mangësia e grave në fe është çështje relative, p.sh. I ploti është më i mangët se i përsosuri, dhe ajo që është me menstruacione e nuk fal namaz nuk ka mëkat, por është më e mangët se ai që falet. ”

- Hadithi tregon se lejohet të falet namazi i bajramit në hapësirë
- Gratë mund të prezentojnë në namazin e Bajramit, mirëpo të ndara nga burat
- Të lejuarit e këshillimit të grave
- Mohimi i mirësive dhe përdorimi i fjalëve fyese janë të ndaluara sikurse mallkimi dhe ofendimi
- Mendja shtohet dhe pakësohet sikurse edhe besimi
- Lëmosha e shuan hidhërimin dhe i shlyen mëkatet.

## Hadithi nr.14: Pastrimi nga mensturacionet

---

Allahu i mëshiroftë gratë e ensarëve (banorët e Medinës) të cilat nuk i ka ndaluar turpi që ta mësojnë fenë e tyre, kanë prezentuar në vendet e diturisë, dhe e kanë pyetur të Dërguarin e Allahut [salallahu alejhi ve selem] për çështjet e grave që normal turp kanë njerëzit të pyesin. Në hadithin në vijim pyet një grua nga ensarët për mënyrën e pastrimit prej menstruacioneve që t'i ketë të qarta rregullat e fesë dhe të adhurimit:

Transmeton Aisheja [Allahu qoftë i kënaqur me të] se një grua e ka pyetur të Dërguarin e Allahut [salallahu alejhi ve selem] për mënyrën e pastrimit prej menstruacioneve, dhe i tregoi Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] duke i thënë : "merr një copë arne të lyer me parfum dhe pastrohu me atë. Tha: si të pastrohem me atë? Tha:"i lartësuar qoftë Allahu(subhanallah)pastrohu". Aishja [Allahu qoftë i kënaqur me të] e afrova kah vetja dhe i thashë:pastroje me atë vendin e gjakut.

### **Dobitë e hadithit:**

- Preferueshmëria e lyerjes me parfum pas pastrimit nga menstruacionet: është e preferuar që ti i lyen me parfum të gjitha ato vendet e trupit të saj që i ka prekur gjaku, është për qëllim në përdorimin e parfumit largimi i aromës së keqe, dhe është e papëlqyer për atë që ka mundësi ta lër atë. (lyerjen me parfum në vendet ku prek gjaku menstruacioneve)
- Preferohet që të përdoren fjalë alegorike kur bëhet fjalë për sende të turpshme.
- Pyet gruaja dijetarin për çështjet e saja që njerëzit kanë turp të pyesin, për këtë arsye tha Aishja [Allahu qoftë i kënaqur me të]: sa gra të mira janë gratë e ensarëve, nuk i ka ndaluar turpi që ta mësojnë fenë.
- Përsëritja e përgjigjes për të kuptuar pyetësi, e ka përsëritur i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] të njëjtën përgjigje sepse ajo nuk e kuptoi me herën e parë, sepse këtë përgjigje kur ia dha Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] ka qenë me shpinën e kthyer ka ajo gruaja, kur ka thënë: "pastrohu" e ka pas për qëllim në vendin të cilin i ka ardhur turp ta përmend direkt dhe ka mjaftuar me përmendjen e gjendjes pa e përmendur vendin. E ka kuptuar Aishja [Allahu qoftë i kënaqur me të]. këtë nga ai dhe ia ka mësuar asaj gruas.

- Spjegimi i fjalës së dijetarit për atë që nuk e kupton, nëse e din që kjo i pëlqen atij. (dijetarit)
- Turpi nga ai që ka më pak dituri kur është prezent ai që ka më shumë.
- Butësia me nxënësin dhe arsyetimi i atij që nuk kupton.
- Tregon hadithi për sjelljen e mirë të peygamberit dhe turpin e tij dhe kujdesin e tij.

## Hadithi nr.15: Vecorit e të Dërguarit [salallahu alejhi ve selem]

---

Nuk ka divergjenc se Pejgamberi i Allahut Muhamedi [salallahu alejhi ve selem] është njeriu më i ndershëm nga të gjithë njerëzit dhe zotëriu i bijve të Ademit alejhi selam dhe njeriu më me vlerë tek Allahu dhe më i Larti. Allahu atë e ka veçuar me disa veçori që nuk ia ka dhënë askujt para atij as që do ti ketë dikush pas tij. Në hadithin në vazhdim i përmend i Dërguari [salallahu alejhi ve selem]. pesë nga veçoritë që ia ka dhuruar Allahu atij:

Transmeton nga Xhabir ibn Abdullahu[Allahu qoftë i kënaqur me të] se i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] ka thënë: "më janë dhuruar pesë gjëra që nuk iu kanë dhuruar ndokujt para meje: jam ndihmuar me frikë (ndaj armiqve para se të arrij në betejë) një muaj para, më është bërë toka xhami dhe pastrim dhe cilindo njeri që e arrin koha e namazit le të falet, më janë lejuar plaçkat e luftës e që nuk iu kanë lejuar askujt para meje, më është dhënë ndërmjetsimi, pejgamberët dërgoheshin vetëm te populli i vet e unë jam e dërguar tek gjithë njerëzimi".

### Dobitë e hadithit:

- Sqarimi i vlerës së të Dërguarit [Allahu qoftë i kënaqur me të] a.s. mbi të dërguarit tjerë dhe gjithpërfshirja e mesazhit të tij, ka thënë All-llahu i lartësuar: **"nuk të kemi dërguar për gjithë njerëzit vetëmse përgëzues dhe qortues"**.
- Lejimi i pastrimit (tejemumit) me dhe në tërë tokën, thotë pejgamberi [Allahu qoftë i kënaqur me të]: "më është bërë mua dhe pasuesve të mi e tërë toka xhamij dhe pastrim". për këtë lejohet pastrimi me dhe (tejemumi) të pastër dhe me çdo send që i përngjason dheut si: zalli, guri, gipsi.  
Ka thënë Allahu: **"pastrohuni me dhe të pastërt"** është për qëllim fytyra e tokës qoftë dhe apo diçka tjetër, kështu kanë thënë dijetarët e medhhebit hanefij.
- Veçimi i Pejgamberit [Allahu qoftë i kënaqur me të] edhe me veçori tjera përveç këtyre pesë veçorive. Kush i shfleton librat e hadithit do të vëren se Pejgamberi [Allahu qoftë i kënaqur me të] është i veçuar

edhe me tjera veçori përveç këtyre pesë saqë ibn Haxher el Askalani i ka përmendur shtatëmbëdhjetë cilësi,dhe ai ka thënë:mundet të ketë ende nëse dikush thellohet në lexim.dhe ato cilësi tjera të Pejgamberit [Allahu qoftë i kënaqur me të] që nuk janë përmendur në këtë hadith janë:ka thënë fjalë me shumë kuptime,është vula e pejgamberëve,është emërtuar Ahmed,pasuesit e tij janë populli më i mirë ndër popujt tjerë,i është dhënë lumi keuther...etj.

- Në këtë hadith ka dobi të shumta,prej tyre:
  - a) Lejohet me i përmend të mirat e Allahut duke pohu mirësitë e Allahut e jo duke u lavdëruar.
  - b) Toka në esencë është e pastërt.
  - c) Pranimi i namazit nuk është i kushtëzuar vetëm në xhami.
  - d) Lejimi i thënies së diturisë pa u pyetur.

## Hadithi nr.16: Ndalimi i pështyerjes në anen e kibles (Qabes)

---

Kibleja është xhamia e shenjtë e qabes të cilën e ka rindërtuar Ibrahim alejhi selam dhe e ka pastruar për adhurim. Ajo është për të cilën shkojnë miliona musliman dhe drejtohen kah ajo gjatë namazit të tyre që d.m.th.kthim kah Allahu dhe kërkimi prej Tij.d.m.th. kthimi i Allahut drejt robit të Tij në namaz. Ka thënë i Dërguari [Allahu qoftë i kënaqur me të]: "Allahu është i kthyer kah robi i tij kur është në namaz derisa robi nuk anon anash". Në hadithin në vijim na e mëson i Dërguari [Allahu qoftë i kënaqur me të] respektimin e kibles dhe na ndalon që të pështymë drejt saj.

Transmetohet nga Enesi [Allahu qoftë i kënaqur me të] se i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] ka parë një shkëlbazë(pështymë) në drejtim të kibles dhe kjo i erdh rëndë atij deri sa u vërejt në fytyrën e tij, u ngrit dhe e fshiu me dorën e tij dhe tha: "kur dikush nga ju ngritet të falet ai i flet Zotit, Zoti është ndërmjet atij dhe kibles prandaj mos pështyni drejt kiblës mirëpo kah ana e majt e tij ose nën këmbë".

### **Dobitë e hadithit:**

- Ndalesë e pështyrjes në drejtim të kibles ose kah ana e djathtë:hadithi na ka mësuar ndalesën që vlen kur është njeriu në namaz,është transmentuar ndalesa nga ebu Hurejra dhe ebu Seidi se: i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] ka parë një shkëlbazë në murin e xhamisë dhe e ka marrë një gurë dhe e ka pastruar atë,dhe ka thënë:"kur te pështyn dikush mos të pështyn përpara fytyrës së vetë as nga ana e djathtë por le të pështyn kah ana e majtë ose nën këmbën e majtë".

Imam Neveviu ka thënë se ndalesa është e përgjithshme si mbrenda në namaz ashtu edhe jashtë namazit,dhe këtë e argumentojnë disa hadithe ku thuhet:"kush pështyn në drejtim të kibles ditën e kiametit do ta ketë pështymën në mes të syve të tij".gjithashtu ka thënë:"ai që pështyn kah kibleja do të ringjallet ditën e kijametit dhe ajo është në fytyrën e tij".

Sikur pështyma kah kibleja gjithashtu edhe pështyma kah ana e djathtë është e ndaluar.Transmetohet nga Abdullah ibn Mes'udi [Allahu qoftë i kënaqur me të]se ai nuk e ka pëlqyer të pështyn kah ana e djathtë dhe nëse nuk ka qenë në namaz.Transmetohet nga

Muadh ibn Xhebeli [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë:nuk kam pështyrë kah ana e djathtë prej kur kam hyrë në islam.

- Pështyma në xhami: është e urryer që të pështyhet në xhami rreptësisht(mekruh tahrim),qoftë në muret e xhamisë apo në tokë apo në tepih apo nën tepih,nesë pështyn e ka obligim ta pastron atë,dhe nuk ka dallim se a është toka e xhamisë me dhe apo e shtruar me tepih apo me keramik.
- Rrespekti ndaj kiblës sepse ajo është kthimi i namazliut kah Allahu.
- Pastrimi i xhamisë nga pështyma,shkël baza dhe të ngjajshme.
- Ndalohet të pështyhet kah ana e djathtë për shkak te vlerës që e ka ana e djathtë.
- Obligueshmëria e përcjelljes së gjendjes se çka ndodhë në xhami,dhe kujdesi i përbashkët nga prijësi dhe njerëzit e rëndomtë për pastrimin e xhamis.
- Zemërimi për shkeljen e normave të Islamit është prej shenjave të besimit.



## Hadithi nr.17: Kalimi para falësit është mëkat

---

Falësi kthehet kah ana e shtëpisë së Allahut të lartësuar dhe ai e lutë Allahun dhe lypën prej Tij dhe kërkon falje prandaj nuk bën të kalohet para fytyrës së tij sepse ai është drejtuar me zemër dhe trup drejt kibles dhe sikurse ai flet me Allahun e lartësuar. Ndalohet kalimi përpara atij sepse e ndalon këtë kënaqësi të qëndrimit para Allahut të lartësuar, dhe kjo tregon për sjelljen e keqe të atij që kalon përpara atij që falet.

Transmetohet nga Ebi Xhuhejm [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: ka thënë Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem]: "nëse e din ai që kalon para duarve të atij që falet se çfarë mëkati bën më mirë kishte me qenë për atë të priste aty katërdhjetë se sa të kalon,ka thënë transmentuesi:nuk e dij a ka thënë katërdhjetë ditë apo muaj apo vite.

### Dobitë e hadithit:

- Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem]është shembëlltyrë: Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] kur është falur,ka marrë sutre(pengesë)ndërmjet atij dhe kibles, p.sh.:ka urdheruar që të vëndohet një shtizë dhe ai është falur pas saj e njerëzit u faleshin pas tij, këtë e bënte në udhëtim ose ndonjëherë vendoste para tij diçka të ngjajshme me shtizën si shkop apo diçka tjetër.
- Rregullat e pengesës(sutres):
  - a) Vendosja e pengesës në namaz është e pëlqyer,ka thënë Ibrahim en Nehaiu: kur faleshim në shkretëtirë e pëlqenin që të vendosin pengesë para tyre.
  - b) Sa është hapësira që nuk bën të kalosh para atij që falet,kanë thënë dijetarët: vetëm vendi ku ai bën sexhde,d.m.th.një metër,dhe ka që kanë thënë:dy rradhë(safe) ose tri.
  - c) Ai që falet në hapësir preferohet që të merrë sutre ndonjë shkop apo të ngjajshme dhe ta vendos në tokë vertikalisht nëse është toka e butë e nëse është e fortë e shtrin atë drejt sepse në hapësirë mund të kalon dikush para atij që falet.
  - d) Nëse vendos pengesë e vendos pak në të djatht ose pak në të majtë dhe nuk i del para në ball.Transmetohet nga Mikdad ibn Esvedi [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë:çdoherë që e kam parë Pejgamberin [salallahu alejhi ve selem] duke u falur kah ndonjë shkop apo

shtyllë apo dru çdoherë i ka dalë pak anash ose ka e djathta ose ka ana e majtë dhe nuk i ka dalë në ball. Transmeton Ebu Davudi.

e) Nëse imami ka marrë pengesë atëherë njerëzit pas tij (xhemati) nuk kanë nevojë të marrin pengesa sepse pengesa e imamit është pengesë për ata dhe nuk prish punë nëse kalon dikush para tyre.

f) I lejohet atij që falet që ta shtyn ngadalë (butë) atë që donë të i kalon para duarve: duke e mbrojtur atë që mos të bën mëkatin e atij që kalon para atij që falet, Transmetohet nga Ebu Seid el Hudriu [Allahu qoftë i kënaqur me të] se Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] ka thënë: "kur të falet dikush nga ju kah ndonjë pengesë dhe donë ndonjë të kalon le ta pengon atë e nëse nuk largohet le ta lufton atë sepse ai është djall". Transmeton Buhariu. Ka thënë imam Neveviu r.h.: në spegimin e fjalës "le ta largon" është për lejimin e veprës e nuk dihet nga dijetarët që e ka obliguar një gjë të tillë. Bëhet ndalesa me shenjë nëse është kaluesi larg dhe po afrohet dhe me përmendje të Allahut (subhanallah më thënë) nëse është afër e nëse as kjo nuk kryen punë ia vendon dorën para me butësi, ka prej dijetarëve që ka thënë me forcë.

- Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] thotë që të kemi kujdes nga kalimi para atij që falet që të largohet muslimani nga kjo vepër, dhe thotë transentuesi i hadithit nuk e dihet a ka thënë katërdhjetë ditë apo muaj apo vite. Mëkatin e merrë ai i cili e din ndalesën dhe e bën atë sepse pejgamberi a.s. ka thënë: "nëse e din" dhe gjithashtu e ka kërcnuar atë i cili ulet apo shtrihet apo ndalet para atij që falet dhe ka për qëllim që ti pengon atij.
- Muslimani duhet të largohet nga ajo që Allahu e ka bërë të ndaluar sa ka mundësi.
- Nuk ka të keqe nëse e zmadhon një gjë nëse e kërkon nevoja, kjo nuk llogaritet gënjeshtërisht.

## Hadithi nr.18: Nxitja për faljen e namazit të sabahut

---

Ka nxitur i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] për faljen e namazit të sabahut në kohën e vet, dhe ka përgëzuar se kush e bën këtë do të shpëton nga zjarri. Transmeton Muslimi se i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] ka thënë: "nuk do të hyn në zjarr ai që falet para lindjes së diellit dhe para perëndimit të tij" d.m.th.namazi i sabahut dhe i ikindisë. Në hadithin në vijim Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] nxit në mënyrë më aktive dhe efektive.

Transmeton Xherir ibn Abdullahu [Allahu qoftë i kënaqur me të] dhe tha: kemi qenë me Pejgamberin [Allahu qoftë i kënaqur me të] një natë prej netëve dhe ai shiqoi kah hëna dhe tha: ju do ta shiqoni Zotin tuaj sikur e shihni këtë hënë pa u lënduar në pamjen e tij, nëse mundeni që mos të ju ikë namazi para lindjes së diellit dhe para perëndimit të tij mos e leni atë. pastaj lexoi: "**përmende Zotin tënd me falënderim para lindjes diellit dhe para perëndimit**"

### Dobitë e hadithit:

- Shiqimi i Allahut: besimtarët do ta shiqojnë Zotin në xhennet kjo është çështje e prerë.Këtë e argumenton Kurani famëlartë ku thotë i lartësuar:"**atë ditë ka fytyra të ndritshme që shiqojnë kah Zoti i tyre**"el Kijame 22,23. Gjithashtu edhe hadithet e të dërguarit e argumentojnë,është transmentuar kjo çështje nga më shumë se njëzet persona prej shokëve të pejgamberit, prej tyre:Ebu Bekri,Aliu,Muadhi,Abdullah ibn Mesudi,ebu Musa el Eshariu,Abdullah ibn Omeri etj. Ka konsenzus të shokëve të Pejgamberit [Allahu qoftë i kënaqur me të] për këtë çështje prandaj nuk ka as dyshim as hamendje dhe nuk është çështje e jona që të flasim shumë për mënyrën e shiqimit,sepse kjo çështje është prej çështjeve të botës së ardhshme. Por prej çështjeve tona është që ta dijmë se shiqimi nuk është sikur shiqimi jonë njëri me tjetrin që mund me e ngërthy me shiqim sepse Allahu ka thënë për veten e Tij:"**nuk është askush sikur Ai,Ai është ndëgjuesi,shiquesi**"ajo që qëndron në këtë hadith është se përngjason shiqimi me shiqim e jo përngjasimi i atij që shiqohet.Ky shiqim është i veçantë për besimtarët dhe i ndaluar për jobesimtarët dhe dyfyrshat,ka thënë Allahu i lartësuar për këtë çështje:"**jo,atë ditë ata do të jenë të penguar nga shiqimi i Zotit**"sureja el Mutafifin 15.

- Vlera e namazit të sabahut dhe të ikindisë: namazi i sabahut është namazi i parë kush e falë atë me xhematë ai e ka shperblimin sikur me u fal tërë natën,dhe ky namaz është që prezentojnë në të melaiiket,ka thënë Allahu i lartësuar:” **dhe kurani i mëngjesit me të vërtetë kurani(namazi)i mëngjesit është i dëshmuar**”.  
Koha e namazit të sabahut është koha e qetësis dhe qetësimit dhe disa njerëz flejnë në këtë kohë,ku e ka vërtetuar i dërguari në ezanin e tij që në të thuhet namazi është më i vlefshëm se gjumi.  
Namazi i ikindisë është namazi i mesëm i ditës,na ka treguar Allahu i lartësuar për rëndësinë e tij ku ka thënë:”**keni kujdes për namazet edhe për namazin e mesëm**”.
- Namazi i ikindisë është në kohën kur njerëzit punojnë apo koha e vizitave Pejgamberi [Allahu qoftë i kënaqur me të] i ka dhënë vlerë faljes së tij sepse namazi është puna më e mirë që e bën njeriu i cili shpreson në takimin me Allahun dhe shpreson kënaqësinë e Tij.
- Kujdesi ndaj mirësive: ka nxitur i Dërguari [Allahu qoftë i kënaqur me të] që të kërkojmë mirësi me fjalën e tij efektive ku tha:”nëse mundeni që mos të ju ikë namazi”.në këto fjalë ka aktivizim të vullnetit,dhe forcim i dëshirës,thotë Allahu:”**edhe për këtë le të bëjnë gara garusit**”.
- Tregon hadithi se mësuesi duhet të bjen shembuj për sqarimin dhe shtjellimin e disa çështjeve.
- Shiqimi i Allahut nga besimtarët në xhennet është një e vërtetë që nuk ka dyshim në të dhe është kënaqësi që i bën të harrojnë çdo kënaqësi tjetër.
- Namazi i sabahut dhe i ikindisë janë ata namaze në të cilët prezentojnë engjujt.
- Obligueshmëria e kujdesit ndaj frikërespektit ndaj Allahut dhe veprimi i obligimeve fetare,më shumë se sa diçka tjetër.
- Bazat e argumentimit janë kur’ani dhe sunneti.

## Hadithi nr.19: Vlera e namazliut tek All-llahu

---

Besimtarët që falin namazin kanë pozitë dhe vlerë tek Allahu. Allahu ka nënshtruar engjij që përkujdesen për besimtarët që mos i godasë ndonjë e keqe, ka thënë Allahu në Kuranin fisnik: **"besimtari ka engjij para tij dhe prapa tij që e mbrojnë nga çdo gjë"** gjithashtu Allahu e ka bërë që adhurimi i disa engjijve të jetë lutja për besimtarët, ka thënë Allahu: **"e falenderojnë Allahun me përmendjen e Tij dhe i besojnë Atij, dhe kërkojnë falje për besimtarët..."**. në hadithin në vijim pejgamberi i cek disa mënyra tjera të vlerës së besimtarit tek Allahu:

Transmetohet nga Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të] se i dërguari [salallahu alejhi ve selem]ka thënë: "engjujt e natës dhe engjujt e ditës ndrojnë pozitën e tyre dhe takohen në namazin e sabahut dhe namazin e ikindisë, pastaj ngriten lart ata që kanë qenë tek ju dhe i pyet All-llahu edhe pse Ai e din më mirë, si i latë robërit e Mi, ata thonë: i lamë duke u falur dhe i gjetëm duke u falur".

### Dobitë e hadithit:

- Ndrimi i engjëjve:vendbanimi i engjijve është qielli mirëpo ata zbresin në tokë me urdhërin e Allahut dhe me dëshirën e Tij,Allahu me urtësinë e Tij e ka bërë që engjujt të jenë dëshmitarët e Tij për veprat e besimtarëve,menyra e zbritjes së melekëve është:zbresin një grup melekësh në kohën e namazit të ikindisë dhe qëndrojnë në tokë,pastaj në kohën e namazit të sabahut zbritë edhe një grup tjetër dhe aty takohen,pastaj ngritet grupi që ka qëndruar gjatë natës dhe qëndrojnë grupi që ka zbritur në mëngjes deri në namazin e ikindisë,pastaj në ikindi zbritë një grup tjetër dhe takohen me ato të mëngjesit,në namazin e ikindisë pastaj ngriten ato që kanë zbritur në mëngjes dhe kështu vazhdon ndrimi i engjijve.
- Për vlerën dhe urtësinë e kujdesit ndaj namazit të sabahut dhe ikindisë u fol në hadithin e mëparshëm.
- Vlera e besimtarit tek Allahu i lartësuar:

a) Ju ka dhënë leje Allahu një grupi prej engjijve të luten për besimtarët ashtu siç kanë dëshirë ata,ka thënë i lartësuar:"**ata të cilët e mbajnë Arshin(fronin e Allahut)dhe ata që janë rreth tyre e falenderojnë Allahun me përmendjen e Tij edhe i besojnë Atij,dhe kërkojnë falje për besimtarët dhe thojnë:Zoti ynë sikur që ke kapluar çdo send me mëshirën Tënde dhe diturinë Tënde fali ata që pendohen dhe e pasojnë rrugën Tënde dhe mbroj nga dënimi i Zjarrit"** gjithashtu ka thënë:"dhe

**mbroj ata(besimtarët)nga të këqiat se kë e mbron Ti nga të këqiat me të vërtetë e ke mëshiruar,e ky është shpëtimi i qartë”.**

b) Allahu e ka bërë një grup prej engjujve që ti mbrojnë besimtarët derisa tu vijë caktimi i Allahut,ka thënë Allahu:”**besimtari ka engjuj para tij dhe prapa tij që e mbrojnë nga çdo gjë derisa të vjen caktimi i Allahut”.**

c) Allahu e ka bërë një grup engjujsh që shëtisin nëpër tokë dhe i kërkojnë vendet ku mësohet dituria apo lexohet kurani dhe mësohet kurani.

d) Gjithashtu e ka bërë një grup engjujsh që shëtisin nëpër tokë dhe ndëgjojnë se ku i dërgohet përshëndetje(salavat) pejgamberit[salallahu alejhi ve selem] që t’ia dërgojnë atij.

- Hadithi tregon që namazi është vepra më e madhe sepse për të i pyet Allahu engjujt.
- Aludimi në atë se namazi i sabahut dhe i ikindisë janë prej namazeve më të mëdha.
- Tregon hadithi për nderin e këtij populli(popullit të muhamedit)mbi popujt tjerë.

## Hadithi nr.20: Ezani

---

Muslimanët në Meke janë thirrur ndërmjet veti për namaz sepse i kanë pasur shtëpit afër dhe janë mbledhur në shtëpinë e Erkamit [Allahu qoftë i kënaqur me të] .Kur u shpërngulen në Medine dhe hynë në islam shumica e banorëve të saj u bë vështirë që të thirren për namaz përveç me ndonjë mjet të veçant dhe Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] u takua me shokët e tij që të bisedojnë për mënyrën e thirrjes së njerëzve në namaz.Prej këtu ja filloi ezani.

Transmeton Abdullah ibn Omeri [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: muslimanët tuboheshin dhe pritshin namazin derisa të hynte koha dhe nuk u thirrte për të, një ditë biseduan dhe tha njeri prej tyre ta bëjmë një kumbonë sikur e krishterëve, thanë disa të tjerë një bri sikur çifutët, tha Omeri [Allahu qoftë i kënaqur me të] pse nuk e bëjmë që njëri nga ne të thërras për namaz, tha Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem]: "ngritu o Bilal dhe thirr për namaz".

### Dobitë e hadithit:

- Namazi me xhemat :i obligoi Allahu i lartësuar pesë kohët e namazit në udhëtimin e të Dërguarit [salallahu alejhi ve selem] me trupin dhe shpirtin e tij prej Qabes deri në xhaminë Aksa pastaj deri në qiell në natën e Israsë dhe Miraxhit.Ditën e nesërme e mësoi Xhibrili alejhi selam të dërguarin për kohët e namazeve.Thu Allahu i lartësuar:"**me të vërtetë namazi për besimtarët është obligim i caktuar(në kohë)**".

Ka nxitur i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] për namazin me xhemat në shumë vende ku ka thënë:"kur njeriu falet në grup i shtohet shpërblimi më shumë se sa në shtëpinë e vet apo punën e vet njëzet e pesë herë më shumë" Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Gjithashtu ka thënë:"kush shkon të falet me grup(xhemat)çdo hap që e bën i fshihet nga një e keqe dhe i shkruhet nga një shpërblim kur shkon dhe kur kthehet".Transmeton imam Ahmedi dhe Taberaniu.

Gjithashtu ka thënë:"a të ju tregoj se çka i fshin mëkatet dhe i ngrit shkallët(në xhenet)thanë:gjithsesi o i Dërguar,tha:"marrja e abdestit kur është vështirë,shpeshtimi i shkuarjes në xhami,pritja e namazit deri në

namazin tjetër,kjo është roja në rrug të Allahut,kjo është roja në rrug të Allahut, kjo është roja në rrug të Allahut”.Transmeton Muslimi.

- I dërguari i Allahut [salallahu alejhi ve selem] e urrejti i që të merr mjete të kopjuara apo të devijuara për thirrjen e njerëzve për namaz,për këtë arsye na e lejoi neve Allahu ezanin.Këtë thirrje madhështore që thërritet pesë herë në ditë anekënd botës duke thirrur për adhurimin që e meriton Allahu i vërtetë. Dhe dëshmia e vërtetë për pejgamberinë e Muhamedit [salallahu alejhi ve selem] dhe lajmerimi për islamin e vërtetë dhe thirrje për veprën më të mirë.E urrejti që ta merr jetën e dikuj tjetër shembull përveç besimtarëve.Tha i dërguari:”kush i përngjason një populli ai është sikur ata”.Transmetoin Ahmedi.  
Duhet të dallohet besimtari me besimin e tij,adhurimin e tij,sjelljen ,moralin ,ndjenjat , veshjen e tij,pamjen e tij si dhe qëllimin e jetës së tij.

- Ezani:

a) Transmetohet nga njëri prej ensarëve se ka thënë: dëshiroj i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] që ti mbledh njerëzit për namaz dhe i thanë që të ngrit një flamur kur të afrohet namazi,e kur ta shofin njerëzit e thërrasin njëri tjetrin mirëpo nuk i pëlqej kjo,iu përmend edhe briri por nuk i pëlqeu tha është prej çifutëve,iu cek edhe kumbona tha jo ajo është prej krishterëve. Abdullah ibn Zejdi [Allahu qoftë i kënaqur me të] e pa në ëndër ezanin dhe shkoi te i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] i tregoi dhe i tha: tek sa isha duke fjetur më erdh një njeri dhe më tregoi ezanin, ndërsa Omeri [Allahu qoftë i kënaqur me të] kishte parë këtë ëndër më herët por e kishte mbajtur fshehur,pastaj ia tregoi të dërguarit të Allahut [salallahu alejhi ve selem] e i tha:”pse nuk na ke treguar më herët” tha ma kaloi Abdulla ibn Zejdi e më erdh turp dhe tha i Dërguari [salallahu alejhi ve selem]:”ngritu o Bilal shiko çka të urdhëron Abdullah ibn Zejdi ashtu bën”dhe e dha ezanin Bilali. Transmeton Ebu Davudi.

b) Ezani është simbol i islamit dhe traditë e tij,ka nxitë i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] për ezan dhe ka thënë:”tre personave ju ofrohet parfumi-ditën e kiametit që i kanë lakmi krejt të parët dhe të mbramët:një rob që e plotëson obligimin ndaj Zotit të vet dhe ndaj pronarit të vet,një imam që i fal popullin dhe ata janë të kënaqur me atë dhe një njeri që e jep ezanin për namaz ditën dhe natën”Transmeton Tirmidhiu.



c) Mënyra e ezanit është e njohur dhe e ditur, fjalët e ezanit janë të transmetuara nga i Dërguari i Allahut [salallahu alejhi ve selem] dhe duhet që patjetër të këndohet ezani.

d) Preferohet që kush e ndëgjon ezanin të thotë sikur thotë thirrësi kur të kryhet të dërgon përshëndetje për të dërguarin dhe të bën lutje dhe të bën lutjen e ezanit dhe ta shqiptojë dëshminë (shehadetin) dhe të thotë jam i kënaqur me Allahun për Zot, me islamin për fe dhe me Muhamedin të dërguar. Ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem]: "kur ta ndëgjoni thirrësin (muezinin) thoni siç thotë pastaj më dërgoni mua përshëndetje (salavat) se kush më dërgon mua përshëndetje i dërgon atij Allahu dhjetë herë përshëndetje, kërkoni që të më jepet mua vesile (vend në xhenet) sepse ajo është vendi im në xhenet dhe aty nuk mund të hyj vetëmse një prej robërve të Allahut dhe shpresoj që të jem unë ai dhe kush kërkon për mua të më jipet vesileja iu ka lejuar apo iu ka obliguar ndërmjetesimi im (ditën e kijametit)". Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Lutja e vesiles është kështu: o Zoti kësaj thirrje të plote, dhe Zot i namazit që për të thirret ezani, jepja Muhamedit vesilen (vend në xhenet) dhe meritat dhe ringjalle në vendin e lavdëruar, që ia ke premtuar". Transmeton Buhariu dhe Muslimi. Gjithashtu ka thënë: "kush thotë kur ta ndëgjon ezanin dëshmoj se nuk ka të adhuruar me meritë përveç Allahut dhe nuk i bëj ortakllëk Atij, dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij, jam i kënaqur me Allahun për Zot, dhe me islamin për fe dhe me Muhamedi për të dërguar, ia falë Allahu atij mëkatet". Transmeton Muslimi.

- Hadithi tregon që muslimani duhet të dallohet me personalitetin e tij fetarë islam sepse islami e kërkon një gjë të tillë dhe nxitë në të.

## Hadithi nr.21: Vlera e ezanit dhe e reshtit të parë në namaz

---

Garimi në vepra të mira është prej shenjave të besimit, ata që garojnë në mirësi e meritojnë që Allahu t'i ngritë, në hadithin në vijim udhëzon i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] popullin e vet për kah mirësia dhe vlerat.

Transmetohet nga Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të] se i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] ka thënë: "nëse e dinë njerëzit vlerën e ezanit dhe të rradhës së parë(në xhami) pastaj nuk mund të dakordohet vetëmse më short do të kishin bërë short, nëse e dinë vlerën e shkuarjes herët në xhami do të garoshin, nëse e dinë çfarë vlere ka namazi i jacisë dhe i mëngjesit do të vishin zhagas".

### **Dobitë e hadithit:**

- Feja islame ka nxitur për rreshtat e para në namaz,sepse ato që qëndrojnë në safet e para shkojnë herët në xhami,dhe se engjujt luten për imamin edhe për rreshtin e parë pas imamit, pastaj për ata që janë në anën e djathtë të rreshtit parë, pastaj për ata që janë në anën e majtë të rreshtit parë ,pastaj për rreshtin e dytë e kështu me rradhë.

a) Ka thënë i Dërguari [salallahu alejhi ve selem]:"rreshtat më të mirë për burrat janë rreshtat e parë,rreshtat më të mira për gratë janë rreshtat e fundit".Transmeton Muslimi.

b) Gjithashtu ka thënë:"le të qëndrojnë pas meje,të rriturit dhe të mençurit,pastaj tjerët pastaj tjerët".Transmeton Muslimi.

c) Drejtimi i rreshtave,mbushja e rreshtave dhe zbrastirave:ka thënë i derguari:"rregulloni rreshtat sepse rregullimi i rreshtave është prej plotësimit të namazit".Transmeton Buhariu dhe Muslimi. Mënyra e rregullimit të rreshtave është:drejtimi në një vij i themrave,mbushja e zbrastirave dhe mos lënia zbrastirave të vogla që të hyn djalli nëpër to.

Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] ka qenë i kujdesshëm për rregullimin e radheve ,ai thoshte:"drejtoni rradhët ofroheni sepse unë ju shiqoj pas shpine".Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

d) Plotësimi i rradhëve:kush sheh ndonjë zbrastirë përpara le ta plotëson duke ecur para edhe nëse është në namaz,ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem] :”kush e plotëson rradhën e ofron Allahu i lartësuar,kush e shkëput rradhën e shkëputë Allahu i lartësuar”.

- Kujdesi i të parëve për adhurimin:Transmeton Seid ibn Mensur Bejhekiu nga Abdullah ibn Shebreme [Allahu qoftë i kënaqur me të]se ka thënë:janë kacafitur njerëzit për ezan në luftën e Kadisijes dhe pastaj janë gjyku tek Sead ibn ebi Vekasi dhe ai bëri short ndërmjet tyre.
- Shkuarja herët në xhami :Thotë Allahu iLartësuar:”**garuesit,garuesit janë ata të ofruarit.**” garuesit janë ata që nxitojnë në adhurime sa më shumë sikur:namazi me xhematë,xhiahadi etj.nuk ka dyshim se shkuarja herët në xhami është kujdes për adhurimin për këtë na ka nxitur i dërguari për shkak të mirësisë që ka.
- Namazi i jacisë dhe mëngjesit me xhematë:këto dy namaze janë argumentet më të forta të sinqeritetit me Allahun,dhe janë dy namazet më të rënda për hipokritët dhe njerëzit e devijuar sepse ata flejnë në kohën e namazit të mëngjesit,a në kohën e jacisë janë në argëtim,dhe në këtë kohë si zakon nuk i shohin njerëzit,sepse ata në realitet dalin në xhami për syfaqësi dhe autoritet,dhe ka nxitur i dërguari për prezentim në këta dy namaze dhe ka thënë:kush e falë jacinë me grup(xhematë)ka shpërblimin sikur me u falë gjysën e natës,dhe kush e falë mëngjesin me grup sikur me u falë tërë natën”.Transmeton Muslimi. Sa pershkrim i mirë i të dërguarit për ata që prezentojnë në këta dy namaze me grup(xhematë)dhe nëse është me hec zhagas duke u munduar ta merr shpërblimin e madh të Allahut.
- Tregon hadithi për vlerën e madhe të thirrjes së ezanit.
- Vlera e namazit në grup dhe e shkuarjes herët në xhami.
- Nxitja për prezentimin në namazin e jacisë dhe të mëngjesit në xhami.

## Hadithi nr.22: Obligueshmëria e përcjelljes së imamit në namaz

---

Një qortim dhe kërcënim të rëndë e lëshon ai i cili nuk flet nga hamendja [salallahu alejhi ve selem] deri tek ai i cili nuk e përcjell imamin në namaz, mirëpo e tejkalon atë në ruku dhe sexhde duke e anashkalu këtë gjë.

Transmeton Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të] se i dërguari [salallahu alejhi ve selem] ka thënë: "a nuk frikohet dikush nga ju që kur ta ngren kokën e tij para kokës imamit që All-llahu të ia shëndron atij fytyrën në fytyrë gomari apo pamjen e tij në pamje gomari".

### Dobitë e hadithit:

- Pasimi i imamit: ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem]:"është bërë imami(në namaz)që të pasohet"padyshim që bukuria e namazit është kur imami të shkon përpara pastaj atë ta pasojnë falësit,kush e ndryshon këtë rregull ka gabuar dhe ka bërë mëkat dhe e meriton që të dënohet. Ka thënë ebu Seid el Hudriu [Allahu qoftë i kënaqur me të] është falur një njeri pas të dërguarit dhe ai shkonte në ruku dhe u ngrit prej rukusë para të dërguarit, kur e kreu namazin i dërguari tha:"kush është ky që bën kështu"?tha unë o i dërguar i Allahut,tha:"keni kujdes tejkalinin në namaz kur të bën ruku imami ,bëni ruku, kur të ngritet, ngrituni".Transmeton Taberaniu në librin Mu'xhem el eusat.  
E shiqoi një herë Abdullah ibn Mesudi[Allahu qoftë i kënaqur me të] njërin që e tejkalonte imamin e vet dhe i tha:as vet që je falë as që e ke përcjellë imamin tënd.
- Shëndrimi: Allahu i ka shëndruar një grup prej beni Israilëve në majmunë dhe derra kur e kanë kundërshtuar urdhërin e Allahut të lartësuar kur i urdhëroi që mos të zënë peshq ditën e shtunë e ata e thyen urdhërin dhe zunë peshq,dijetarët e tyre i këshilluan që mos të bëjnë një gjë të tillë mirëpo nuk morën mësim,dhe Allahu i bëri disa prej tyre majmunë dhe disa të tjerë derra dhe në këtë gjendje jetuan një kohe dhe pastaj vdiqën të gjithë dhe nuk u shumuan,tregimi i tyre është i regjistruar në kur'an në suren el e'raf ku thotë Allahu i lartësuar:"**pyeti ti ata për atë fshatin që ishte në buzë deti...**".

Do të ketë shëndrim në fizionomi dhe në këtë umet(popull)do të shëndrohen disa njerëz që e kalojnë kohën duke pirë alkool dhe duke ndëgju muzik dhe nëpër ahengje të çoroditura,ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem]:”do te ketë në këtë popull:shafitje,shëndrim dhe gjuajtje(me gur)”.Transmeton Tirmidhiu. Nuk është patjetër që çdoher kur të bën dikush ndonjë mëkat të i vjen dënimi menjëher.

Ka thënë shejh Tekijuddini:hadithi aludon në ndryshimin e pamjes së jashtme,por ka mundësi të kthehet dhe në aspekt kuptimor sepse gomari përshkruhet si budallë,tha:ky kuptim i përngjanë edhe atij injorantit që nuk i din obligimet e namazit as përcjelljen e imamit.

- Dispozita e tejkalimit: kush e tejkalon imamin me harresë në ndonjë vepër prej veprave të namazit p.sh.:bjen në ruku para tij,ai duhet të kthehet prap që ta bën rukunë pas imamit,nëse nuk mundet me u kthy nga harresa apo padituria derisa e zen imami në ruku,atëher nuk ka kurfarë mëkati,mirëpo nëse e din këtë çështje atëher konsiderohet se e ka kundërshtuar sunetin(traditën)në tejkalim,dhe ka bërë mëkat,mirëpo namazin e ka në rregull.
- Kujdesi i të dërguarit [salallahu alejhi ve selem] për popullin e tij.
- Tejkalimi i imamit nga xhemati është kundërshtim i traditës së të falurit me xhematë.
- Ndonjëherë Allahu e përshpejtonë dënimin e mëkatit në këtë botë.
- Jehuditë janë të ashpër dhe të vrazhdë për këtë e kanë merituar hidhërimin e Allahut.
- Allahu e ka nderuar njeriun prandaj mos ta nënçmon veten e tij me veprimin e mëkateve.
- Nuk ka mëkat në harrim dhe mosdije.

## Hadithi nr.23: Urrehet zgjatja e namazit nga imami

---

Islami është mëshirë nga Allahu për njerëzit, që me të ka dërguar Pejgamberin e mëshirës Muhamedin [salallahu alejhi ve selem], Islami është feja e lehtësimit dhe nuk egziston vështirësia në të, fe e butësisë, dhe çdokush që e shtrëngon atë, vetemse feja e mundë atë.

Transmetohet nga Abdullah ibn Mesudi [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: Një njeri i tha të dërguarit [salallahu alejhi ve selem]: o i dërguari i Allahut unë vonohem për namazin e sabahut sepse imami shumë e zgjatë namazin, i dërguari i Allahut u hidhërua saqë asnjëherë nuk e kam parë të hidhëruar sikur atë ditë dhe tha: “o ju njerëz ka prej jush që i largojnë njerëzit nga feja, prandaj kush është imam le të falet shkurt sepse pas tij ka të sëmur,të moshuar dhe nevojtar”.

### **Dobite e hadithit:**

- Zgjatja e namazit provokim - Muadhi [Allahu qoftë i kënaqur me të] ua fali fisit të vet namazin e jacisë por e zgjati atë duke lexuar suren Bekare ( sureja më e gjatë në Kuran) , një person u largua nga xhemati dhe u fal vetëm për shkak se nuk mundë të duronte.Ky person shkoi te Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] dhe u ankua se zgjatja e namazit të Muadhit është shkak që ky nuk mund të fal sabahun me xhemat. Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] u hidhërua saqë Ibn Mesudi asnjëherë nuk e kishte parë më herët të dërguarin e Allahut të hidhëruar kur këshillonte njerëzit.

Përveç mohimit që ia bëri Muadhit [Allahu qoftë i kënaqur me të] tha se disa prej jush që jeni imama të njerëzve në namaz i ngushtoni njerëzit për shkak të zgjatjes së namazit edhe këtë për arsye se në mesin e njerëzve mund të ketë të sëmur që u pengon qëndrimi i gjatë në këmbë,apo të moshuar që lodhen ,apo ndonjë nevojtar që punon apo udhëton edhe kjo është e vërtet. Ka thënë Ebu Vakid el Lejthi [Allahu qoftë i kënaqur me të] se i dërguari i Allahut është falur shkurt me njerëzit dhe shumë gjatë kur është falur vetëm .Transmeton Imam Shafiu.

Nuk është për qëllim shkurtimi në namaz lënia e obligimeve apo suneteve të namazit,sepse i dërguari[sallahu alejhi ve selem] ka thënë: “nuk pranohet

namazi i atij që nuk drejton shpinën në ruku dhe sexhde”, gjithashtu i ka thënë njeriut i cili gaboi në namaz “kthehu, falu sepse nuk je falur”.

- Sa preferohet të lexohet në namaz- Në sabah imami mund të lexon prej 40 deri 60 ajete, në drekë, ikindi dhe jaci të lexon suren ves-semai ose suren et-tarik ose suren vesh-shemsi ose diçka të ngjajshme, në aksham diçka më pak, e nëse paraqitet ndonjë nevojë në namaz atëherë e shkurton. Një ditë i dërguari e ka falur namazin e sabahut me kul eudhat (kul eudhu birabil felek dhe kul eudhu burabi nas) ngase e dëgjoi një fëmi duke qarë në xhami.
- Hidhërimi për hirë të Allahut - Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] ishte njeriu më zemërgjër dhe më i urtë, nëse i ndodhte diçka vetes ose pasuris së tij e falte dhe nuk u hakmerte, mirëpo nëse i bëhej mëkat Allahut të Lartësuar atëherë ai u hidhëronte shume dhe nuk shuhej hidhërimi i tij derisa të shkonte në vend urdhëri i Allahut ose dispozita e Tij.  
Ka thënë Aishja [Allahu qoftë i kënaqur me të] për të : nuk u hakmerte për veten e tij asnjëherë mirëpo nëse shkeleshin normat e Allahut atëherë hidhërohej saqë askush nuk mund ta frenonte.
- Hadithi tregon për vlerën e diturisë dhe dijetarit.
- Hidhërimi për hirë të fese është prej cilësive të mira të muslimanit.
- Tregimi i shkaqeve të ndalesave ka rëndësi të madhe në islam.

## Hadithi nr.24: Butësia me kafshët

---

All-llahu e ka dërguar Muhamedin [Allahu qoftë i kënaqur me të] mëshirë për tërë botën, për njerëzit, xhinët, kafshët, shpezët, Pejgamberi [Allahu qoftë i kënaqur me të] i mësonte shokët e tij për butesi me kafshët dhe ju thoshte: “Ka shpërblim për çdo dhënie ujë kafshës”, hadithi në vijim tregon për rrezikun e dëmtimit të kafshëve.

Transmeton Abdullah ibn Omeri [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: kam dëgjuar të dërguarin e Allahut [salallahu alejhi ve selem] duke thënë: ka hyrë një grua në zjarr për shkak një maceje, të cilën e ka lidhur dhe nuk i ka dhënë me ngrën, as nuk e ka lënë të lirë që të haje prej gjallesave të tokës”.

### Dobite e hadithit:

- Islami fe e mëshirës – Arabët para ardhjes së fesë islame i kanë dëmtuar kafshët dhe nuk janë mërziur, e kanë vendos kafshën cak për gjuajtje sikurse që veprojnë sot disa shoqata të gjuetise, ose kanë organizuar përleshje mes tyre si p.sh. përleshje mes gjelave, apo qenve sic veprohet edhe në ditët e sodit, i kanë ngarkuar kafshët më shumë se ata mund të bartin ose kanë përdorur metoda tjera të mundimeve të cilat i ka ndaluar Islami.
- Mbytja e kafshëve – Besimtari është i mëshirshëm dhe nuk i bën dëm me qëllim askujt, as njeriut as kafshëve, përveç nëse është për mbrojtje, nëse kafsha e dëmton atëher lejohet mbytja e saj, ndonjëher kërkohet për shkak të mbrojtjes prej dëmit të saj. Ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem] në lidhje me gjarpërin dhe akrepin “Mbytni dy të zezat edhe nëse jeni në namaz”. Gjithashtu e ka lejuar mbytjen e korbit, miut, qenit me dy sy edhe nëse gjindet në Meke
- Bota e ardhshme është e vërtet – Ka thënë Allahu i Lartësuar: **“Kush vepron mirë edhe sa grimca do të sheh atë dhe kush vepron keq sa grimca do ta sheh atë (në botën tjetër)”**, gjithashtu tha: **“Edhe ne i vendosim peshoret e sakta Ditën e Kijametit dhe nuk i bëhet padrejt askujt”**. Gruaja e cila e mbylli macen dhe la që urria ta mbytë atë, ajo do të dënohet në varr për këtë mëkat, Ditën e Kijametit do të peshohen veprat, nëse ka posedu besim dhe të mira i lumtë atij personi, do te



pergëzohet me shpëtim dhe lumturi të pafund, sepse Allahu ia ka falë të këqijat. Ndërsa nëse ka posedu besim mirëpo pak të mira, e më shumë të këqia ai person është në rrezik, ka mundesi që ta mer Allahu me drejtësin e Tij dhe ta dënon për të këqijat e tij, ose ta mer me mëshirën e Tij dhe t'ia falë shumë prej mëkateve të tij. Ka thënë Allahu i Lartësuar:” **Allahu nuk e fal ti bëhet shok atij dhe falë përveç kësaj kujt donë**”.

Nëse nuk ka pasur besim (iman) nuk i bën dobi asnjëlloj adhurimi për dalje nga zjarri mirëpo atij i pakësohet denimi.

Më mekate i obligohet njeriut zjarri, dhe do të vendoset peshorja Ditën e Kiametit patjetër.

Me punë të mira i obligohet xhenneti edhe mëkatarit, dhe do të vendoset peshorja Ditën e Kiametit patjetër.

Nuk ka mëkat që i fshin krejt punët e mira njeriut përveç kufrit (mohimit) pas besimit, Allahu na mbrojtë.

Nuk ka vepër e mirë që i fshin gjithë veprat e këqia përveç besimit pas kufrit apo pendimi i sinqert.

- Macja është prej kafshëve shtëpiake, ledhatohet edhe nuk duhet të dëmtohet e aq më pak të mbytet.

## Hadithi nr.25: Sexhdeja shtyllë e namazit

---

Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] ua mësonte shokëve të tij rregullat e fesë, e posaçërisht rregullat e namazit, në mënyrën më të mirë nëpërmjet fjalëve dhe veprave. Hadithi në vijim qartëson se Allahu i Lartësuar e ka urdhëruar Pejgamberin [salallahu alejhi ve selem] që ta plotëson sexhden dhe njëkohësisht ky urdhër vlen për tërë umetin. Transmeton Abdullah ibn Abbasi [Allahu qoftë i kënaqur me të] se i dërguari [salallahu alejhi ve selem] ka thënë: “Jam urdhëruar të bëj sexhde me shtatë gjymtyrë ; me ballë, dhe bëri me shenjë kah hunda, me duar, me gjunjët, me gishtat e këmbëve, dhe mos ti përvjelim rrobat e as të lidhim flokët”.

### Dobitë e hadithit:

- Forma e namazit- Xhibrili alejhi selam e ka mësuar Pejgamberin [Allahu qoftë i kënaqur me të] për formën e namazit një ditë pas udhëtimit të madhë në Isra dhe Miraxh ,sikur që ia mësoi edhe fillimin dhe mbarimin e kohës së namazeve , dhe ia mësoi që sexhden ta bën me shtatë pjesë të trupit e ata janë :
  - a) Balli: pjesa më e ndershme e njeriut, vendosja e ballit në toke nëse bëhet për madhërimin e dikujt tjetër pos Allahut te Lartësuar është mohim i Allahut.
  - b) Duart: e jo bërrylat sepse vendosja e bërrylave në toke gjatë sexhdes është e urryer.
  - c) Gjunjët :nuk mundet me u kompletu sexhdeja pa i vendos gjunjët ne tokë.
    - d) Majet e këmbëve : m.th. majet e gishtave. Bërja e sexhdes në këtë formë është obligim (farz) në namaz sepse urdhri ne këtë hadith është i qartë.
    - e) Vendosja e hundës dhe ballit në tokë është obligim (vaxhib) .Ka thënë Ebu Seid el Hudriu: na e fali namazin i dërguari [salallahu alejhi ve selem]dhe i pash shenjatat e baltës në ballin dhe hundën e tij ...”Transmeton Buhariu.
  - Prej etikës së namazit: Ka ndaluar i dërguari [salallahu alejhi ve selem] që të përvjelën rrobat kur bën sexhde ,ka disa kryelarte që i përvjelin ngase frikohen mos ju prishet pantallonave të tyre hekurosja. I dërguari i Allahut [salallahu alejhi ve selem] gjithashtu ka ndaluar që të mblidhen flokët për ata që i kanë flokët e gjata.

Nëse kjo bëhet me qëllim që t'u përngjasohet jobesimtarëve, atëherë kjo është mëkat, mirëpo qëllimi është për disa që i lidhin flokët në namaz ose i shtinë nën kapelë, gjë që është e ndaluar, sepse nuk i lë flokët që të bëjnë sexhde dhe në të njëjtën kohë u ngjason hindusëve dhe disa priftërinjve të krishterë.

E pa Ebu Rafiu Hasanin birin e Aliut [Allahu qoftë i kënaqur me të] duke u falur dhe i kishte lidhur flokët bisht mbrapa shpine ia zgjidhi bishtin dhe i tha e kam dëgjuar të dërguarin [salallahu alejhi ve selem] duke thënë:” ky është dryni i i djallit apo vendi i uljes së djallit” Transmeton Ebu Davudi.

Dijetarët janë të pajtimit për ndalesën që të falet dikush me rroba të përvjela apo këmishë të përvjelur ,apo të futen flokët nën kapele ngase kjo vepër është e urryer (mekruh tenzih) mirëpo nuk është haram, e nëse falet në këtë formë gabon, mirëpo namazi i pranohet . Nëse i mbledh flokët gjatë namazit i prishet namazi sepse ai ka lëvizur shumë në veprimin e një mekruh (e urryer apo papëlqyer).

- Nuk është e pëlqyer që të vendoset pengesë për vënien e ballit ne toke përveç në rast urgjent siç është ftohti i madh, në këtë rast nuk është patjetër të shpalosen duart apo këmbët gjatë sexhdes ,duhet te mbulohen gjunjët sepse janë pjese te turpshme(auret).
- Modestia e të dërguarit [salallahu alejhi ve selem].
- Rëndësia e namazit dhe obligueshmëria e mësimit të dispozitave të saj për atë që nuk i din.
- Ndalimi nga përngjasimi me jobesimtarët që te dallohet personaliteti islam.

## Hadithi nr.26: Etika e ditës së xhuma

---

Dita e xhuma është ditë e veçantë prej ditëve tjera, ka vlerën dhe pozitën e vet, veçoritë që e dallojnë nga ditët tjera të javës siç janë pastrimi për faljen e namazit të xhumasë, dëgjimi i hutbes, koha e përgjigjes së lutjes etj. Transmetohet nga Selman Farisiu [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: kam dëgjuar të dërguarin [salallahu alejhi ve selem] duke thënë : ” Kur njeriu pastrohet ditën e xhuma aq sa ka mundësi ,pastaj drejtohet, parfymoset ,pastaj del dhe nuk i ndanë dy persona (në xhami), falet, dëgjon imamin kur të flet, i falen mëkatet prej këtë deri në xhumanë e ardhshme”.

### Dobitë e hadithit:

- Pastrimi ditën e xhuma: pastrimi ditën e xhuma është sunnet i forte për atë person që ka obligim xhumanë. Ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem] :”Kush merr abdes ditën e xhuma ka vepruar mirë, kush pastrohet,pastrimi është më i mirë” Transmeton Ebu Davudi.  
Pastrimi ditën e xhuma ka qenë obligim pastaj është anuluar dhe është bërë sunnet (e pëlqyer) si lehtësim për njerëzit.  
Pastrimi ditën e xhuma bëhet për shkak të namazit të xhumasë, kush pastrohet pas agimit të diellit ai ka praktikuar sunnetin , e kush pastrohet natën e premtë ose pas namazit të xhumase atij i ka ikur një sunnet, mendim ky i disa dijetarëve.
- Rregullimi: sunnete të forta janë veshja e teshave të pastra ,pastrimi i trupit dhe kokës për shkak të namazit të xhumasë, sikur për namazin e bajramit. Ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem] : “Është mire qe ju të bleni nga dy palë rroba,një palë për namazin e xhumasë edhe një palë për punë” Transmeton Ibn Maxhe.  
Prej pastrimit është edhe përdorimi i misvakut ose diçka tjetër e cila i pastron dhëmbët, sepse për namazin e xhumasë mblidhen shume njerëz dhe duhet larguar çdo gjë që ju pengon njerëzve. Ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem]:”Sikur mos të frikohem se ju rëndohet popullit tim do i kisha urdhëruar që ta përdorin misvakun për çdo namaz” Transmeton Buhariu. Gjithashtu ka thënë:” prej hakut të besimtarit ditën e premtë është të përdor misvakun dhe të vishet mirë” Transmeton Ibn Ebi Shejbe sipas kushteve të Muslimit.

Prej pastërtisë është edhe përdorimi i parfumit.

Nga kjo që cekëm më lart shihet kujdesi i fesë islame në plotësimin e pastërtisë tek e gjithë shoqëria ,nga pastrimi, krehja e flokëve dhe e mjekrës, parfymosja, dhe pastrimi i dhëmbëve.

- Namazi në xhami: është për qëllim namazi i përshëndetjes së xhamisë edhe sunnetet e para të xhumasë.
- Prej etikës së xhumasë: është që të ulet njeriu ku të gjen vend, nuk ka të drejtë ai që vjen me vonesë ti pengon njerëzit dhe ti kalon safet duke u mundu për të arritur safin e pare sepse kjo i pengon njerëzit, ndërsa pengesa ndaj besimtarit është mëkat ,përveç nëse gjen zbrazëti të atëherë mundet të ecë përpara.
- Prej dispozitave të xhumasë është obligueshmëria e dëgjimit të hutbes , heshtja gjatë saj edhe heshtja nëse të pyet dikush apo me e ndal nga të folurit. Ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem]:” Ditën e xhuma kur imami është duke ligjëruar në hutbe nëse i thua shokut tënd hesht ke gabuar”Transmeton Buhariu.
- Arritja e faljes: kjo fjale d.m.th. se kushtet e arritjes së faljes janë shtatë gjërat e lartpërmendura: pastrimi, larja, krehja, parfymosja, mos ndarja e dy personave në saf, falja e sunneteve para se të del imami në hutbe, dëgjimi i hutbes ,sa punë të lehta e sa shpërblim i madh.
- Hadithi tregon se pastrimi në ditën e xhuma është sunnet dhe se rregullimi i pamjes për shkak të takimit me njerëzit në shtëpinë e Allahut.
- Ata që shkojnë në xhuma me tesha të zhytura, pa u pastruar dhe rregulluar e kundërshtojnë sunnetin, nëse i kane mundësit për tu pastruar.

## Hadithi nr.27: Ditët e Bajramit janë ditë feste dhe gëzimi, dispozita e këndimit në festa.

---

Patjetër që muslimani të ketë ditë feste dhe të gëzohet në të, sidomos kur kryen ndonjë adhurim sikur që është agjërimi, haxhi apo kur vepron ndonjë vepër të preferuar si sunetimi apo martesë.

Transmetohet nga Aisheja [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: hyri i dërguari [salallahu alejhi ve selem] tek dhoma ime dhe tek unë ishin dy vajza të vogla këndonin për ditën e Buathit<sup>1</sup>, ai u mbështet në shtratin e vet dhe e ktheu fytyrën e tij kah ana e kundërt, hyri Ebu Bekri [Allahu qoftë i kënaqur me të] dhe më qortoi dhe më tha: a mjetet e djallit në shtëpinë e të dërguarit!? iu drejtua i dërguari atij dhe i tha: leri, kur u qetësua ua bëra me shenjë dhe shkuan, ka qenë ditë feste kur disa zezake luanin me shtiza dhe parzmorë dhe nuk e dija se kam pyetur të dërguarin apo ai më ka pyetur: “a dëshiron të i shikosh”? Thashë: po unë qëndrova pas tij dhe faqja ime e vendosur në faqën e tij, dhe ai tha: “vazhdoni o bijtë e Erfide” (emri i etiopianve), derisa u mërzita tha: “mjafton”, i thashë po atëherë tha: “largohu”.

### Dobitë e hadithit:

- Kënga – Kënga e cila ngjall emocione, lëviz njeriun, përshkruan bukurinë e pjesëve të trupit apo veprimin e amoralitetit, apo përshkrimin e alkoolit apo veprave të këqija, nuk ka dyshim se është e ndaluar (haram), nëse ia bashkëngjitet edhe instrumentet muzikore atëherë shtohet mëkati, të ardhurat prej saj janë të ndaluara, edhe për atë që përfiton dhe për atë që shpenzon. Dëgjimi i Kuranit të ndershëm i përcjellur me mjete muzikore është mëkat sepse i përngjason këngës. Ka thënë Allahu i Lartësuar: **“Ka prej njerëzve që blejnë fjale të kota që t’i devijojnë tjerët nga rruga e vërtetë”**. Thotë Abdullah ibn Mesudi [Allahu qoftë i kënaqur me të] pasha Allahun që nuk e meriton adhurimin askush pos tij, është për qellim muzika dhe këtë e përsëriti tri herë, po ashtu të njëjtën e thanë edhe Abdullah ibn Abbasi, Ikrimja, Seid ibn Xhubejr, Hasan el Basriu, edhe të tjerë.

---

<sup>1</sup>Dita e Buathit është një ditë në kohën e injorancës që janë luftuar ndërmjet veti dy fiset arabe Eusi edhe Hazrexi që jetonin në Medinë, dhe kësaj dite poetet i kanë kushtuar vjersha.

I dërguari [salallahu alejhi ve selem] thotë :”Do të ketë në umetin tim njerëz që do të lejojnë amoralitetin,mëndafshin,alkoolin edhe mjetet muzikore”.Transmeton Ebu Davudi, dhe Buhariu në mënyrë të komentit. Katër imamat (e ehli sunetit) janë të pajtimit që është mëkat kënga e cila përmban fjalë te fëlliqura, nxit provokim apo shoqërohet me muzikë. Ajo çfarë këndonin dy vajzat në shtëpinë e Pejgamberit [salallahu alejhi ve selem] nuk kanë qenë këngë sikur këngët e sodit, as nuk kane qenë gra, as nuk ka pasur fjalë te këqija e as përshkrim i ndaluar ,por kanë qenë dy vajza të vogla të cilat kanë kënduar poezinë e cila është kënduar për luftën e Buathit dhe padyshim nuk ka pasur mjete muzikore ,mirëpo kane pasur defe pa çampare , të cilat janë lejuar në dasma dhe festa. Gjithashtu lejohet kënga në këto raste me kusht që mos të përmban fjalë nxitëse te provokimit, fjalë amorale, apo muzikë. Dijetaret kanë thënë se nuk prish pune nëse njeriu këndon në vete për relaksim, gjithashtu edhe gruaja nëse këndon në vete për relaksim apo për fëmijën e saj, apo të ngjashme siç është këndimi i gruas ne dasmë ne mesin e grave me kushtet e lartpërmendura. Xhabiri [Allahu qoftë i kënaqur me të] thotë : Keni kujdes nga kënga sepse ajo është prej Iblisit dhe është shirk, nuk këndon vetëm se shejtani.

- Festa – preferohet që të gëzohemi në festa sepse është prej simboleve te islamit. Transmetohet nga Enesi [Allahu qoftë i kënaqur me të] se kur ka shkuar Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] në Medine, ata kanë pasur dy ditë në të cilat kanë lozur, Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] ju tha:” ua ka zëvendësuar Allahu këta dy ditë me dy më të mira, ditën e Kurban Bajramit dhe Fitër Bajramit”. Transmeton Nesaiu. Kur e qortoi Ebu Bekri [Allahu qoftë i kënaqur me të] Aishen [Allahu qoftë i kënaqur me të] për shkak se kënduan vajzat e vogla Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] : “O Ebu Bekër çdo popull ka festat e tyre dhe kjo është festa jone”. Transmeton Buhariu. Për këtë arsye preferohet që në festa të vishen teshat më të reja ose më të mirat, vizita e të afërmve dhe shokëve duke i përkujtuar dhuntitë e Allahut që ua jep robërve te tij besimtareve qoftë në festen e Kurbanit apo festën e Fitrit (pas ramazanit). Ka qenë prej shenjave të gëzimit në festë kur i dërguari [salallahu alejhi ve selem] i lejoi që të luajnë etiopianët në xhami lojën e tyre luftarake, të mbledhen rreth tyre fëmijët, të shikojnë dhe të mësojnë takimin me armiqtë dhe të nxisë tek njerëzit shpirtin luftarak për ngritjen e fjalës së Allahut. Vazhdojnë njerëzit në vendin tonë deri në këtë kohë të shfrytëzojnë mbledhjen e njerëzve për festa edhe disa

luajnë me shpata dhe mburoja, disa herë me mundje, disa herë me garimin e kuajve apo me gjuajtjen në shenjë.

- Butësia me gratë -gruaja në kohën e injorancës është nënçmuar edhe nënvlerësuar tek arabet dhe popujt tjerë jo arab. Disa prej arabëve vajzat e tyre i varrosnin të gjalla,siç e ka cekur kurani në disa vende. Ka thënë Omeri [Allahu qoftë i kënaqur me të]: Pasha Allahun nuk i kemi konsideruar gratë asgjë derisa ka zbritur Allahu ajet për to edhe ua ka ndarë atë që ua ka nda atyre. d.m.th. trashëgiminë.

Ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem]: “Më i miri prej jush është ai i cili sillet më së miri me familjen e vet, dhe unë sillem më së miri me familjen time”. Gjithashtu ka thënë: “Nuk i nderon gratë vetëm se një i ndershëm edhe nuk i nënçmon ata vetëm se një i poshtër”.

Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] i ka nderuar shume gratë e tij ,siç tregohet rasti me Aishen r.a. kur garuan një herë jashtë Medines ,larg njerëzve dhe ajo ia tejkaloj Pejgamberit [salallahu alejhi ve selem], pas një kohe ai ia tejkaloj Aishes r.a. në luftën e Tebukut.

Mjerë për atë që thotë se islami e nënvlerëson gruan, feja islame e ka bërë të barabartë gruan në çdo send përveç në disa aspekte që i takojnë natyrës së saj si mosmarrja pjesë në luftë dhe mos përzierja me burra. Te humbur janë disa burra që mendojnë se burrëria është në maltretimin apo nënçmimin e femrës.

- Hadithi tregon se lejohet baba të edukon vajzën e tij edhe në prezencë të bashkëshortit, edhe nëse burri e braktis edukimin, atëherë kjo është mision i babës
- Butësia e bashkëshortit me bashkëshorten e tij, dhe mos marrja në pyetje për sendet që i ka lejuar feja.
- Pozita e Aishes r.a. te i dërguari alejhi selam .
- Muslimanet i kanë dy festa që në to gëzohen, vizitohen për mbajtjen e lidhjes farefisnore dhe mbajtjen e afërsisë.
- Lejohet përgatitja për lufte para se te vjen ajo dhe mbledhja e njerëzve për të shikuar atë



- Butësia e të dërguarit [salallahu alejhi ve selem]dhe sjellja e mirë të tij.

## Hadithi nr.28: Kohët e dobishme

---

Allahu i Lartësuar ka lënë kohë, vende edhe njerëz të veçantë, ka bërë dhjetë ditët e para të muajit Dhulhixhe dhe u ka dhënë një pozitë të veçantë saqë është betuar në Kuranin e Madhërisëm për to dhe Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] ka thënë që veprat e mira në këto ditë janë më të vlefshme se sa në ditët tjera të vitit.

Transmetohet nga Abdullah ibn Abbasi [Allahu qoftë i kënaqur me të] se i dërguari [salallahu alejhi ve selem] ka thënë: “Nuk ka punë me vlerë më të madhe se sa veprat që bëhen në dhjetë ditëshin (e dhul hixhes) thane: as xhihadi ?, tha:”as xhihadi përveç një njeriu që sakrifikon me veten e tij dhe pasurinë e tij dhe nuk kthehet me asgjë”.

### **Dobitë e hadithit:**

- Ditët e haxhit: Dhjetë ditët e muajit Dhulhixhe janë ditët e haxhit që në to mblidhen hanxhinjtë nga çdo vend i largët dhe i afërt në Meken e ndershme. Në ditën e tetë dalin shume haxhinj dhe qëndrojnë në vendin Mina që të nesërmen të nisen për në Arafat, disa të tjerë shkojnë drejt në Arafat, sepse dita e nëntë është dita e qëndrimit në Arafat ,nata e nëntë është nata e qëndrimit në vendin Muzdelife. Dita e dhjetë është dita e therjes së kurbanave obligim për ata që e kryen haxhin e llojit Mutemeti’ ose Karin, dhe sunnet për atë që e kryen haxhin e llojit Mufred, dhe është dita e gjuajtjes së guralecëve për të gjithë haxhinjtë. Ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem]: “Nuk ka dite që në to është më e vlefshme vepra e mirë se në këto dhjetë ditët e Dhulhixhes” i thanë as xhihadi në rrugë të Allahut ?, tha:”as xhihadi në rrugë të Allahut përveç një njeri që ka dalë me pasurinë e tij dhe nuk kthehet me asgjë nga ky udhëtim”. Transmeton Buhariu dhe Muslimi.
- Ditët e Teshrikit : Këto janë dita e dytë, e tretë dhe e katërt e festës së Kurban Bajramit janë quajtur kështu sepse arabët i shfaqnin lëkurat e kurbanave në diell që të thahen dhe mos të prishen. Këto ditë kanë vlerë sepse janë afër dhjete ditëve të Dhulhixhes dhe në këto ditë priten kurbanat dhe hidhen gurëzit.

- Xhihadi: shpenzimi i pasurisë dhe shpirtit në luftimin e politeistëve për hirë të ngritjes së fjalës së Allahut të Lartësuar dhe ndihmimi i fesë së Tij.

Ky ndahet në dy lloje:

1. Obligim individual: është kur sulmohet shteti islam edhe banorët e tij dhe udhëheqësi urdhëron për dalje për luftime, ky lloj i luftës është më e mirë se çdo vepër.
2. Obligim kolektiv: kjo është kur nuk sulmohet shteti islam apo banorët e tij dhe kur nuk i thirr udhëheqësi të gjithë njerëzit për luftë, kjo është sikur lufta e atyre që dalin në rrugë për shpërndarje të Veprat e mira gjatë dhjetë ditëve të Dhulhixhes janë më të mira se kjo lloj luftime. Allahu e din më së miri.
  - Tregon hadithi për vlerën e disa kohërave dhe të disa vendeve.
  - Vlera e xhihadit është e madhe.

## Hadithi nr.29: Namazi i natës

---

Namazi i natës është afrim tek Allahu i Lartësuar, sjellje e njerëzve të devotshëm, shenjë e të shpetuarve, namazi më i mirë pas farzeve (obligimeve). Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] është falur natën shumë, qëndronte në këmbë shumë derisa iu çaheshin ata, duke shpresu në kënaqësinë e Allahut.

Transmeton nga Aishja [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: i dërguari [salallahu alejhi ve selem] falte njëmbëdhjetë rekate edhe ky ishte namazi i tij, gjatë natës-sexhden e bënte aq sa derisa dikush nga ju i lexon pesëdhjetë ajete para se të ngritej, i falte dy rekate para namazit të sabahut pastaj mbështetej në anën e djathtë deri të vinte muezini për namaz.

### Dobite e hadithit:

- Namazi i natës: ia ka obliguar Allahu i Lartësuar të dërguarit të Tij namazin e natës, dhe i ka thënë: "**edhe nje pjese nga nata falu vullnetar për veten tende**" edhe ndonjëherë u falte njëmbëdhjetë rekate. Është pyetur Aishja [Allahu qoftë i kënaqur me të] për namazin e të dërguarit gjatë natës tha: shtatë, nëntë, njëmbëdhjetë, përveç dy rekateve të sabahut. Transmeton Buhariu.

Kur dëshironte të falte natën e pastronte gojen me misfak, i falte dy rekate shkurt, pastaj kur u falte pas kësaj e zgjate, dhe lexonte shumë sa që u lodhte ai që qëndronte pas tij, ka thënë Abdullah ibn Mesudi [Allahu qoftë i kënaqur me të]: jam falur një natë me të dërguarin dhe vazhdoi të qëndron në këmbë derisa desha ta bëj një punë të keqe, i thanë: çka deshe të bësh? tha: të ulem dhe ta lë të dërguarin.

Transmeton Buhariu.

Namazi i natës është i preferuar për këtë popull, ka nxitur Allahu i Lartësuar për te ku ka thënë në përshkrimin e disa robërve të tij: "**Pak nga nata flenin, e para mengjesit kerkonin falje**". ka nxitur për të edhe i dërguari [salallahu alejhi ve selem] dhe ka thënë: "namazi më i mirë pas obligimeve është namazi i natës"

Namazi i teravive është namaz i natës:

a) Baza e legjimitetit të namazit të teravive me xhemat është vepra e

Pejgamberit [salallahu alejhi ve selem] që dy apo tre net me rend e ka falur pastaj e ka lënë që mos të bëhet obligim, ka thënë Aishja [Allahu qoftë i kënaqur me të] :më të vërtet i dërguari[Allahu qoftë i kënaqur me të] u fal një natë në xhami e me të u falen shumë njerëz,pastaj u fal edhe natën e ardhshme u shtuan njerëzit edhe më shumë,kur u mbledhën për tu falur natën e tretë ose të katërtën nuk doli i dërguari për tu falur,kur doli mëngjesi ju tha:"e kam parë se jeni mbledhur dhe nuk kam dalë vetëmse jam frikuar mos të ju obligohet juve" kjo ka ndodhë në ramazan.Transmeton Buhariu.

b) Kur erdhi koha e hilafetit Omerit [Allahu qoftë i kënaqur me të] i pa që njerëzit faleshin grupe grupe,dhe tha: sikur t'i kishim bashkuar të falen me një imam,dhe e bëri që tu prijë Ubeji [Allahu qoftë i kënaqur me të] dhe tua fallë nga tetë rekate,pastaj i bëri njëzet rekate,dhe sahabët e përkrahën dhe e përcjellen në këtë, kështu vepruan Uthmani dhe Aliu [Allahu qoftë i kënaqur me ta] në kohën e tyre,dhe falja e njëzet rekateve u bë traditë. (Me këtë të fundit nuk pajtohemi unë, prandaj në fusnotë do të shkruaj se jo çdosend çka është e përkthyme e mbështes).

Ka thënë Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] : "pasoni ata dy që janë pas meje Ebu Bekrin dhe Omerin". Transmeton Ahmedi dhe Tirmidhiu.

Ka thënë Daib ibn Jezid [Allahu qoftë i kënaqur me të]:në kohën e Omerit kanë falur njëzet rekate" ky është lajm i vërtet e ka transmetuar Bejhekiu në sunenin e madh, e ka vërtetuar Neveviu dhe e ka pohuar Zejleiu, e ka vërtetuar Sebkiu,ibn Iraki,Ajniju,Sujutiu,Ali el Karij,Nejmeviu etj.

E ka pyetur Ebu Jusufi imamin Ebu Hanife r.h për bashkimin e Omerit [Allahu qoftë i kënaqur me të] të njerëzve në njëzet rekate në ramazan,tha: e ka vepruar këtë Omeri sepse e ka llogaritur sunet e nuk e ka shpikur prej vetes.

c) Muslimanët në lindje dhe perëndim në vendin e shenjtë Qabe edhe jasht saj e shohin se falja e teravisë njëzet rekate është sunet,ai që dëshiron të shton deri në tridhjetë e gjashtë ose katërdhjetë mundet,kush dëshiron të falë vetëm tetë rekate mundet.

ç) Etika e namazit të teravive:zgjatja,të lexon imami së paku një xhuz nga Kurani që derisa të përfundon ramazani të përfundon edhe leximi i Kuranit të madhërisëm.

Namazit i vitrit: Ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem]: "vitri është hak, kush nuk falë namaz vitri nuk është prej nesh" Transmeton Ebu Davudi.

\*baza në faljen e namazit të vitrit është të falet ndërmjet namazit të jacisë dhe të sabahut për atë që mundet të ngritet para sabahut,ai qe frikohet se nuk mund të ngrihet para sabahut e fal pas namazit të jacisë ose para se të

flej.

\*është obligim më i ulët se farzi dhe mbi sunnetin,sepse ka nxitur i dërguari [salallahu alejhi ve selem] për te,vazhdueshmeria e tij ne të,mos falja e tij në mjet në udhëtimet e tij.Ky është mendimi i Hanefive ndersa tek të tjerët konsiderohet sunnet i forte ( mendoj se ky është mendim më i forte ).

\*namazi i vitrit është tek,një rekat pas dy rekateve ose tre rekate të ngjitura ose më shumë. Imam Ebu Hanifja e ka zgjedhur që të fal tre rekate të ngjitura.

\* në namazin e vitrit është e preferuar që të lexohet : Transmetohet nga Omeri [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: i dërguari [salallahu alejhi ve selem] lexonte në namazin e vitrit, në rekatën e parë sebbihisme rabbikel e'la,në të dytin kul ja ejjuhul kafirun,në të tretin kul huvallahu ehad.Transmeton imam Tahaviu.

\*duaja e kunutit sipas hanefive bëhet pas leximit, para rukusë ndërsa sipas Shafiive bëhet pas rukusë.

- Tregon hadithi se namazi i natës ka qenë obligim për të dërguarin ndërsa për ne e preferuar.
- Nxitja për ndejtje gjatë në sexhde në namazin e natës.

## Hadithi nr.30: Kërkimi i shiut prej All-llahut

---

Ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem]: ” kërkoni prej mirësive të Zotit sepse All-llahu dëshiron që të kërkohet prej Tij” I dërguari[sallahu alejhi ve selem] kërkonte prej All-llahut çdo gjë, kur u vononte shiu iu luste All-llahut dhe All-llahu lëshonte shi.

Transmeton Abdullah ibn Zejdi [Allahu qoftë i kënaqur me të] se i dërguari [salallahu alejhi ve selem] ka dalë në faltore të kërkon prej All-llahut shi, u kthi kah kibleja e ktheu petkun e tij dhe I fali dy rekate.

### **Dobitë e hadithit:**

- Kërkimi i shiut: ndodh që Allahu ta ndalë shiun te muslimanët për ndonjë urtësi që ai e din,mund të jetë prej urtësisë së Tij që dëshiron që njerëzit ta lusin Atë,që kur ta lusin Ai të lëshon shi,kjo është arsye që ta falënderojnë njerëzit më shumë dhe të lidhen me Allahun më shumë. I dërguari [salallahu alejhi ve selem] kërkonte që të bjen shi kur kishte nevojë, ndonjëherë lutej në hutbe, ndonjëherë dilte jashtë qytetit dhe lutej për shi, ngandonjëherë mbante fjalim, lutej, falej,dhe kërkonte shi.

Kërkimi shi me Pejgamberin[sallahu alejhi ve selem] dhe me njerëzit e mirë është i lejuar.

Njëherë erdhi një beduin te i dërguari [salallahu alejhi ve selem] dhe tha:o i dërguari i Zotit kemi ardhur tek ti sepse kafshët nuk kanë çka hanë,as fëmijët çka pinë...pastaj u ngrit i dërguari [salallahu alejhi ve selem] duke u ngutë derisa hypi në hutbe dhe e falënderoi Zotin dhe e madhëroi pastaj tha: o Zot na lësho shi....pastaj pas një kohe erdhën njerëzit duke britur thonin: u zhytëm u zhytëm (prej shiut) pastaj qeshi i dërguari [salallahu alejhi ve selem] derisa i dolen dhëmballët...

Transmeton nga Enesi [salallahu alejhi ve selem] se Omeri [salallahu alejhi ve selem] kur u bënte thatësi kërkonte shi (duke ndërmjetësuar) me Abbas ibn AbdulMutilibin dhe thonte: o Zot ne ndërmjetësojmë teTi me të derguarin tonë,dhe na lëshoj shi, tash po ndërmjetësojmë me mixhën e të derguarit tonë na lësho shi, dhe binte shi.Transmeton Buhariu.

- Mënyra e kompletuar e kërkimit të shiut :

a) Dalja në hapsirë dhe asokohe ishte jashtë vendbanimit, kjo është që tregon më shumë nënshtrim dhe mvarshmëri ndaj Allahut.

b) Kërkimi i shiut, lutje e Allahut për këtë.

c) Kthymi i rrobave, me optimizëm se do të ndërrojë gjendja nga ngushtimi në gjerësim, nga vështirësia në lehtësim. Kthymi i rrobave bëhet në mënyrë që e veshë rrobën kah e prapa se anën e djathtë e vendos kah e majta dhe tëmajtën kah e djathta.

d) Namazi është dy rekatesh që falet në kohërat që nuk ndalohet falja sikur namazi i bajramit mirëpo nuk merren tekbirot e bajramit. Ka thënë ibn Abbasi [Allahu qoftë i kënaqur me të] në përshkrimin e kërkimit të shiut: nuk ka mbajtur hutbe sikur ju kështu, mirëpo ka bërë vazhdimisht lutje dhe përulje dhe madhërim ndaj Allahut pastaj ka falur dy rekate sikur e falte bajramin. Transmeton Ebu Davudi.

- Hadithi tregon për vlerën e të dërguarit të Zotit dhe vlerën e mixhës së tij Abbasit [Allahu qoftë i kënaqur me të]
- Kërkimi i shiut është sunnet i përhershëm.



## Hadithi nr.31: Çështje që nuk i din askush përveç Allahut

---

Njeriu din aq sa ka dëshiruar Allahu që të din, arrin njeriu me shqisat e tij aq sa dëshiron Allahu të arrij ,dhe gjithë kjo është pak në krahasim me diturinë e Allahut gjithëpërfshirëse . Allahu disa dituri i ka mbajtur vetëm për vete dhe nuk ua ka treguar robërve të Tij.

Transmetohet nga Ibn Omeri [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem]: “çelësat e diturisë së fshehtë(gajbit) janë pesë dhe nuk i din askush përveç All-llahut, askush nuk e din çka do të ndodhë nesër, askush nuk e din çka ka në mitra, njeriu nuk e din çka do të bënë nesër,njeriu nuk e din se në cilin vend do të vdesë,askush nuk e din se kur vjen shiu”.

### Dobitë e hadithit:

- Dituria e Allahut: dituria e Allahut është cilësi e Tij vetore e vjetër,që i shpalos të dhënat krejtësisht,obligimet,të lejuarat,të pamunduratur,nuk i fshehët diturisë së Allahut asgjë në tokë e në qiell,ka thënë i Lartësuari:” **me të vërtetë Allahu din çdo send**”. Gjithçka që dinë njerëzit është nga ajo që ua mëson Allahu,ka thënë i Lartësuari:” **nuk ngërthejnë asgjë nga dituria përveç aq sa donë Allahu**”.Gjithashtu:”**nuk u është dhënë nga dituria përveç se pak**”.

Ajo që Allahu e ka veçuar veten e Tij dhe nuk ia ka treguar askujt është me të vërtetë shumë,p.sh.: askush prej njerëzve nuk i din ushtarët e Allahut,njeriu nuk e din gjendjen e vetes së vet,askush prej krijesave nuk e din kur është kiameti ,askush prej njerëzve nuk e din thelbin e shpirtit.

Nga ajo që e ka veçuar Allahu veten e Tij dhe nuk ia ka mësuar askujt prej krijesave janë pesë gjëra:

a) askush nuk e din çka do të ndodhë nesër: e nesërmja është e ardhmja,kjo është e fshehur dhe ende nuk ka ardhur dhe prej kah ka me e ditur njeriu atë, ka thënë i Lartësuari:”**Dijetari i fshehurisë dhe nuk ia tregon fshehurinë e Tij askujt përveç kujt donë prej pejgambereve** “. Nga kjo e dimë se parashikuesi i së ardhmes, dhe shikuesi i yjeve janë gënjeshtarë,sepse pretendojnë se e dinë të ardhmen. Disa njerëz e kanë pyetur të dërguarin për fallxhorin,dhe tha:”kush shkon tek fallxhori dhe e pyet atë për diçka nuk i pranohet atij namazi katërdhjetë ditë” Transmeton Muslimi.

Kur i thanë atij : o i dërguari i Allahut ata fallxhorët dhe parashikuesit na tregojnë ndonjëherë diçka që del e vërtetë,tha :”ajo është një

fjalë që ia përcjellë xhini shokut të tij sikur zëri i pulës,dhe me atë i përziejnë njëqind gënjeshtër”.Transmeton Muslimi.

Nga këtu e kupton gënjeshtërën e disave që pretendojnë se dinë të ardhmen e afërt apo të largët, disa që i thonë vetes pejgamber(ose parashikues).

b) askush nuk e din çka ka në mitër: mitra është vendi ku bashkohen sperma e mashkullit me vezoren e gruas dhe nga kjo bëhet fëmiju në një gjendje që nuk e sheh syri as nuk e kapin shqisat dhe nuk e din askush se çka do të jetë ky fëmijë mashkull apo femër, jetëgjatë apo jetëshkurtër,i ngjashëm me babanë apo me nënën,besimtar apo mohues,i lumtur apo i dëshpëruar, thotë Allahu:”Ai është i cili ju formon në mitra ashtu siç dëshiron”. Kanë thënë dijetarët: nëse thotë mjeku që nëse është gjiri i djathtë i nxirë ai është djalë e nëse është gjiri i majtë atëherë është femër,gjithashtu thonë: nëse gruaja është më e rëndë kah ana e djathtë është vajzë,duke pretenduar se kjo është si zakonisht e jo patjetër atëherë ai mjek nuk bën kufër as gjunah.

c) nuk e din njeriu çka bën nesër:nuk e din askush çka do të i ndodh atij apo prej tij në të ardhmen,vepër e mirë apo e keqe,furnizim me bollëk apo pak,sprovë apo qetësi,vdekje apo jetë, ka thënë i Lartësuar i në gjuhën e të dërguarit:”nëse e kisha ditur të fshehurën do te kisha bërë vepra të mira edhe nuk do të më kaplonte e keqja”.

d) nuk e din njeriu ku do të vdesë:nuk e din askush ku e ka mbarimin në këtë tokë,ku do ta ketë varrin, njeriu mundet të jeton kohë të gjatë në një vend pastaj nevoja e nxjerr nga ai vend dhe pastaj shkon në ndonjë vend tjetër dhe atje vdes dhe atje varroset. Ka thënë i dërguari:”nëse ja ka caktuar Allahu vdekjen dikujt në ndonjë vend ia bën që të ketë nevojë për të shkuar atje”,ka thënë i Lartësuar i :”thuj: nëse jeni në shtëpitë e juaja do të dilnin prej saj ata të cilëve u është shkruar vdekja”.

e) nuk e din askush kur vjen shiu:nuk e din askush saktë se kur dhe ku do të bie shi,as sa është sasia e tij as lloji i tij, atë çka e thonë astronomët nga shpejtësia e erës dhe bartja e mjegullave është mendim shkencor,shpeshherë flasin diçka që i takon të fshehurës,dhe nuk emërtohet shkencë dhe nuk ndërtohet mbi të dispozita,nëse thotë një astronom se nga ajo që ai posedon në shumicën e rasteve bie shi atëherë nuk bën ai kufër as mëkat.

## Hadithi nr.32: Shenjat e fuqisë së All-llahut të Lartësuar

---

Planetet qarkullojnë në një rregull të përkryer dhe kjo nuk ndryshon përveç se me dëshirën e Allahut. Kjo tregon për fuqinë e të Urtit dhe të Diturit. Allahu nuk ndryshon asgjë nga këto përveç nëse dëshiron të bën mrekulli për ndonjë peygamber apo nderim për ndonjë të sinqert apo frikësim për ndonjë popull që nuk kthehet tek Allahu.

Transmeton ebi Bekra [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: kemi qenë te i dërguari [salallahu alejhi ve selem], u morrë dielli dhe u ngrit I dërguari [salallahu alejhi ve selem] duke e krehur petkun e tij derisa hyri në xhami dhe ne hymë me të, pastaj i falëm dy rekate derisa u shpalos dielli dhe tha i dërguari [salallahu alejhi ve selem]: "me të vërtetë nuk mirret dielli e as hëna për vdekjen e dikujt, kur ti shihni kështu atëherë faluni dhe lutuni derisa të kalon ajo që ju ka kapluar".

### Dobitë e hadithit:

- Marrja e diellit dhe hënës:

a) eklipsi i diellit: marrja e dritës së diellit, ndodhë kur del hëna ndërmjet tokës dhe diellit dhe e ndalon dritën e diellit.

Marrja e hënës është shkuarja e dritës së hënës, ndodhë përshkak se toka del ndërmjet diellit dhe hënës dhe i'a ndalon dritën e diellit dhe errësohet hëna.

b) namazi i marrjes së diellit dhe hënës është legjitim me kur'an, sunnet dhe me konsensus. Sa i përket kuranit thotë Allahu: "**nuk i dërgojmë argumentet përveç se për frikësim**". Eklipsi është argument prej argumenteve të Allahut frikësuese. Sa i përket sunnetit, ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem]: "nëse shihni diçka nga këto shenja frikësuese, hyni në namaz". Sa i përket konsensusit: muslimanët kanë konsensus që lejohet me u fal ky namaz, pa mospajtime .

c) shkak i ligjshmërisë së saj: është marrja e diellit dhe hënës, kjo përsëritet çdoher që të ketë marrje të tyre.

Kushti për lejimin e këtij namazi: për tu lejuar falja e këtij namazi kushtëzohet çdo send që kushtëzohet në namazet tjera siç është: pastërtia në të gjitha aspektet, mbulimi i pjesëve të turpshme, kthimi kah kibla dhe qëllimi.

Dispozita: është sunnet dhe thuhet se është farz kifaje.

Mënyra: falen dy rekate ose katër sikur gjitha namazet tjera nafile sipas

medhhebit Hanefi,ndërsa sipas medhhebit Shafi falen dy rekate, çdo rekat me dy ruku:lexon pastaj shkon në ruku pastaj ngritet dhe lexon përsëri ,pastaj shkon në ruku, pastaj drejtohet dhe pastaj bën sexhde,dhe në çdonjerën prej tyre e zgjat.

Falet në ndonjë xhami të madhe apo në hapsir që të i nxen të gjithë.

Sa i përket marrjes së hënës nëse ndodh natën atëherë nuk i mbledh njerëzit që të falen në xhami për shkak të vështirësive gjatë natës,dhe se këtë nuk e ka bërë i dërguari.

- Lutja: ka urdhëruar Allahu i madhëruar që të bëjmë lutje në mirësi dhe vështirësi,në kërkimin e faljes,për largimin e dëmit dhe largimin e sprovave,ska dyshim se marrja e diellit dhe hënës është prej shenjave frikësuese nga Allahu i lartësuar,që tregojnë se Allahu është që e rregullon gjithësinë e prej saj është hëna e dielli. Nuk duhet që muslimani të argëtohem me shiqimin e diellit kur të mirret apo hënës por duhet të angazhohet me namaz dhe me lutje,siç ka bërë i dërguari. Lutja është truri i adhurimit,Allahu ka urdhëruar për të dhe ka thënë:”luteni Zotin tuaj të perulur dhe në heshtje”.
- Tregon hadithi se Allahu vet e kontrollon gjithësinë ashtu siç dëshiron me urtësinë e Tij.
- Kujdesi i edukatorit që të i mëson njerëzit në çdo rast.
- Shenjat e Allahut nga marrja e diellit,marrja e hënës,erërat e forta,shiu i madh janë shkaqe për tu frikësuar nga Allahu i lartësuar.
- Butësia e Allahut me robërit kur ju dërgon shenja për t’u larguar mëkatet nga mëkatet e tyre.

## Hadithi nr.33: Udhëtimi i gruas

---

Islami nuk bën dallim ndërmjet gruas dhe burrit në të drejta dhe obligime, përveç që ka disa rregulla të veçanta që vlejnë vetëm për gratë, për shkak mbrojtjes së nderit dhe pozitës së saj, që të jeton e nderuar, krenare e mbrojtur nga çdo send që e zvogëlon vlerën e saj. Prandaj e ka urdhëruar që të largohet nga disa vende që mund të bëhet pre e disa njerëzve të këqij, as mos të jetë e etiketuar apo akuzuar në nderin e saj nga disa që kanë gjuhë të këqija.

Një nga vendet që mund të i bëhet dëm asaj është : që të shkon në udhëtim prej një vendi në vend tjetër pa pasur me të ndonjë burrë prej të afërmeve të saj, për këtë arsye e ka ndaluar islami këtë, siç ceket edhe në hadithin në vijim:

Transmetohet nga Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: ka thënë I dërguari [salallahu alejhi ve selem]: "nuk I lejohet një gruajë që I beson All-llahut dhe të dërguarit që të udhëton një distance prej një dite e nate e të mos ketë dikë prej të afërmeve me vete".

### **Dobitë e hadithit:**

- Muslimanët kanë rënë në konsensus se nuk i lejohet gruas që të udhëton përveç haxhit dhe umres pa të afërm ose pa bashkëshort, duke u argumentuar me këtë hadith. Edhe pse ka mendime të ndryshme se kur konsiderohet ajo udhëtare. Shumica e dijetarëve thonë: ndalohet nga çdo udhëtim i gjatë apo i shkurtër, për shkak se transmeton Imam Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Abbasi se ka thënë: "nuk lejohet veçimi i një burri me një grua përveç nëse është prezent mahremi (i afërm i gruas), as nuk lejohet të udhëton gruaja përveç se me mahrem". Hadithi është i përgjithshëm në ndalimin nga çdo udhëtim. Kanë thënë dijetarët hanefi : ndalohet nga udhëtimi i gjatë në të cilin shkurtohet namazi, dhe nuk ndalohet nga udhëtimi i shkurtër që në të nuk lejohet të shkurtohet namazi, duke u argumentuar me hadithin që e transmeton Imam Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Omeri [Allahu qoftë i kënaqur me të] që ka thënë: ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem] : "nuk lejohet të udhëton gruaja tre ditë përveç se me mahrem". Ndërsa shumica e dijetarëve këtë hadith e komentojnë si pyetje e veçantë.

- Ka përjashtim nga rregulli që gruaja mos të ec pa mahrem (të afërm) në raste të domosdoshmërisë. Nëse është gruaja duke ecur në një udhëtim dhe me mahrem por ndalen në rrugë për ndonjë nevojë pastaj ecën grupi dhe ajo mbetet në rrugë, gjithashtu nëse një jobesimtare është në një vend dhe e pranon islamin, ose një e burgosur ka shpëtuar prej burgut, në këto raste dhe të ngjashme lejohet që gruaja të ecë vetëm.
- Dijetarët kanë mendime të ndryshme rreth udhëtimit të gruas vetëm për në haxh apo umre.  
Kanë thënë dijetarët Shafi: lejohet nëse gratë shkojnë në shoqërimin e grave tjera të besueshme dhe është haxhi i parë dhe janë argumentuar për këtë se Omeri [Allahu qoftë i kënaqur me të] ju ka dhënë leje grave të pejgamberit të shkojnë në haxh dhe e ka dërguar me to Othmanin [Allahu qoftë i kënaqur me të] Abdurahman ibn Aafin [Allahu qoftë i kënaqur me të] dhe këtë nuk e ka mohuar askush.  
Kanë thënë dijetarët Hanefi dhe Hanbeli: nuk lejohet të udhëton përveç nëse ka me vete mahrem, sepse Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem] ka thënë:” mos të bën haxh ndonjë grua vetëm se me mahrem”.  
Ka thënë Imam Maliku: lejohet udhëtimi i gruas pa mahrem nëse haxhi është obligim nëse jo atëherë nuk lejohet.
- Dijetarët kanë divergjencë se a i obligohet burrit apo ndonjë të afërmit të shkon në haxh me gruan.  
Shumica e dijetarëve thonë: nuk i obligohet të shkon me të në haxh, dhe nëse nuk shkon vetëm se me kompensim ajo obligohet ta paguan atë.  
Ka thënë Imam Ahmedi : obligohet që burri të shkon në haxh me gruan e tij, ose i afërmi me të afërmen e tij, nëse nuk ka tjetër, sepse një njeri e ka pyetur të dërguarin dhe i ka thënë: o i dërguar gruaja ime dëshiron të shkojë në haxh a unë jam shkruar për në filan luftën të shkojë? I dërguari [salallahu alejhi ve selem] tha:” shko në haxh me gruan tënde”.
- Nuk konsiderohet mahrem buri i motrës, as burri i hallës, as burri i tezës, sepse ndalesa për martesë me ta është e përkohshme, vetëm nëse e shkurorëzon pastaj kalon një kohë atëherë i lejohet ta marton motrën e saj apo hallën e saj apo tezen e saj.

- Hadithi tregon se: muslimani duhet të i përgjigjë urdhrave të Allahut dhe të i përmbahet atyre pa u lëkundur, sepse është prej domosdoshmërisë së imanit. Ka thënë Allahu i Lartësuar:” **nuk i takon një besimtari as besimtareje që kur të gjykon Allahu në një çështje e ato të zgjedhin çka të duanë** “.
- Muslimani dhe muslimanja duhet të jenë syçelë dhe të largohen nga vendet e dyshimta.
- Islami ndalon nga çdo gjë që të dërgon në shkatërrim.

## Hadithi nr.34: Bashkimi ndërmjet dy namazeve

---

Allahu im ka obliguar pesë kohë që duhet ti falë muslimani gjatë natës dhe ditës, dhe e ka bërë për çdo namaz kohën e vet për shkak të urtësisë që Ai e din dhe e

ka obliguar muslimanin të i përmbahet kësaj kohe, ka thënë Allahu:”  
**me të vërtetë namazi për besimtarin është obligim (për kohë) i caktuar për besimtarët”.**

Falja e namazit çdoherë në kohën e vetë është vështirë për udhëtarin. Udhëtarin ari në përgjithësi është meshoqëri, dhe në ndonjë mjet udhëtimi të përgjithshëm, dhe ndoshta i ikë mjeti i udhëtimit nëse ndalet të falet, ose vendi ku eka zënë namazi është i papërshtatshëm për namaz, e shkaqe tjera.

Islami është feja e lehtësimit, nuk i ngarkon njerëzit me gjëra të rënda, ka thënë në i Lartësuar:”**nuk ka bërë në fe vështirësi**”, për këtë arsye e ka bërë bashkimin e namazeve në udhëtim lehtësim për besimtarët, siç ceket në hadithin në vijim:

Transmeton nga Ibn Abbasi [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem]

i bashkonte namazin e drekës me të ikindisë kur ishte në udhëtim, gjithashtu i bashkonte akshamin me jacinë.

### Dobitë e hadithit:

- Lejimi i bashkimit ndërmjet dy namazeve në udhëtim: nëse është udhëtim i gjatë shkurtohet në të namazi. Shumica e dijetarëve thonë se bashkimi ndërmjet namazeve është i lejueshëm në çdo udhëtim, dhe kjo nuk ka të bëjë vetëm me udhëtimin e haxhit. Kurse medhhebi Hanefi nuk e lejon bashkimin ndërmjet dy namazeve përveç se në arafat dhe në muzdelife. (kjo është gabim).
- Bashkimi bëhet në dy lloje: bashkim i hershëm, kjo është kur i falë dy namaze në kohën e namazit të parë, dhe bashkim i vonuar: kur i falë dy namazet në kohën e namazit të dytë, dhe të dy mënyrat janë të lejuara sipas shumicës së dijetarëve.
- Kusht në bashkimin e hershëm është që ta bën nijet (qëllim) që të i bashkon namazet kur të hynkoha, dhe nuk i ndanë ndërmjet namazeve e me asgjë përveç se me ikamet, p.sh.: kur të kryen namazin e parë si drekën pastaj ngritet e thotë



të ikametin dhe ja fillon ikindisë. Nëse e zgjatë pritjen ndërmjet këtyre dyjave nuk lejohet bashkimi. Kusht është që kur të i bashkon

vonë ta bën nijetin (qëllimin) para

se të del koha e namazit të parë, sepse nëse del koha e parë dhe nuk e ka ba qëllim atëherë ka mëkat, dhe namazi i parë bëhet kaza.

4) Namazet që bashkohen janë dreka me ikandinë apo akshami me jacinë, dhe e nuk bashkohet namazi i mëngjesit me namazet tjera.

5) Islami është feja e lehtësimit, për këtë arsye lejohet bashkimi dhe shkurtimi i namazeve, dhe marrja e tejemumit kur nuk ka ujë, dhe lehtësime tjera.

6) Hadithi tregon për rëndësinë e namazit në islam, sepse Allahu e ka bërë obligim kryerjen e tij në çdo gjendje, e ka lejuar bashkimin dhe shkurtimin e tij në udhëtim që mos të bëhet vështirësia e udhëtimit si shkak që të lihet namazi në udhëtim.

## Hadithi nr.35: Prej porosive të të dërguarit

---

Pejgamberi shpesh herë i veçonte disa nga shokët e tij me disa udhëzime dhe këshilla, m'varësisht nga gjendja e tyre ose nga ajo që shihte nga pasionet e tyre për disa çështje, dhe për shtimin e veprave të mira ose ka lënë ndonjë vepër që ka qenë me rëndësi për të.

Pejgamberi ua ka dhënë çdokujt barnat që ju kanë përshtatur. Nga këto porosi është edhe porosia e ebu Hurejres r.a. në hadithin në vijim:

Trans. nga ebu Hurejra r.a. se ka thënë: më ka porositur i dashuri im alejhi salam me tri porosi, nuk i lë derisa të vdes: agjërimi i tre ditëve në çdo muaj, namazi i duhasë dhe namazi i vitrit para gjumit.

Dobitë e hadithit:

- 1) Preferueshmëria e agjërit të tri ditëve në çdo muaj: nëse janë ditët e bardha është më mire. Trans. Nesaiu me zinxhir të mirë nga ibn Abbasi r.a. se ka thënë: pejgamberi nuk e lente agjërimin e ditëve të bardha as në udhëtim as në vendbanim.
- 2) Namazi i duhasë është i preferuar: duke u argumentu me hadithin e mëparshëm dhe nga ajo që trans. nga Tirmidhiu nga ebu Seid el Hudri r.a. se ka thënë: pejgamberi e falte namazin e duhasë derisa thonim nuk e len asnjë herë, dhe e lente derisa thonim nuk e fal më.
- 3) Namazi i vitrit para gjumit është më mirë për atë që nuk mundet të zgjohet natën. Nëse është i sigurt në vete se zgjohet atëherë më së miri është të falë natën. Trans. Xhabiri r.a. ka thënë: ka thënë i dërguari: "kush friget që nuk mund të zgjohet natën le të falë vitrin në fillim të natës, kush mund të zgjohet atëherë le të falet në fund të natës, se me të vërtetë namazi në fund të natës është i dëshmuar, prandaj është më mirë". Pejgamberi e ka kuptuar se disa nuk mundin të zgjohen natën dhe i ka urdhëruar ta falin në fillim të natës.
- 4) Me kryerjen e namazit dhe agjërit vullnetarë, ushtrohet trupi me këta adhurime që pastaj obligimet ti kryen me lehtësim.
- 5) Pasimi i udhëzimit të pejgamberit dhe veprimi sipas këshillave të tij derisa të ketë shpirt në trup dhe zemër që rreh.
- 6) Njohja e pejgamberit ndaj njerëzve dhe dhënia e mjekimit të përshtatshëm për çdo kënd, lehtësimi ndaj muslimanit dhe mosngarkimi me vepra që nuk mund ti bëjë.

## Hadithi nr.36: Rruga e xhenetit

---

Shokët e të Dërguarit[salallahu alejhi ve selem] kanë qenë të kujdesshëm që të shpëtojnë nga dënimi i Allahut dhe kanë qenë të përmalluar për kënaqësinë e Allahut dhe hyrjen në xhenetin e Tij. Për këtë arsye, kanë ardhur dhe shpesh e kanë pyetur të Dërguarin[salallahu alejhi ve selem] për rrugën që i shpie në cakun e tyre, edhe për punën që ua mundëson realizimin e dëshirës së tyre, e sidomos ata që takoheshin me të Dërguarin rrallë. I Dërguari i siguronte ata dhe u thoshte se të gjitha këto arrihen me përfilljen e urdhrave të Allahut dhe largimin nga ndalesat e Tij, pas besimit në Të.

Transmetohet nga Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të] se kishte ardhur një beduin<sup>2</sup> te i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] dhe i kishte thënë: *“Më trego një punë që nëse e bëj do të hyj në xhenet!”* Ai tha: *“Ta adhurosh Allahun dhe të mos i bësh ortak asgjë, ta falësh namazin e obliguar dhe të japësh zeqatin e domosdoshëm, ta agjërosh ramazanin.”* Beduini më pas tha: *“Pasha atë në dorën e të cilit është shpirti im, nuk shtoj më shumë se kaq!”* Kur shkoi ai, i Dërguar[salallahu alejhi ve selem] i tha: *“Kush dëshiron që ta shohë një njeri prej banorëve të xhenetit, le ta shikojë këtë.”*

### Dobitë e hadithit:

- Myslimani duhet të pyesë për atë që i intereson, për fenë e tij, për dunjanë e tij dhe për ahiretin e tij. Për këto duhet t'i pyesë njerëzit e diturisë që janë të devotshëm dhe të mire;
- Rëndësia e këtyre çështjeve të përmendura në hadith qëndron aty se këto janë shtyllat mbi të cilat është i ndërtuar Islami dhe se veprimi i tyre e shpie njeriun në xhenet. Nuk është përmendur haxhi në këtë vend, sepse pyetësi ka qenë duke shkuar në haxh;
- Veprat me të cilat ngarkohet myslimani janë dy llojesh: a) **vepra obligative**, për të cilat bën mëkat nëse i lë dhe b) **të preferuara**, lejohet lënia e tyre, mirëpo veprimi i tyre është më mirë. Ndërkaq, vazhdueshmëria në lënien e tyre dhe mospërfillja e tyre është mëkat, sepse të çon në anashkalimin e obligimeve. Nuk ia ka

---

<sup>2</sup> Beduin është njeriu që jeton jashtë qyteteve dhe fshatrave dhe vendbanimeve.

përmendur i Dërguari sunetet këtij pyetësi, sepse ai ishte i ri në Islam dhe nuk ka dashur që t'ia vështirësojë çështjen;

- Vazhdueshmëria në obligime e çon myslimanin që të veprojë vepra të preferuara dhe sunete. Kështu kanë qenë shokët e Pejgamberit, të cilëve u patë zënë vend Islami në zemrat e tyre, nuk kanë bërë dallim ndërmjet suneteve dhe obligimeve në pikëpamje të vazhdueshmërisë;
- Në hadith ka përgëzim për çdo besimtar që i vepron këto vepra, që do të përfundon me mirësi, me mëshirën e Allahut.

## Hadithi nr.37: Dënimi i mosdhënësit të zekatit

---

Islami është feja e ndihmesës dhe barazisë shoqërore ndërmjet njerëzve. Për këtë arsye, Allahu I Lartësuar ka bërë obligim zekatin në pasurinë e të pasurve, për t'i përmbushur nevojat e të varfërve dhe e ka bërë atë shtyllë prej shtyllave të Islamit dhe e drejtë e të varfërve dhe nevojtarëve. Nëse të pasurit nuk e japin zekatin me dëshirë, u merret me fuqi. Nëse kanë pasuri të dukshme, u humbet shpërblimi. Nëse nuk e kanë pasurinë të dukshme dhe as nuk e japin me dorën e tyre, atëherë do të dënohen në botën tjetër me dënim shumë të dhembshëm.

Në hadithin në vijim na tregohet për një lloj prej dënimeve që e shijojnë mosdhënësit e zekatit.

Transmetohet nga Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: *“Ka thënë i Dërguari [salallahu alejhi ve selem]: “Kujt i jep All-llahu pasuri dhe nuk e jep zeqatin e saj, i paraqitet në Ditën e Kiametit sikur një gjarpër me kokë të verdhë dhe me dy pika mbi sy, e shtrëngon për fyti, pastaj e kafshon në faqen e tij dhe i thotë: “Unë jam pasuria jote e rrojtur.” Pastaj e lexoi (ajetin) “dhe mos ta llogaritin ata që janë koprracë...”*

Dobitë e hadithit:

- Zekati është prej shtyllave të Islamit. Nxjerrja dhe dhënia e zekatit është obligim prej obligimeve më të rëndësishme, sepse një kërcënim i rëndë dhe dënim i dhembshëm nuk bëhet vetëm se për atë që i lë obligimet;
- Nxitja për nxjerrjen e zekatit për të shpëtuar nga dënimi që e pret Ditën e Kiametit për atë që është koprrac për dhënien e tij në këtë botë;
- Allahu nuk bën padrejtësi as sa grimca e atomit, që do të thotë se nuk i humbin askujt te drejtat;
- Është obligim për myslimanin që t'i ndihmon vëllait të tij, t'ia jep dorën e ndihmesës, t'ia largon brengat, t'ia lehtëson telashet;
- Feja islame e bën që njeriu ta kritikon veten e tij, që buron nga besimi në Allahun e lartësuar të cilit nuk i fshihet asgjë. Ne besojmë se Ditën e Kiametit do të japim llogari për çdo send;

- Kopraccia nuk është prej cilësive të besimtarëve. Ai e di që pasuria është e Allahut, Ai ia jep kur të dojë dhe ia merr kur dojë, dhe ia kthen atë shumëfish për atë që e shpenzon në rrugë të tij;
- Pasuria të cilës i jepet zeqati nuk konsiderohet e deponuar edhe nuk dënohet njeriu dhe as nuk pyetet për ruajtjen e saj;
- Ditën e Kiametit ka lloj-lloj dënimesh dhe nuk është i kufizuar vetëm në zjarrin e xhehenemit;
- Kush e kryen një krim ose e lë ndonjë obligim dhe pastaj shpëton prej drejtësisë në këtë botë, le të mos mendojë se ka shpëtuar, por kjo është një humbje e madhe, atë ditë kur e pret dënimi i dhembshëm dhe nuk do t'i bëjë dobi as pasuria as shoqëria.

## Hadithi nr.38: Lemosha më e mirë

---

Feja islame ka nxitur në shpenzim dhe lëmoshë, përveç asaj që ka obliguar Allahu për dhënie të zeqatit. Krejt kjo që të shtohet afërsia ndërmjet njerëzve dhe të largohet zilia, urrejtja etj. Allahu ka premtuar shpërblim të madh për lëmoshën, për këtë arsye shokët e të Dërguarit bënin gara në lëmoshë dhe mundoheshin të fitojnë më shumë shpërblime.

Transmetohet se Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të] ka thënë: *“Erdh një njeri te i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] dhe tha: “O i Dërguari i Allahut, cila lëmoshë është më e vlefshme?” Ai tha: “Të japësh lëmoshë duke qenë i shëndoshë dhe të dhimbet pasuria, i frikohesh varfërisë dhe shpreson në pasuri. Dhe mos prit derisa të të vijë shpirti tek arra e fytit, e të thuash “për filanin kaq, për filanin kaq”, kurse ajo (pasuria) më është e dikujt tjetër.”*

### Dobitë e hadithit:

- Nxitja për shpenzim në rrugë të Allahut, veprimi i mirësive dhe veprave të mira, dhe mosvonimi i tyre;
- Shfrytëzimi i mundësive, siç ka ardhur në hadith: *“Shfrytëzoi pesë para pesëve: jetën para vdekjes, shëndetin para sëmundjes, kohën e lire para angazhimit, rininë para pleqërisë, pasurinë para varfërisë”;*
- Të shpenzohet pasuria më e dashur tek njeriu. Ka thënë Allahu: **“Nuk do ta arrini mirësinë, para se të shpenzoni atë që e doni”;**
- I sëmuri në shtratin e vdekjes nuk ka të drejtë të plotë në pasurinë e tij, pos sa ia lejon feja dhe ajo është një e treta. Gjithashtu, nëse do të lërë testament lëmoshe për dikë, nuk i lejohet më shumë se sa një e treta prej pasurisë;
- Sahabët kanë pasur kujdes për veprimin e punëve të mira dhe kërkimin e veprave më të mira;
- Myslimani gjithmonë e kërkon atë që i bën dobi dhe e afron kah Allahu i lartësuar dhe i pyet dijetarët për veprat e mira;

- Luftimi i vetvetes nga vesi i koprracisë. Kjo bëhet nëpërmjet sjelljeve të mira, me sjellje të Kuranit dhe pasimin e të Dërguarit, adaptimin e vetes dalë-ngadalë në shpenzim dhe dhënie.



## Hadithi nr.39: Vetëpërmbytja në kërkimin e pasurisë

---

Feja islame nuk e ndalon grumbullimin e pasurisë, mirëpo e lufton lakminë, e edukon myslimanin të ketë krenari dhe bujari. Ai e mbledh pasurinë nëse i vjen pa e përulur veten në kërkimin e tij. Kur t'i vijë pasuria, e shpenzon në rrugë të Allahut dhe në kënaqësinë e tij.

Transmetohet se Hakim ibën Hizami [Allahu qoftë i kënaqur me të] ka thënë: *“I kam kërkuar të Dërguarit [salallahu alejhi ve selem] pasuri dhe më ka dhënë, pastaj i kam kërkuar dhe përsëri më ka dhënë, më pas më tha: “O Hakim, pasuria është e ëmbël dhe e freskët. Kush e fiton me nder, i jepet begatia në të, kush e fiton pa nderë, i hiqet begatia nga ajo dhe është sikur ai që ha dhe nuk ngopet. Dora e lartë është më e mirë se dora e ulët”.*

### Dobitë e hadithit:

- Kanë ra në ujdj dijetarët se kërkimi i lëmoshës pa qenë i detyruar është i ndaluar. Transmeton Muslimi nga Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të] se i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] ka thënë: *“Kush kërkon nga pasuria e njerëzve duke pasur për qëllim shtimin e saj, ai ka kërkuar një gacë prej xhehenemit, prandaj të kërkon pak ose shumë”.* Gjithashtu, edhe nëse lypësi është i varfër, mirëpo ai mund të punojë apo fitojë. Ndërsa nëse lypësi është i varfër dhe pa mundësi për të punuar apo është i aftë për punë, por nuk gjen punë, atij i lejohet të kërkohet, edhe pse vetëpërmbytja është më e mirë, pos nëse vetëpërmbytja çon në shkatërrim nga uria, duke mos e vërejtur njerëzit atë. Edhe pse lejohet kërkimi i lëmoshës, duhet të largohet nga kërkimi i saj për hir të fytyrës së Allahut të lartësuar. Nëse ka nevojë, le të kërkohet prej njerëzve të devotshëm, nga të pasurit, ata të cilët nuk e ndalojnë të drejtën e të varfrit, të cilët nëse e dinë ndonjë të nevojtar, i japin dhe nuk e kthejnë;
- Nxitja në vetëpërmbytje, bindje dhe kënaqësi me atë që e ka caktuar Allahu edhe nëse është pak;
- Njeriu duhet t'i kërkohet rrugët e ndershme të fitimit dhe jetesës;

- Largimi nga kërkimi i pasurisë me nënvlerësimin e vetes apo lypjen e tepërt;
- Nxitja për kërkim të punës dhe kërkim të furnizimit nga rrugët e lejuara, derisa të largohet nga kërkimi dhe t'u bëjë dobi të tjerëve me dhënie dhe të bëhet shpenzues e jo kërkues;
- Nxitja për lëmoshë dhe shpenzim në rrugët e dobishme.

## Hadithi nr. 40: Lëmosha për cdo musliman

---

Muslimani duhet të jetë anëtar i dobishëm i shoqërisë. Ai duhet të punojë për mirësinë, të jetë thirrës kah mirësia dhe udhëzimi ose t'u bëjë dobi njerëzve me pasurinë e tij apo t'u ndihmojë me pune fizike, t'u ndihmojë me gjuhën e tij, duke i orientuar mirë dhe duke i këshilluar. Nëse nuk mund t'i bëjë dobi shoqërisë, atëherë më së paku të jetë i dobishëm për veten dhe mos t'i bëjë dëm shoqërisë.

Transmeton Ebu Musa el Eshariu [Allahu qoftë i kënaqur me të]nga i Dërguari [salallahu alejhi ve selem] se ka thënë: *“Çdo musliman duhet të japë lëmoshë”*. Thanë: *“O i Dërguari i All-llahut, e ai që nuk ka?”* Tha: *“Punon me duart e tij, i bën dobi vetes dhe jep lëmoshë”*. Thanë: *“E nëse nuk ka?”* Tha: *“Le të veprojë mirë dhe le të ndalohet nga e keqja, sepse kjo për të është lëmoshë”*.

### Dobitë e hadithit:

- Nxitja për shpenzim dhe dhënie të lëmoshës. Ka thënë i Lartësuari: **“Çdo send që shpenzoni, ajo do t'u kompensohet”**, gjithashtu ka thënë: **“Shpenzoni nga ajo që u ka bërë kujdestarë të saj”**;
- Nxitja për fitim, që t'i përmbushë nevojat e veta dhe t'u bëjë dobi njerëzve;
- Njeriu duhet që në shpenzim së pari herë të fillojë prej te vetja e tij, ajo që i tepron e shpenzon në atë që e ka obligim fëmijët e tij, nëse i tepron diçka nga nevojat e tyre, atëherë e shpenzon te të tjerët, dhe kështu është më së miri;
- Veprat e mira të përmendura në hadith e zënë vendin e lëmoshës në shpërblim, sidomos për atë që nuk mund të jep lëmoshë;
- Sa i përket të pasurit, lëmosha për të është më e mirë se sa disa vepra të mira, sidomos ata të cilët nuk u bëjnë dobi të tjerëve;
- Nuk është për qëllim në hadith renditja e veprave sipas pyetjes, mirëpo kush jep lëmoshe dhe u ndihmon të tjerëve, është më mirë, sepse ai që i ka dy cilësi është më i mirë se sa ai që e ka një dhe kështu me radhë;

- Prej cilësive të myslimanit është kujdesi ndaj krijesave të Allahut të lartësuar dhe bërja dobi ndaj tyre me pasuri ose me diçka tjetër;
- Në këtë hadith ka lehtësim për atë që nuk ka mundësi të bëjë të mira, sidomos nëse pamundësia është pa dëshirën e tij;
- Prej të drejtave të myslimanit është që ta pyet dijetarin për atë që nuk e kupton.

## Hadithi nr. 41: Dinjiteti i muslimanit

---

Feja islame i edukon pasuesit e vetë që të kenë dinjitet dhe çiltërsi në brendësinë dhe të jashtmen e tyre. Prandaj nuk është i kënaqur që pasuesit e tij të e nënçmojnë veten e tyre duke kërkuar pasuri prej dikujt tjetër, duke e shtrirë dorën e që ndoshta kthehen duarzbrazur. Në këtë mënyrë e humbasin krenarinë e tyre. Allahu thotë: **”krenaria i takon Allahut, të dërguarit të tij dhe besimtarëve”**.

Në të njejtën kohë dëshiron nga muslimani që të jetë pjesë e dobishme e shoqërisë, që ti bëj dobi vetes dhe të tjerëve, të merr pjesë në ndërtimin e tij, të mëson të tjerët nga përvoja dhe puna e tij ashtu sikur merr nga përvojat e të tjerëve dhe puna e tyre. Për këtë arsye ka kërkuar nga muslimani punën dhe zhvillimin duke i përvetur krahët për aktivitet që ti bënë dobi popullit të tij dhe ta largojë veten e tij nga kërkimi prej njerëzve, nga nënçmimi i vetes dhe mos të jetë ngarkesë për ata.

Kjo është që tregohet në hadithin në vijim:

Transmetohet nga ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të] se i dërguari [salallahu alejhi ve selem] ka thënë: ”pasha atë në dorën e të cilit është shpirti im, të merr dikush nga ju litarin dhe të bartë dru në shpinën e tij, është më mirë për të se sa të shkon te një njeri të i kërkon, pamvarësisht i jep gjë ose jo”.

### Dobitë e hadithit:

- Nxitja për tu larguar nga kërkimi prej njerëzve, edhe nëse njeriu detyrohet që të punon punë të rënda në kërkimin e furnizimit.
- Nxitja për punë, qartësimi se jeta më e mirë është kur ushqehesh nga puna e dorës tënde, edhe nëse është profesion i thjeshtë në sytë e njerëzve. Transmeton Buhariu se i dërguari [salallahu alejhi ve selem] ka thënë: ”Davudi alejhi selam nuk ka ngrënë vetëm se nga puna e dorës së tij”. Transmetohet nga Omer ibn Hattabi [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: ”fitimi që përmban diçka nga poshtërimi është më e mirë se të kërkuarit nga njerëzit”.
- Prej dobive të punës dhe fitimit është se nuk ke nevoj për njerëzit e pasur, dhe ke mundësi të japësh lëmoshë ndaj të varfërve.
- Thonë disa dijetarë se puna e dorës është fitimi më i mirë, disa të tjerë kanë thënë tregtia është më e mirë, e disa të tjerë thonë se

bujqësia është më e mirë se është më afër mbështetjes ndaj Allahut.Në të gjitha këto profesione ka mirësi ndoshta ndonjëra në ndonjë kohë është më e mirë se tjetra,dhe anasjelltas sipas nevojës së popullit dhe dobisë që e sjell.Transmeton Muslimi nga ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të] se i dërguari [Allahu qoftë i kënaqur me të]ka thënë:"Zekerija alejhi selam ka qenë zdruckhtarë".

- Lejimi i fitimit nga të lejuarat,ose gjërat që nuk janë pronë e askujt,sikur drujt,kullosat që dalin në toka që nuk jane pronë e dikujt.
- Muslimani është krenarë dhe dinjitoz,nuk duhet të pranon të punojë në vende që e nënçmojnë atë,për të fituar ndonjë gjë prej kësaj bote,qoftë pak apo shumë.
- Vlera e punës në jetë,nevoja e njerëzve për punë,sepse nëse humbet puna prishet jetesa dhe dobësohet populli.

## Hadithi nr.42: Zekati i fitrit

---

Allahu i Lartësuar ka bërë për muslimanët kohë kur u ka lejuar që në të gëzohen dhe të festojnë, të kënaqen me ushqime të këndshme dhe pije, dhe të zbukurohen me tesha të reja dhe të kenë pamje të bukur. Për t'i përfshirë gëzimi të gjithë muslimanët të pasurit dhe të varfërit, Allahu u ka obliguar të pasurve përveç zekatit të pasurise që e kanë obligim, edhe disa detyrime tjera të veçanta në disa kohë, me qëllim që të shtohet gëzimi, të shtohet dashuria, të forcohet lidhja vëllazërore ndërmjet muslimanëve më shumë në raste gëzimi e hidhërimi.

Nga këto kohë është edhe fitër bajrami, që obligohet ndihmesa e të varfërve, siç e shpjegon hadithi në vijim:

Transmetohet nga ibn Omeri [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: I dërguari [salallahu alejhi ve selem] e ka obliguar zekatul fitrin një sa'ë<sup>3</sup>(masë matjeje) prej hurmave, ose sa'ë prej elbit, për robin dhe të lirin, për mashkullin dhe femrën të madhin e të voglin prej muslimanëve, dhe e ka obliguar që të jepet para daljes së njerëzve për namaz(të bajramit).

### Dobitë e hadithit:

- Zekati i fitrit është obligim për muslimanin e lirë. Sipas imam Shafiut për dhënien e tij kushtëzohet posedimi i ushqimit më tepër se sa i duhet për veten dhe ata që i ka obligim të përkujdeset për ta ditën dhe natën e bajramit, ndërsa sipas imam Ebu Hanifes nuk i obligohet vetëm atij që e posedon nisabin e zekatit (masën më të vogël për obligueshmërin e tij). Kur të obligohet dhënia e zekatul fitrit, obligohet dhënia për gjithë fëmijët e tij, përderisa janë te vegjël por nëse janë fëmijët e mëdhenj e japin për vete, sa i përket bashkëshortes, Shafitë thonë se obligohet burri të paguan fitrat e gruas së tij.
- Koha e obligueshmërisë të zekatul fitrit dhe nxjerrjes së tij: sipas xhumhurit(shumicës) së dijetarëve, obligohet të jepet pas perëndimit të diellit në ditën e fundit të ramazanit, dhe në fillimin e natës së parë të bajramit. Ndërsa sipas Hanefive obligohet pas lindjes së diellit në ditën e parë të bajramit. Dobia e divergjencës është se nëse lindet një foshnje pas perëndimit të diellit, natën e bajramit dhe para lindjes së diellit, atëherë nuk obligohemi të japim për të zekatul fitr sipas shumicës së dijetareve ndërsa sipas Hanefive duhet të jepet. Nëse

---

<sup>3</sup> Sae' është mase matese e kohes se te derguarit alejhi selam qe peshon perafersisht 2.400 kg(dy kilogram e 400 gram).

vdesh dikush në këtë kohë atëherë vlen e kundërta obligohet për të të jepet zekatul fiter sipas shumicës së dijetarëve ndërsa sipas Hanefive nuk obligohet.

Koha e dhënies së zekatul fitrit, të gjithë dijetaret janë të pajtimit se jepet para daljes për faljen e namazit të bajramit, preferohet nxjerrja e tij para bajramit një dite ose dy ditë, që të ketë mundësi i varfëri të perfitojë, kjo është transmetuar nga ibn Omeri r.a.

Ndërsa përshpejtimi i tij më shumë se kaq, sipas Shafive lejohet të nxjerrët që nga fillimi i ramazanit.

Ndërsa vonimi i tij pas namazit të bajramit, janë pajtuar të gjithë dijetarët se vonimi më shumë se dita e bajramit nuk është i lejuar, ndërsa nxjerrja e tij pas namazit të bajramit është mekruh(e urryer), dhe nuk bie obligueshmëria me vonim, por e jep dhe i konsiderohet lëmoshe e rëndomte. Siç qëndronë në hadithin e Abdullah ibn Abbasit se kush e jep para namazit (të bajramit) ajo është zekat(fiter)i pranuar, ndërsa kush e jep pas namazit ajo është lëmoshe e rëndomte.

- Masa e caktuar në zekatul fitr sipas shumicës së dijetarëve një sa'ë (masë përafërsisht 2.5 kg) për çdo njeri, çfarëdo qoftë gru, hurma, rrush i thatë, elb ose diçka tjetër. Hanefitë kanë thënë sikur shumica e dijetarëve përveç në çështjen e grurit. Ata thonë se gru duhet të nxirret gjysmë e saj për çdo njeri, dhe argumentohen me ngjarjen e Muavi ibn ebi Sufjanit [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ai ka mbajtur fjalim në haxh dhe ka thënë: mendoj se dy grushta nga gruri i Shamit barazohen me një sa'ë nga hurmat. Dhe njerëzit kanë filluar të punojnë sipas këtij.  
Baza është të nxirret ushqim nga i cili hanë shumica e popullit të atij vendi, dhe e ka lejuar ebu Hanifja nxjerrjen e tij (zekatul fitrit) vlerën e ushqimit (në të holla). Ndoshta kjo është më e dobishme për te varfërin.
- Ti jepet zekatul fitri atij që i jepet zekati i pasurisë këto janë që i ka përmendur Allahu i Lartësuar në kuran: **“Më të vërtetë zekati ju takon të varfërve, skamnorëve, mbledhësve të tij, për përfitimin e zemrave, për lirimin e robërve, për te zhyturit në borxhe, në rrugë të Allahut dhe udhëtarit”**.
- Hadithi na mëson kujdesin e fesë islame për forcimin e lidhjes vëllazërore, ndihmesën ndërmjet muslimaneve, dhe kujdesi për të futur gëzimin dhe lumturinë në çdo rast.



- Muslimani e ka obligim që çdoherë të kujdeset për ndihmën ndaj vulluat të tij musliman,dhe të jetë afër tij në gëzime dhe hidhërime.
- Madhështia e Islamit në ligjet e tij, drejtësinë e tij, në udhëheqje dhe rregullim.

## Hadithi nr.43: Shitja e arrit dhe argjendit

---

Feja islame bën thirrje në ndihmesë ndërmjet anëtareve të shoqërisë. Gjithashtu na tërheq vërejtjen nga çdo shfrytëzim i nevojtarit. Prej shfrytëzimeve që ka tërhequr vërejtjen më shumë, dhe ka ndaluar rreptësisht është që t'i jep një njeri dikujt borxh me kusht që kur të ja kthen borxhin, të ja kthenë më shumë. Kjo në gjuhën fetare quhet kamatë, ose ndryshe quhet fajde. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Allahu e ka lejuar shitblerjen dhe e ka ndaluar kamatën”,** gjithashtu ka thënë: **“e humbë Allahu kamatën dhe e shtonë lëmshën”,** gjithashtu ka thënë: **“o ju të cilët keni besuar keni frikë Allahun dhe braktisni atë çka ka mbetur(prej kohës së injorancës)nga kamata, nëse jeni besimtarë”.**

Nëse disa marrëveshje të tregtisë të dërgojnë në kamatë, ose janë shkak për kamatë, këtë e ka ndaluar feja Islame, dhe ka tërhequr vërejtje përveç nëse është me kushte dhe me kufizime.

Transmetohet nga Ebi Bekra [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem]: “mos e shitni arin me ari përveç njëjtë me njëjtë(barabartë), dhe as argjendin me argjend përveç njëjtë me njëjtë(barabartë), dhe shitni arin me argjend edhe argjendin me ari si të doni”.

### Dobitë e hadithit:

- Shitja e arit me ari, ose shitja e argjendit me argjend ose shitja e njëres për tjetrën, tek dijetarët quhet shkëmbim. Dhe kushtëzohet në të që të jenë të njëjta, mundësia e zgjedhjes dhe marrja(kapja)në vend nëse nuk ndryshon lloji. Ndërsa lejohet që të ketë diference por kushtëzohet mundësia e zgjedhjes dhe marrja në vend nëse ndryshon lloji. Sikur që konsiderohet fetarisht kjo lloj shitblerje kamatë, nëse bjen në të kuptimi i kamatës. Në qoftë se ndodh diferenca nëse lloji është i njëjte, ose caktohet afati në ndonjë marrëveshje edhe nëse lloji është i njëjte apo lloji i ndryshëm. Edhe kjo është e ndaluar fetarisht sepse është shkak që të dërgon në kamatë. Ka thënë i dërguari alejhi selam : “shitja e arit me ari është kamate përveç, merr dhe merr”, gjithashtu tha: “shitja e argjendit është kamatë përveç merr dhe merr”, gjithashtu ka thënë:” ari me ari dhe argjendi me argjend,...sasi e njëjte me të njëjt,një lloj me një lloj, kush shton, ose kërkon shtesë ai ka hyrë në kamatë”d.m.th.ka bërë mëkatin e kamatës.  
Dijetarët kamatën e ndajnë në dy pjesë:  
Kamata e diferencës apo shtesës: është kur lloji është i njëjte mirëpo shtohet njëri kompensim më shumë se tjetri.

Kamata e vonimit: ndodhë kur caktohet afat në marrëveshje edhe nuk bëhet marrja në vend, edhe nëse është lloji i njëjtë apo lloji i ndryshëm, edhe nëse barazohet pesha apo ndryshon pesha.

Shkurtimisht dispozita në këtë lloj shitblerje është: se ndalohet fetarisht diferenca edhe vonimi, nëse lloji është i njëjtë në të dy kompenzuesit siç është ari me ari ose argjendi me argjend. Ndërsa lejohet diferenca dhe ndalohet fetarisht vonimi, nëse ndryshojnë lloji në dy kompenzuesit siç është shitja e arit me argjend dhe e kundërta.

- Sipas dijetarëve Hanefi: shembulli i arit dhe argjendit është sikur shembulli i çdo sendi që matet dhe çdo send që peshohet, ndërsa sipas dijetarëve Shafii: çdo send që hahet edhe çdo send që ka vlerë. Në atë shitblerje që gjenden dy defekte ndalohet në të diferenca dhe vonimi, ndërsa në atë në të cilën gjendet një defekt lejohet në të diferenca mirëpo ndalohet vonimi, ndërsa nëse nuk gjendet asnjëra nga dy defektet atëherë lejohet diferenca edhe vonimi.

Defektet sipas Hanefive janë:se kompenzuesit janë masa edhe pesha nëse është lloji i njëjte, ndërsa defektet sipas Shafive janë:se kompenzuesit janë send qe hahet apo edhe send që ka vlere nëse është lloji i njëjte.

Të dy medhhebet në këtë çështje argumentohen me hadithin që e transmeton imam Muslimi edhe imam Ahmedi nga Ubade ibn Samit se ka thënë: ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem]:”ari me ari, argjendi me argjend, gruri me grurë, elbi me elb, hurma me hurma, krypa me krypë, (lejohet)njëjtë me njëjtë, njëlloj me njëlloj, dorë në dorë, nëse ndryshojnë këto lloje shitni siç te doni nëse është dore në dorë”.

- Hadithi na tregon për shtengimin e fesë islame edhe për kujdesin e saj në çështjen e kamatës, si dhe mbylljen e çdo dëre që të dërgon deri atje.
- Lehtësimi i islamit edhe gjerësia e tij në marrëdhëniet ndërmjet njerëzve, në largimin e njerëzve nga sendet e dyshimta, vendosja e rregullave, dhe sigurohet largimi nga të ndaluarat.

## Hadithi nr.44: Zgjedhja e vendit për dy tregtar

---

Kur erdhi feja Islame njerëzit bënë ndërmjet vete shitblerje dhe feja Islame e la ashtu siç ishte, mirëpo i vendosi kushte dhe kufizime. Vendosi edhe rregulla me qëllim që të i ruan pasuritë e njerëzve, dhe të ua mbron të drejtat e tyre. Që ti bëjë të jenë të sigurtë në punën e tyre, dhe ti largon prej tyre mospajtimet dhe zënkat, e ti largon shkaqet e shumë armiqësive.

Në të njëjtën kohë i ka nxitur në sinqeritet, i ka urdhëruar në këshillim gjatë punës, dhe mos mashtrimin e njeri tjetrit “kush mashtron nuk është prej nesh”(hadith),ua ka tërhequr vërejtjen nga falsifikimi dhe tradhtia.

Transmetohet nga Hakim ibn Hizam [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë, ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem]: “Dy shitësit kanë mundësi zgjedhjeje derisa nuk janë ndarë, ose tha: “ derisa të ndahen, nëse janë të sinqerte dhe të qarte ndaj njeri tjetrit ju begatohet tregtia e tyre, ndërsa nëse fshehin dhe gënjejnë atëherë ju humbet begatia e tregtisë së tyre”.

### **Dobitë e hadithit:**

- Hadithi është i qartë në vlefshmërinë e zgjedhjes nga dy palët, dijetarët kanë divergjencë se çka është për qellim me ndarjen, dhe kur vazhdon shitblerja dhe nuk ka mundësi zgjedhjeje. Dijetarët Shafi dhe Hanbeli thonë se te ndarja për qellim është ndarja me trupa, dhe se nuk është patjetër të realizohet shitblerja përdërisa janë në vendin e marrëveshjes ,e tek ata kjo quhet zgjedhja e vendit. Dhe thonë kjo është baza në kuptimin e ndarjes. Këtë e kanë argumentuar edhe me hadithin që e transmeton ibn Omeri [Allahu qoftë i kënaqur me të] dhe se ai kur ka dëshiruar që të bën ndonjë shitje, është ngritur nga vendi i tij dhe i ka bërë disa hapa. Ndërsa dijetaret Hanefij edhe Malikij thonë se: ndarja për qellim është ndarja e fjalëve e ajo është pohimi dhe pranimit dhe se nëse donë që të kthehet nga pohimi i tij njeri nga dy shitblerësit ai e ndryshon qëndrimin para se ta pranon tjetri. Sikurse edhe tjetri ka mundësi ta pranon ose mos ta pranon dhe ta refuzon, dhe kur ta pranon është i detyruar të i përmbahet marrëveshjes dhe se nuk ka të drejte asnjëri ta prish marrëveshjen pas pohimit dhe pranimit. Janë argumentuar në qëndrimin e tyre se marrëveshja realizohet me

pohim dhe pranim, më fjalën e të lartë madhëruarit ku ka thënë:”  
**realizoni marrëveshjet ” el Maide.**

- Hadithi na tregon se obligohemi që ta këshillojmë muslimanin dhe se mashtrimi ndaj tij është i ndaluar.
- Vlera e sinqeritetit dhe nxitja në të, dhe nënvlerësimi i gënjeshtërs dhe kujdesi nga ajo.
- Këshilla dhe sinqeriteti i shtonë të mirat dhe begatitë ndërsa mashtrimi dhe gënjeshtria e humbë begatinë dhe mirësinë.
- Kush punon për botën e ardhshme e arrinë dobinë e kësaj bote dhe të botës së ardhshme ,ndërsa kush e ka për qëllim vetëm këtë botë e humbë shpërblimin e botës së ardhshme dhe ndoshta e humbë dobinë e kësaj bote.

## Hadithi nr. 45:Fitimi i dëmshëm

---

Islami ka ndaluar nga disa shitblerje ,me të cilat kanë punuar në kohën e injorancës, për shkak se në to ka pasur shfrytëzim edhe humbje të pasurisë. Gjithashtu ka ndaluar nga veprimi i disa punëve sepse në to ka humbje të burrërisë edhe humbje të nderit të njeriut. Ka ndaluar edhe disa çështje tjera që nga jashtë dhe në realitetin e saj kundërshtojnë me frymën e legjislacionit Islam dhe qëllimet e tij të larta, i cili ka për qëllim shpëtimin e njerëzve nga politeizmi edhe manifestimet e tij dhe atë që të dërgon te ai.

Transmetohet nga Ebu Xhuhajfe [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ai e ka blerë një rob që bënte hixhame, dhe urdhëroi që mjetet e hixhames të thehen dhe ashtu u bë. Pastaj tha: ka ndaluar i dërguari [salallahu alejhi ve selem] nga çmimi i qenit, nga çmimi i gjakut, nga ai që bën tatuazhe edhe atij që i bëhet tatuazhe, nga ngrënia e kamatës dhe atij që e jep, si dhe e ka mallkuar pikturuesin(e gjallesave).

### **Dobitë e hadithit:**

- Dispozita e shitjes së qenit: Shumica e dijetarëve thonë se nuk lejohet shitja e qenit assesi, edhe nëse është qen gjuetie, dhe se vlera e tij është e ndaluar, dhe se është fitim i keq, sepse qeni është i papastër në esencë sikur derri, dhe ka hadithe që flasin rreth kësaj çështje. Ka thënë Ebu Hanifja r.h.: lejohet shitja e tij nëse përdoret për roje ose gjueti, dhe lejohet vlera e tij. Dhe Hanefitë janë përgjigjur ndaj haditheve që e ndalojnë, dhe thonë se ka qenë në fillim të islamit, dhe se ka qenë e obliguar vrasja e tyre edhe mos lejimi për mbajtjen e tyre dhe përfitimin prej tyre. Pastaj është lejuar mbajtja e tyre dhe përfitimi prej tyre.
- Dispozita e hixhames dhe marrja e kompensimit për të: hixhameja në vete është e lejuar, sepse te dërguarit i është bërë hixhameja siç është vërtetuar në transmetime të vërteta, përderisa është e lejuar atëherë edhe bartja e kësaj si profesion është e lejuar, edhe pse është prej profesioneve të ulëta, ngase ka të bën me heqjen e gjakut.  
Sa i përket marrjes se kompensimit për hixhamen: shumica e dijetarëve e konsiderojnë të lejuar, sepse është vërtetuar në hadithe të vërteta se të dërguarit i është bërë hixhame dhe atij që i ka bërë hixhamen e ka paguar, nëse kishte qenë e ndaluar nuk i kish dhënë i dërguari i Allahut. E për ndalesën që është transmetuar në disa hadithe kanë thënë se është mekruh tenzihij. Ndërsa Ebu Hanife thotë: nuk lejohet marrja e kompensimit për hixhame sepse i

dërguari “ka ndaluar nga paga e amoralitetit dhe fitimi i atij që bën hixhame”, përderisa e ka krahasuar me pagën e imoralitetit për të cilën ka konsensus se është e ndaluar njëjtte vlen edhe për fitimin e atij që bën hixhame.

- Ndalesa e tatuazheve, kjo është çështje që për të ka konsensus dhe nuk ka mospajtim ndërmjet dijetareve sepse për këtë është transmetuar mallkimi edhe mallkimi nuk është vetëm për gjerat e ndaluara.
- Ndalesa e kamatës, edhe mohimi i rreptë, dhe se ata që e marrin edhe e japin kamatën janë të njëjtë në dispozitë.
- Me të vërtetë pikturimi (i sendeve të gjalla) është prej ndalesave më të rrepta, sepse i dërguari e ka mallkuar, atë që pikturon, edhe mallkimi nuk bëhet vetëm së për gjerat e ndaluara. Ndalesa e përfshinë pikturuesin edhe atë që pikturohet, nëse është me dëshirën e tij dhe është në moshën madhore i pikturuari. Për këtë çështje kanë folur shumë dijetarët, dhe nga hadithet kuptohet se është e ndaluar të pikturohet çdo gjë e gjallë. Nëse lejohet diçka prej pikturimit sikur: fotografia e letërnjoftimit ose për ndonjë analizë mjekësore ose të ngjajshme, atëherë është e lejuar me rregullin domosdoshmëria e bënë të lejuar të ndaluarën, dhe kjo lejohet me masë të caktuar sipas domosdoshmërisë edhe nuk lejohet çka teprohet nga ajo, sepse domosdoshmëria matet sipas nevojës për të.
- Nxjerrët prej hadithit se çdokush që ndihmon për kah e keqja merr pjese në mëkat.
- Nxitë feja Islame në fitimin e lejuar ndërsa largon nga fitimi i ndaluar.
- Largimi nga papastërtia edhe largimi nga çdo send që ka të bëjë me të.

## Hadithi nr.46: E drejta e ndërmjetësimit

---

Feja islame e mbron të drejtën e individit, e mbron dinjitetin e tij, dhe personalitetin e tij. Prandaj ka sjellur ligje që janë komfort natyrës së tij edhe i plotëson kërkesat dhe dëshirat e tij. Nga këto ligje është e drejta e tij që t'ia falë dhe të vepron çka të dëshiron në atë që posedon, individi ka të drejte të posedon sa të dëshiron nga pasuria dhe të bën me pasurine e tij çka të dëshiron, nga vet dëshira e tij dhe zgjedhja e tij.

Edhe nuk i takon askujt që të ndërhyt në çështjen e tij apo t'ia mer pronësimin e tij përveç me lejen e tij. Mirëpo feja islame në të njëjtën kohë e mbron të drejtën e shoqërisë, edhe është e rezervuar ndaj egoizmit të individit e cila mund t'a kaplon atë ndonjëherë, dhe ta bënë që ai të i bën dëm tjetrit, për këtë arsye ka vendosur rregulla dhe kushte për pronësim, edhe ka vendosur disa ligje që kanë për detyrë ta rregullojnë sjelljen e individit me pronën e tij, që mos të jetë mjet për dëm ndaj te tjerëve ndonjëherë, nga këto ligje është edhe e drejta e ndërmjetësimit që ne e sqarojmë nga hadithi i radhës:

Transmetohet nga Xhabiri [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: e ka lejuar i dërguari [salallahu alejhi ve selem] ndërmjetësimin në çdo send që nuk është ndarë (gjykuar), ndërsa kur të vendosen kufijt dhe të ndahen rrugët atëherë nuk ka më ndërmjetësim.

### **Dobitë e hadithit:**

- Dijetarët kanë rënë në pajtueshmëri se ndërmjetësimi është e drejtë e partnerit në pronat e patundura ose te ngjajshme nëse nuk është ndarë prona e patundëshme ende, dhe që është prej sendeve që mund të ndahet. Dijetarët janë në pajtueshmëri se nuk ka ndërmjetësim ne sendet që mund të barten si: kafshët, veshjet, mobiljet etj, dhe gjithashtu në pronat e patundshme që nuk mund të ndahen siç janë banjot ose të ngjashme. Sepse urtësia në shumicën e rasteve është largimi i dëmit të ndarjes që ndoshta do ta kërkonte ortaku i tij, ndërsa këto gjëra nuk mundet të ndahen dhe nuk ka frikë prej ndarjes se tyre. Ndërsa nuk kanë rënë ne pajtueshmëri dijetarët në vërtetimin e të drejtës së ndërmjetësimit për: fqin, ortakun ndarës, mirëpo kanë thënë se këtyre ju takon rruga edhe te ngjajshem.

Tre dijetarët (Maliku, Shafiu, Ahmed ibn Hambeli) thonë se atyre nuk ju takon ndërmjetësimi. Ndërsa Hanefijt thonë: ju takon atyre dyve e drejta e ndërmjetësimit. Dhe argumenti i tyre është se edhe ata dy fqin edhe



ortakun ndarës mund ta dëmton i njëjti dëm sikur ortakun i cili nuk është ndarës.

- Na bën me dije hadithi se feja Islame e mbron pronën e individit, dhe e nderon të drejtën e tij në veprimin e tij me pronën e tij.
- Shoqëria islame është shoqëri e plotësuar, dhe shiqon në dobinë e të gjithëve, duke i pasur parasysh individët, dhe nuk e pranon egoizmin, as nuk e pranon bërjen dëm dikujt tjetër.
- Nuk ka dëm as të dëmtuar në fenë islame, as nuk ka të drejt askush ti bën dëm askujt tjetër, as nuk i lejohet që ta hjek dëmin e dikujt duke i bërë dëm dikujt tjetër.

## Hadithi nr.47: Mirësia e All-llahut të lartësuar

---

Nga natyra e njeriut të shëndoshë është që të dëshirojë të veprojë mirë, mirëpo nga ndonjëherë i dalin pengesa në veprimin e mirësis, prandaj prej mirësis së All-llahut të lartësuar ndaj besimtarëve është se Ai ua mundëson veprimin e adhurimit, dhe ua zmadhon shperblimet për atë adhurim, edhe kur nuk kanë mundësi që të veprojnë veprat e mira, mirëpo kanë dëshirë t'i realizojnë, i shpërblenë sipas qëllimit të tyre.

Edhe nga natyra e njeriut është që të gabon, dhe të bjen në kundërshtim, prandaj prej mirësis së All-llahut të lartësuar është gjithashtu ajo që nuk ua përshpejton atyre dënimin kur të gabojnë edhe pse ndonjëherë njeriu i flet vetes për veprimin e ndonjë mekati mirëpo pa e shprehur atë, këtë nuk e denon All-llahu i lartësuar për qëllimin e tij edhe nëse e shfaq atë para krijesave, Ai nuk ia shumëfishon atij dënimin. E gjithë kjo është nga mirësia e All-llahut të lartësuar dhe nga mëshira e Tij, prandaj në vazhdim është një hadith kudsij që na përgëzon për këtë:

Transmetohet nga Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të] se i dërguari [salallahu alejhi ve selem] ka thënë: Thotë All-llahu i Madhëruar:

*“Nëse dëshiron robi Im ta vepron një të keqe mos ia shenoni atij derisa ta vepron, nëse e vepron shënojani atij vetem një, nëse e braktisën atë për shkak Meje shënojani atij një shpërblim, gjithashtu nëse dëshiron robi Im të vepron një vepër të mirë dhe nuk e vepron, atëherë shënojani atij një shpërblim, mirëpo nëse e vepron atë, atëherë shënojani atij me dhjetë shperblime deri në shtatëqind fish më shumë shpërblime”.*

### **Dobitë e hadithit:**

- All-llahu i Lartësuar i sheh zemrat e robërve të Tij, dhe i njeh qëllimet e tyre.
- All-llahu nuk e ndëshkon robin për shkak të përshpëritjes së vetës se tij për kryerje të mëkatit derisa nuk e vepron atë.
- Njeriu shpërblehet për qëllimin e tij të mirë edhe përkundër orvatjes së tij për veprimin e mirësis edhe pse nuk e vepron atë për shkak të ndonjë pengese.
- Kur ndonjërit i obligohet ndonjë adhurim me plotësimin e shkaqeve të tij, siç është: obligueshmëria e namazit me hyrjen e kohës ose obligueshmëria e agjërimit me hyrjen e ramazanit ose obligueshmëria e haxhit me realizimin e mundësisë pastaj nuk mundet që ta vepron ai për shkak të ndonjë pengese edhe pse ai

orvatet për veprimin e tij, atëherë edhe nëse vdes para se ta vepron atë, ai nuk ka përgjegjësi për të.

- Muslimani duhet që të ketë për qëllim veprimin e së mirës çdoherë sepse ndoshta do ta merr shpërblimin e asaj vepre, si dhe ai përgatit veten e tij për veprimin e mirësis kur të ketë mundësi.
- Sinqeriteti në veprimin e adhurimeve dhe lënijen e mëkateve është baza e shumëfishimit të shpërblimit sepse sa më shumë që është sinqeriteti i madh aq më shumë shumëfishohet shpërblimi.
- Mirësia e All-llahut të lartësuar për robërit e Tij besimtarë është e madhe dhe mëshira e Tij e gjërë, falja e Tij gjithëpërfshirëse, shpërblimet e Tij të panumërta.

## Hadithi nr. 48: Dunjaja mjet për ahiret

---

Njeriu jeton në këtë botë sa donë All-llahu të jetoj, pastaj një ditë prej ditësh duhet patjetër që të vdes, thotë All-llahu: **“Ti (o Muhamed) je i vdekshëm dhe ata janë të vdekshëm” si dhe nuk e din njeriu kur përfundon afati i tij dhe kur i vjen vdekja, thotë All-llahu: “Nuk e din njeriu çka fiton në të nesërmen dhe nuk e din njeriu në cilën tokë do të vdes”.**

Kjo botë do të zhduket sa e gjatë që është dhe kjo është një e vërtetë e qartë, që ne e shiqojmë çdo ditë dhe natë, si dhe e ndjejmë atë çdo orë e çast.

Pas vdekjes njeriu do t'a jetoj një jetë të përhershme, që nuk ka fund e as afat, ajo jetë e pafund është jeta e ahiretit. Pasiqë t'i rringjallë Allahu i lartësuar njerëzit nga varetat dhe t'i mbledh tek Ai që t'i llogaritë për veprat e tyre dhe të gjykon në mes tyre ose për në parajsë që gjërësia e të cilit është sa qiejt e toka dhe që është përgaditur për të devotshmit që do të jenë përgjithmonë në të ose për në zjarr që lënd djegëse e tij janë njerëzit dhe guret, që është përgaditur për mosbesimtarët, që nuk do të kenë mundësi të dalin prej tij.

Njeriu i mençur është ai që nuk mashtrohet me këtë botë dhe nuk qetësohet në të e as nuk sigurohet në të e as nuk e mendon atë për çdo send, por e bënë atë një kopsht që në të e mbjell farën që do ta korr në botën tjetër dhe e bënë mjet për të shpëtuar nga ura e siratit e ngritur mbi xhehennem dhe e konsiderone rrugë në një shkretëtirë të frikshme dhe se ai duhet të kalojë me kujdes që të arrin në vend të sigurt.

Në të ka mirësi që aludon hadithi i të dërguarit:

Transmetohet nga Abdullah ibn Umeri [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: më kapi i derguari [salallahu alejhi ve selem] për shpatulla dhe më tha: “Bëhu në këtë botë sikurse me qenë i huaj ose udhëtarë apo kalimtarë. Ibn Omeri thoshte: Nëse e arrin mbrëmjen mos e prit mëngjesin e nëse e arrin mëngjesin mos e prit mbrëmjen, shfrytëzoje shëndetin tënd para sëmundjes dhe të njejten para vdekjes.

### Dobitë e hadithit:

- Duhet që njeriu t'i shton të mirat, adhurimet dhe respektin si dhe mos të i anashkalojë e as mos t'i vanon ato duke shpresu në të mirat e ardhmes sepse nuk e din se kur i mbaron afati i jetes tij.

- Muslimani duhet që të i shfrytëzon shanset kur t'i jepen atij dhe para se te kalon koha.
- Në këtë hadith ka nxitje për asketizëm në botë dhe largim nga zbukurimet e saja dhe angazhimet e saj, mirëpo kjo nuk d.m.th. lënien e punës e as aktiviteteve as fitimeve por mos lidhja për të e t'i anashkalon punët e botes tjetër.
- Muslimani duhet të përpiqet për vepra të mira si dhe t'i shton mirësit që çdoherë duke u frikësuar prej dënimit të All-llahut të lartësuar dhe kjo të jetë shkak për shtimin e punës e aktivitetit sikur udhëtari i cili shpenzon mund duke u frikësuar mos t'i nderpritet udhëtimi e të frikësohet se a do të arrin në cakun e tij.
- Muslimani ka kujdes nga shoqëria me të kqinj të cilët llogariten si plaçkitës të rrugës që mos ta largojnë atë nga qëllimi i tij si dhe të ndërhyjnë ndërmjet atij dhe arritjes së qëllimit të tij.
- Puna në këtë botë është e patjetërsueshme për arritjen e dobive. Muslimani krejt këtë e nënshtron për arsye të botës tjetër dhe arritjes së shpërblimit tek All-llahu i lartësuar.

## Hadithi nr. 49: Etika e bisedës në takime

---

Islami është fe e cila me rregullin e saj ka përmbledhur gjitha çështjet e jetës duke mbrojtur me këtë rregull bashkimin e shoqërisë, dashurisë së individëve të saj dhe njëashtu përforcimin e lidhjes ndërmjet tyre.

Ka vendosur ligje për këtë çështje që ta forcon lidhjen me dashuri, që ka urdhëruar për të dhe ka nxitur në të (në dashuri). Në të njëjtën kohë ka tërhequr vërejtjen nga çdo gjë që shpie në përçarje dhe shpërndarje, gjë që mbjellë urrejtjen dhe largimin.

Disa nga rregullat që ka vendosur për këtë çështje janë:

Përfillja e etikës së përgjithshme dhe mos largimi nga ajo, e mbështetur nga hadithi i Pejgamberit [salallahu alejhi ve selem] për etikën e të folurit në prezencë të tjerëve.

Transmetohet nga Abdullah ibn Mes'udi [Allahu qoftë i kënaqur me të] se ka thënë: ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem]:

“Nese jeni tre persona mos flisni dy persona fshehurazi nga i treti derisa te përziheni me njerëzit, për arsye që mos të mërëzitet ai”.

### **Dobitë e hadithit:**

- Nuk lejohet që një grup të flasin ndërmjet veti dhe ta lënë njërin anash duke mos e kyçur në bisedë përveç me leje prej tij që të flasin ndërmjet veti për ndonjë çështje të veçantë për ta, siç është transmetuar në librin e Muslimit se ka thënë i dërguari [salallahu alejhi ve selem]: “Mos të flasin dy veta fshehur nga i treti përveç me leje”.

Dhe nuk ka dallim nëse ata që flasin janë dy apo me tepër përderisa prej atij që fshihet biseda është vetëm një person.

- Nëse janë një grup më shumë se tre persona dhe flasin fshehurazi ndërsa tjerët janë më shumë se një person, atëherë nuk ka ndalesë

edhe pse me etikë është që të marrin pjesë në bisedë tërë grupi përveç në rast nevojë.

- Nëse flasin dy persona e më shumë që lënë njërin ose më shumë jashtë bisedës nuk lejohet që këta ta ndëgjojnë bisedën e tyre sepse gjithashtu edhe ky gjest nxit urrejtje dhe armiqësi që i përngjason spiunimit të ndaluar.

Gjithashtu nëse një person hyn në një vend nuk i lejohet që të ulet afër dy personave dhe të dëgjon se çka flasin fshehurazi, përveç nëse ka argument se kjo gjë nuk ju pengon atyre dhe i japin leje.

- Ndalohen biseda të fshehura pa dallim se a bëhen në vendndeje, në udhëtim apo diku tjetër.
- Nëse është biseda e fshehtë ndërmjet dy personave ose më shumë, që ka të bëjë me ndonjë bisedë të ndaluar fetarisht, ajo nuk lejohet edhe nëse është me lejen e një personit ose pa lejen e tij, gjithashtu nëse është i lërë anash apo jo, ka thënë All-llahu i lartësuar:

**“O ju të cilët keni besuar, kur të flitni fshehtas, mos flitni diç të ndaluar apo për armiqësi apo për mosdëgjueshmëri ndaj të dërguarit, po flitni fshehtas për mirësi dhe devotshmëri”.**(el muxhadele:9)

- Nëse një njeri është me famë dhe post që dëshirojnë të gjithë njerëzit të marrin pjesë në bisedën e tij, por mund të mërzhiten dhe të ofendohen nëse flet me ndonjërin fshehurazi, i ndalohet atij që të bisedon me ndonjërin prej tyre fshehurazi edhe nëse janë tjerët më shumë se një person.
- Islami është fe e përsosur dhe ligj gjithpërfshirës që regullon jetën, ka parasysh ndjenjat e njeriut, i nderon ndjenjat e individit edhe grupeve.

- Duhet që muslimani të zbkurohet me etikën islame sepse ajo e zmadhon dashurinë ndërmjet njerëzve.
- Duhet që muslimani të ketë kujdes në sjelljet e tij në publik duke përfshirë vendndejt dhe kuvendet e sidomos kuvendet e gjykatësve sepse në të ka rregullim të etikës se individit dhe përforcim të shoqërisë.
- Duhet që muslimani të ketë etikë që e forcon në dashurinë ndërmjet të tjerëve dhe të largohet nga çdo send që e shkakton urrejtjen dhe largimin ndërmjet tyre.



## Hadithi nr.50: Puna shtëpiake

---

Transmetohet nga Abdullah ibn Abbasi [Allahu qoftë i kënaqur me të]se i derguari [salallahu alejhi ve selem] ka thënë: se All-llahu i lartësuar ka thënë: "Me të vërtet All-llahu i lartësuar e ka shkruar çdo send, të mirat dhe të këqiat, pastaj i ka sqaruar, kush përpiqet ta bene një miresi, edhe nuk e bën atë, ia shënon All-llahu atij një të mirë komplet, e nëse ai perpiqet ta bën një mirësi, dhe e bën atë atëher ia shënon All-llahu atij dhjetë mirësi, deri në shtatëqind herë e më shumë, ndërsa kur përpiqet ta bën një të keqe dhe nuk e bën atë ia shenon All-llahu atij një mirësi komplet, nëse përpiqet që ta vepron një të keqe dhe e bën atë ia shkruan All-llahu atij vetëm një të keqe". hadith kudsî

**Nga arabishtja :**

**Mr. Ibrahim Sherifi**

**[www.thirrjaislame.com](http://www.thirrjaislame.com)**

## Përmbajtja :

Parathënie.....	4
Hadithi nr. 1: Etika e lutjes.....	6
Hadithi nr.2: Morali në rrugë .....	8
Hadithi nr.3: Dispozita e xhenazes.....	10
Hadithi nr.4: Kerkimi i natës së Kadrit .....	12
Hadithi nr.5: Këshilla për cdo musliman nga Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem].....	14
Hadithi nr.6: Xhelozia pozitive e lavdëruar .....	17
Hadithi nr.7: Furnizimi është prej All-llahut të lartësuar .....	20
Hadithi nr.8: Ngritja e diturisë .....	22
Hadithi nr.9: Mësimi i grave.....	24
Hadithi nr.10: Përparësia e të djathtës ndaj të majtës.....	26
Hadithi nr.11: Larja e të Dërguarit [salallahu alejhi ve selem].....	28
Hadithi nr.12: Besimtari nuk bëhet i papastër.....	30
Hadithi nr.13: Këshillimi i të Dërguarit [salallahu alejhi ve selem] ndaj grave ....	32
Hadithi nr.14: Pastrimi nga mensturacionet.....	35
Hadithi nr.15: Vecorit e të Dërguarit [salallahu alejhi ve selem].....	37
Hadithi nr.16: Ndalimi i pështyerjes në anën e kibles (Qabes).....	39
Hadithi nr.17: Kalimi para falësit është mëkat.....	41
Hadithi nr.18: Nxitja për faljen e namazit të sabahut.....	43
Hadithi nr.19: Vlera e namazit tek All-llahu.....	45
Hadithi nr.20: Ezani.....	47
Hadithi nr.21: Vlera e ezanit dhe e reshtit të parë në namaz.....	50
Hadithi nr.22: Obligueshmëria e përcjelljes së imamit në namaz .....	52
Hadithi nr.23: Urrehet zgjatja e namazit nga imami.....	54
Hadithi nr.24: Butësia me kafshët .....	56
Hadithi nr.25: Sexhdeja shtyllë e namazit.....	58

Hadithi nr.26: Etika e ditës së xhuma .....	60
Hadithi nr.27: Ditët e Bajramit janë ditë feste dhe gëzimi, dispozita e këndimit në festa. ....	62
Hadithi nr.28: Kohët e dobishme .....	66
Hadithi nr.29: Namazi i natës.....	68
Hadithi nr.30: Kërkimi i shiut prej All-llahut .....	71
Hadithi nr.31: Çështje që nuk i din askush përveç Allahut .....	73
Hadithi nr.32: Shenjat e fuqisë së All-llahut të Lartësuar .....	75
Hadithi nr.33: Udhëtimi i gruas.....	77
Hadithi nr.34: Bashkimi ndërmjet dy namazeve.....	80
Hadithi nr.35: Prej porosive të të dërguarit.....	82
Hadithi nr.36: Rruga e xhennetit.....	83
Hadithi nr.37: Dënimi i mosdhënësit të zekatit .....	85
Hadithi nr.38: Lemosha më e mirë .....	87
Hadithi nr.39: Vetëpërmbytja në kërkimin e pasurisë.....	89
Hadithi nr. 40: Lëmosha për cdo musliman .....	91
Hadithi nr. 41: Dinjiteti i muslimanit.....	93
Hadithi nr.42: Zekati i fitrit.....	95
Hadithi nr.43: Shitja e arrit dhe argjendit .....	98
Hadithi nr.44: Zgjedhja e vendit për dy tregtar .....	100
Hadithi nr. 45:Fitimi i dëmshëm .....	102
Hadithi nr.46: E drejta e ndërmjetësimit .....	104
Hadithi nr.47: Mirësia e All-llahut të lartësuar .....	106
Hadithi nr. 48: Dunjaja mjet për ahiret.....	108
Hadithi nr. 49: Etika e bisedës në takime .....	110
Hadithi nr.50: Puna shtëpiake.....	113